

Jostina Dhimitri Fatmiroshe Xhemalaj (Shehaj)

Silvana Kasa Orjeta Prifti

LIBRI I MËSUESIT

Gjeografia 7

Shtëpia Botuese & Shtypshkronja



TIRANË 2017

***“Libri i mësuesit” hartuar sipas tekstit “ Gjeografia 7”,
fitues i konkursit kombëtar 2016, miratuar
nga Ministria e Arsimit dhe Sportit***

BOTIME SHKOLLORE



Titulli i librit:

Libri i mësuesit Gjeografia 7

Autorë

Jostina Dhimitri

Modele Testesh: Testi 2 tremujori I;
Testi 4 tremujori II; Testi 6,7 tremujori III
Model i një projekti

Fatmiroshe Xhemalaj (Shehaj)

Hyrje, Vlerësimi i një mësuesi

Silvana Kasa & Orjeta Prifti

Korniza kurrikulare-Izha 2014
Plani mësimor vjetor
Planet mësimore tremujore
Modele të planifikimit të orës mësimore
Modele testesh

Arti grafik

Studio grafike FILARA

Punoi: Gazmir Myteberi

Botimi i parë

FILARA, Tiranë, 2017

© Shtëpia Botuese, FILARA

Shtypur në shtypshkronjën FILARA, Tiranë, 2017

Adresa:

***Shtëpia Botuese & Shtypshkronja FILARA
Rruga “Sabaudin Gabrani”
(Ish-kombinati “Misto Mame”), Tiranë***

Cel: 069 333 0983 / 069 66 99 693

E-mail: filarabotime@yahoo.com

Website: www.filarabotime.com

PËRMBAJTJA

1. HYRJE - PËRSE NJË LIBËR NDIHMËS PËR MËSUESIN	4
2. KORNIZA KURRIKULARE-IZHA 2014	7
3. PLANI MËSIMOR VJETOR	13
4. PLANET MËSIMORE TREMUJORE	18
5. MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE	34
6. MODELE TESTESH	107
7. MODEL I NJË PROJEKTI	124
8. KRITERET BAZË PËR VLERËSIMIN E NJË MËSUESI	129

HYRJE

PËRSE NJË LIBËR NDIHMËS PËR MËSUESIN?

Libri i mësuesit është hartuar për t'u ardhur në ndihmë mësuesve për zhvillimin e lëndës Gjeografia 7, në arsimin e mesëm të ulët, në edukimin parauniversitar. Ai ka rolin e ndihmësit pedagogjik dhe synon ndihmën dhe lehtësimin e mësuesit në organizimin e orëve mësimore dhe në menaxhimin e klasës. Procesi i përfshirjes së mësuesit në mësimdhënie, kërkon kohë dhe përkushtim nga ana e mësuesit për hartimin e dokumenteve bazë për zhvillimin e tij. Nevoja për ide në realizimin dhe aplikimin e procesit të mësimdhënies, përmes planit mësimor vjetor, planeve mesimore tremujore, planifikimit të orës mësimore, projektit mësimor, testeve rritet gjithmonë e më tepër.

Libri i mësuesit ju ndihmon pikërisht për këtë. Mund të jenë ide të shumta për zbatimin e teknikave efektive të mësimnxënies. Kështu ju mund ta nisni mësimin me një “brainstorming” (stuhi mendimesh) ose të motivoni nxënësit për pjesëmarrje aktive me një ngjarjet më të fundit, p.sh., me lëvizjet e shpejta të kores së tokës. Mund të sillni të dhëna nga tërmetet apo shpërthimet vullkanike më të fundit të hasura diku, gjeografikisht, në ndonjë rajon të Tokës etj. Mund të gjeni ide në pyetjet e realizuara në testimet tremujore apo në organizimin e projekteve. Ajo që sugjerojmë në këtë libër është mundësia për t'ju gjendur dhe ndihmuar në punën tuaj të përditshme, duke ua bërë atë më të lehtë.

Libri i mësuesit për lëndën e gjeografisë, klasa e shtatë, në arsimin e mesëm të ulët, përfshin udhëzime të IZHA-ës për kornizën kurrikulare të lëndës së gjeografisë, planin mësimor vjetor, planet tremujore, modele orësh mësimore (70 orët e planit mësimor vjetor të zhvilluara), modele testesh tremujore, modele projektesh lëndore, shpjegime të kriterëve të hartimit të një testi, të vlerësimit të mësuesit, të vlerësimit të nxënësit.

Libri i mësuesit është përgatitur duke u bazuar në programin e lëndës “Gjeografia 7”, shkalla 3 (klasa 6-7), fusha “Shoqëria dhe mjedisi”. Hartimi i këtij programi rrjedh nga Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të ulët. Ndër të tjera ky program i shërben:

- nxënësit për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënësit gjatë gjithë jetës, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri;
- mësuesit për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj. (fq. 4-5 në programin zyrtar).

Gjatë hartimit të tekstit të nxënësit, është treguar kujdes që nëpërmjet tij dhe punës suaj si mësimdhënës, nxënësit të ndërtojnë dhe të aftësohen në zotërimin e kompetencave kyçe të të nxënësit si dhe kompetencave të fushës “Shoqëria dhe Mjedisi”.

Gjatë zbërthimit të tematikave në tema mësimore i është kushtuar vëmendje zbërthimit të njohurive, krijimit të shkathtësive dhe mbajtjes së qëndrimeve/vlerave. Në tekstin e nxënësit,

ju si mësues, ndiheni të lirë, të orientoni nxënësit sipas aftësive të tyre të të nxënës drejt zotërimit të kompetencave të shkallës së tretë të kurrikulës (klasa VII). Ju do të shihni te teksti i nxënësit një ndërthurje me fusha të tjera si: matematika, fizika, kimia, edukimi qytetar, edukimi figurativ etj., duke ndihmuar nxënësit në zhvillimin e kompetencave të të nxënës dhe lidhjen e njohurive lëndore me jetën e përditshme.

Ju jeni të lirë të përzgjedhin dhe të përdorin metoda, teknika, strategji të mësimdhënies e të nxënies që nxisin interesin, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënës të tyre. Një ndër motot që duhet t’ju ndjekë në punën tuaj si mësues është: “Learning by doing” ose “të mësuarit nëpërmjet të bërit” të studiuesit John Dewey, me qëllim pjesëmarrjen aktive të nxënësve në procesin e mësimnxënies.

Si dhe e përmendëm më lart, në këtë libër gjithçka që është shtjelluar është e sugjeruar.

Ato mund të pranohen ose jo prej jush, por gjithsesi janë një bazë ku mund të mbështeteni për të realizuar qëllimet dhe objektivat mësimore në lëndën e gjeografisë për fushën 3, klasa 7.

Mësimet e shtjelluara në tekstin e nxënësit Gjeografia VII, të shtëpisë botuese FILARA, ju vijnë në ndihmë me gjithçka nëpërmjet aparatit pedagogjik, duke ju mundësuar një përgatitje ditore profesionale.

Lexoni dhe përgjigjuni se çfarë keni kuptuar



1. Ç' është Dielli?
2. Sa yje ka në Gjithësi?
3. Cilat janë karakteristikat e Diellit?
4. Ç' është Gjithësia?
5. Cilat janë shpjegimet e astronomëve për krijimin e Gjithësisë?
6. Si e shpjegojnë librat fetare krijimin e Gjithësisë?
7. Ç' karakteristike zbuloi Xhordano Bruno për Gjithësinë?

Kërkoni informacion për:

1. **Kuptimin e fjalëve:** forca e rëndësës së Tokës, **astronom**, teleskop.
2. **Jetën dhe veprën e dijetarit të madh, Xhordano Bruno.**
Pse është përmendur ai në këtë mësim?

Kështu, në tekstin e nxënësit do të shihni një organizim të tillë të tij:

Rubrika: “Lexoni dhe përgjigjuni se çfarë keni kuptuar” do t’ju ndihmojnë në krijimin e situatave hyrëse apo në përmbyllje të mësimi. Gjithashtu ju ndihmon në përcaktimin e kompetencave që doni të nxirrni më në pah.

Rubrika “Kërkoni informacion për kuptimin e fjalëve” është krijuar posaçërisht për të nxitur nxënësit në hulumtime të mëtejshme të fenomeneve, personazheve, rasteve etj, që dalin përceptazi gjatë dhënies së njohurive të reja në tekst, por që bashkërisht mund t’i hulumtoni më tej. Kjo rubrikë nuk cenon dhënien dhe shpjegimin e koncepteve bazë apo të dukurive kryesore në të.

Rubrika “Punojmë”, përfshin një sërë nënçështjesh si:

Fjalorth: ku jepen konceptet kryesore që duhet të njohin dhe zotërojnë nxënësit. Të gjitha këto fjalë janë të shpjeguara në brendinë e tekstit të nxënësit;

Punoni me foton: ku nëpërmjet fotove ilustrohen dukuritë, dëshmi, jepen skema, shpjegohen shkaqe, paraqiten pasoja etj. Kjo ndihmon në një perceptim më të thellë të brendisë së trajtuar në mënyrë tekstuale në librin e nxënësit. P.sh., me anë të fotove ju mund të realizoni mjaft mirë nxitje të

mendimit kritik etj;

Punoni me hartën / diagramin: ju kërkon të përdorni hartën sa më shumë të jetë e mundur duke planifikuar dhe nxitur edhe metodën e kërkimit;

PUNOJMË



FJALORTH

Shpjegoni kuptimin e fjalëve kyç:
Sistemi ynë diellor, "Apollo 11"



PUNONI ME FOTON

Vëreni fotot dhe shpjegoni se çfarë paraqesin ato.



PUNONI ME HARTËN

1. Cilët janë autorët e saj?
2. Si e kanë menduar ata, pozicionin e Tokës në sistemin diellor?



MENDONI NË MËNYRË KRITIKE

"Ky është një hap i vogël për një njeri, por një hap gjigant për njerëzimin" - ka thënë, Neil Armstrong.
Shpjegoni në një paragraf se si e kuptoni, këtë thënie të tij. Qëndrimin tuaj diskutojeni në klasë.



ZGJIDHNI SITUATËN

1. Ballafaqoni qëndrimin e dijetarit Ptoleme dhe të dijetarit Nikolla Kopernik, për temën "Pozicioni i planetit Tokë në sistemin tonë diellor". Cili është qëndrimi më i saktë?
2. Çfarë metodash e mjetes, përdori Galilei në zbulimet e tij?

Mendoni në mënyrë kritike: lejon që nëpërmjet situatave të shkohet nga përkufizimi, drejt analizave, përgjithësimeve dhe zotërimit të aftësive etj.

Zgjidhni situatën: i ndihmon nxënësit në formimin e qëndrimeve dhe vlerave dhe nxitjen e tyre drejt dhënies së mendimeve, bërjes së raporteve, nxjerrjes së përfundimeve dhe dhënies së vlerësimeve për çështje të trajtuara në tematikat lëndore dhe më gjerë.

Nuk na mbetet gjë tjetër veçse t'ju urojmë të jeni sa më frytdhënës në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies së lëndës së gjeografisë, duke formësuar një individ të denjë për shoqërinë ku ai bën pjesë dhe kërkon të përparojë.

Fatmiroshe Xhemalaj (Shehaj)



Qëllimet e lëndës së gjeografisë

Lënda e gjeografisë për shkallën III synon që nxënësi:

- të zhvillojë kuriozitetin për vendet, njerëzit, kulturat dhe mjediset në botë;
- të zhvillojë dijet për dukuritë dhe proceset fiziko-gjeografike mbi bazën e një përgatitjeje të përshkallëzuar dhe ballafaqimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik e krijues.
- të zhvillojë kuptimin, interesin dhe respektin për vendin ku jeton, vendet e tjera, njerëzit dhe mënyrën si ata ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe mjedisin ku jetojnë.
- të zhvillojë shkathtësitë për të qenë përdorues kritik dhe krijues i metodave të kërkimit gjeografik.
- të zhvillohet si qytetar i informuar, i përgjegjshëm dhe aktiv, i cili mund të kontribuojë për zhvillimin e një bote të qëndrueshme.
- të përdorë teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit.

Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës /lëndës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme që i shërbejnë procesit të të nxënit.

Kompetenca përcaktohet si ndërthurje e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet të fitojë gjatë procesit të nxënies. Ato janë:

1. kompetenca qytetare;
2. kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit;
3. kompetenca e të menduarit;
4. kompetenca e të nxënit;
5. kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
6. Kompetenca personale;
7. kompetenca digjitale.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen në lëndën e Gjeografisë mbështetur në programin lëndor, shkalla III dhe tekstin mësimor “Gjeografi 7”.

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi mendon në mënyrë efektive.

- Shpreh qartë mendimin e vetë për një temë të caktuar (sistemi diellor, zonat klimatike, relievi kontinenteve, mjediset jetësore etj.)
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe diskutimet e bëra nga të tjerët, duke bërë pyetje, komente dhe propozime (veprimtari praktike, projekte, ekskursion etj.).
- Shpjegon qartë dhe saktë kuptimin e termave të reja (fjalë kyçe, koncepte) gjeografike, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.

- Punon në grup (veprimtari praktike) duke ndërtuar marrëdhënie të mira bashkëveprimi me shokët e shoqet.
- Komenton dhe diskuton lirshëm duke ndarë mendimet e veta me mësuesin, shokët e shoqet dhe prindërit.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi mendon në mënyrë krijuese.

- Njeh dhe përshkruan në mënyrë të drejtpërdrejtë realitetin e mjedisit natyror dhe shoqëror të vendbanimit të tij dhe bashkisë.
- Interpreton mënyra të zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror mjedisit jetësor (peizazhit gjeografik, dhe burimet natyrore etj.) duke ilustruar atë me shembuj konkretë.
- Krahason dhe përshkruan kushte të ndryshme natyrore dhe të jetës së popujve në rajone të veçantë gjeografik.
- Parashtron argumente pro dhe kundër për një temë apo problem të caktuar (mjediset jetësor, asgjësimi dhe riciklimi i mbetjeve etj.) gjatë debateve që do të kryen.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

Nxënësi mëson për të nxënë.

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si libra, revista, enciklopedi ose internet) të cilat i shfrytëzon për realizimin e detyrave të dhëna.
- Shpjegon nëpërmjet shembujve kuptimin për tokën në hapësirë, proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë, ndërveprimi i shoqërisë njerëzore me mjedisin etj.
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike dhe grafike për tema mësimore të caktuara (temperatura e
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga mësuesi dhe teksti shkollor për të nxënë një temë, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
- Mendon në mënyrë kritike kur vlerëson pasojat e veprimtarisë së shoqërisë njerëzore në një mjedis jetësor të caktuar dhe parashtron mendimet e veta për zgjedhjen e duhur.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive.

- Ndërgjegjësohet për proceset dhe dukuritë e ndryshme gjeografike duke njohur veprimtarinë e forcave natyrore dhe shoqërisë njerëzore në mjedisin jetësor.
- Vlerëson rëndësinë dhe efektivitetin e zgjedhjeve të propozuara nga njëri-tjetri.
- Diskuton për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit lokal dhe pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe të gjallesave, si dhe propozon masat e duhura që duhen ndërmarrë për mënjanimin e tyre.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët për realizimin e një veprimtarie të përbashkët (në bazë klase / shkolle, bashkie) të zhvilluar në mjedisin lokal të vendbanimit të tij.

Kompetenca personale

Nxënësi bën jetë të shëndetshme.

- Zhvillon aftësitë për të menaxhuar veten e tij që të jetë i pavarur në zbatimin e njohurive, shkathtësive, me qëllim marrjen e vendimeve konkrete.
- Bashkëpunon në klasë dhe në terren për të zhvilluar aftësitë ndërpersonale dhe të mësojë që të vlerësojë mendimet e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca qytetare**Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët.**

- Vlerësohen gjetjet e tij në lidhje me qëndrueshmërinë mjedisore në nivel lokal dhe respektimin e burimeve natyrore në zonën ku jeton.
- Nxitet të mendojë në mënyrë kritike në marrjen e vendimeve që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat do të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së veprimtarisë në grupin shoqëror.
- Propozon rrugë alternative për çështje të ndryshme gjeografike, duke vlerësuar faktorët mjedisorë, ekonomik dhe shoqëror në vendbanimin e tij.

Kompetenca digjitale**Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin.**

- Përdor TIK-un për të mbledhur informacion shtesë për temat mësimore.
- Analizon dhe vlerëson informacionin e marrë elektronikisht për proceset dhe dukuritë gjeografike në vendbanimin e tij dhe marrëdhënien e njeriut me mjedisin.
- Përdor programet kompjuterike për të realizuar detyra dhe projekte rreth temave mësimore.

Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

Në shkallën e tretë, programi i gjeografisë zhvillon kompetencat e mëposhtme lëndore, të cilat lidhen me kërkimin gjeografik:

- *Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.*
- *Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit.*
- *Marrja e vendimeve mbi bazën e informacionit të mbledhur.*

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës / fushës**1. Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike**

- Formulon, shqyrton dhe drejton pyetje individualisht dhe si pjesë e një grupi për çështjen gjeografike që do të zhvillohet kërkimi gjeografik.
- Pasqyron në mënyrë kritike pyetje duke shpjeguar idetë e tij personale për vëzhgimin dhe hetimin e dukurive gjeografike dhe respekton mendimin e të tjerëve.
- Formulon hipoteza që do të shërbejnë si pikënisje për një kërkim a studim të mëtejshëm të dukurive gjeografike në mjedisin lokal të zonës së tij.
- Analizon dhe përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike që ndodhin në sistemet natyrore të rruzullit tokësor në mjedisin lokal dhe të veprimtarisë së shoqërisë njerëzore në lidhje me mënyrat e përdorimit të burimeve natyrore.
- Përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike që ndodhin në sistemet natyrore të Tokës dhe në mjedisin lokal.

2. Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

- Identifikon, shqyrton dhe shpjegon burimet e informacionit si një domosdoshmëri në punën kërkimore që kryen.
- Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe saktësinë e tyre për shpjegimin e dukurive gjeografike me qëllim që të arrijë në përfundime të arsyetueshme dhe logjike.
- Përzgjedh dhe përdor burimet e informacionit si burimet tekstuale, vizuale, objektet dhe mjedisin gjeografik.
- Ndërton njohuri për mjedisin lokal dhe proceset gjeografike në sistemet natyrore të Tokës, duke përdorur burimet dhe shkathtësitë gjeografike, si harta, grafik, skica, vëzhgime direkt në

teren, fotografi etj.

- Komunikon, paraqet me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht, shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, duke përdorur harta të shkallëve të ndryshme sipas tematikave përkatëse.
- Komunikon njohuritë e fituara gjeografike duke shqyrtuar e klasifikuar burimet e informacionit dhe duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

3. Marrja e vendimeve

- Përmbledh, përgjithëson e paraqet anët më të rëndësishme të të dhënave me qëllim për të zhvilluar një përfundim të paracaktuar, një parashikim apo një gjetje kyçe.
- Identifikon rrugë të ndryshme të veprimit apo të bashkëveprimit, gjithmonë duke parashikuar pasojat për to.
- Përdor pyetje të ndryshme për të pasqyruar çdo fazë të kërkimit gjeografik “Si po kryen detyrat e ngarkuara?”, “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet metodika e punës kërkimore?” etj.
- Propozon me gojë dhe me shkrim rrugët për zgjidhjen e problemit në të ardhmen.

Planifikimi vjetor i lëndës

Për planifikimin vjetor të lëndës, mësuesi, përveç programit mësimor duhet të njohë tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor i përzgjedhur është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm përvetësimit të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni.

Plani vjetor është një plan sintetik. Mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tre tremujore.

Tremujori i parë: shtator- dhjetor

Tremujori i dytë: janar - mars;

Tremujori i tretë: prill- qershor.

PLANI MËSIMOR VJETOR

Klasa:

Fusha:

Lënda:

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes së lëndës		
	Shtator – dhjetor Orët Në këtë kolonë vendoset përmbajtja e lëndës që do të zhvillohet në këtë periudhë për secilën tematikë.	Janar – mars Orët Në këtë kolonë vendoset përmbajtja e lëndës që do të zhvillohet në këtë periudhë për secilën tematikë	Prill – qershor Orët..... Në këtë kolonë vendoset përmbajtja e lëndës që do të zhvillohet në këtë periudhë për secilën tematikë
Këtu vendosen orët e planifikuara për secilën tematikë për klasën e __, të marra nga programi i shkallës.			

Planifikimi sipas periudhave

Fusha:

Lënda:

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

.....

Këtu vendosen rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës

.....

Këtu vendosen rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore

Nr.	Tematika (orë)	Temat mësimore	Situatë e parashikuar e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
		<i>Këtu vendosen temat mësimore për çdo orë mësimi.</i>	<i>Këtu vendoset situata të nxënësi që mësuesi parashikon të realizojë gjatë një ose disa temave mësimore.</i>	<i>Këtu vendoset metodologjia e mësimdhënies që do të përdoret gjatë zhvillimit të këtyre temave (jo shumë e detajuar sepse vendoset në planifikimin ditor).</i>	<i>Këtu vendosen teknikat e vlerësimit të arritjeve të nxënësit (jo shumë e detajuar sepse vendoset në planifikimin ditor).</i>	<i>Këtu vendosen burimet që përdor mësuesi dhe nxënësi për arritjen e rezultateve të nxënies. (jo shumë e detajuar sepse vendoset në planifikimin ditor).</i>

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Metodat, teknikat, strategjitë e mësimdhënies në lëndën e gjeografisë janë faktorë të rëndësishëm për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënit të tyre.

Mësimdhënia dhe të nxënit, i bazuar në kompetenca, kërkon që në përzgjedhjen dhe përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësuesit e kësaj lënde:

- ✓ të marrin parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësit, që nënkupton përvojat individuale të tij dhe, mbi këtë bazë, të mbështesin e orientojnë të nxënit e tij;
- ✓ të nxisin vrojtimin e drejtpërdrejtë, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve dhe vëzhgimeve në natyrë;
- ✓ të nxisin të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- ✓ të motivojnë nxënësin, duke e konsideruar si partner, në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë komplementarë të njëri-tjetrit;
- ✓ të mbështesin të nxënit e pavarur dhe në bashkëpunim të nxënësve përmes punës me projekte, punës në grup, punës individuale;
- ✓ të mbajnë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të fushës Shoqëria

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

dhe mjedisi, zbatimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe lidhjen ndërlëndore.

✓ të shfrytëzojnë burime të shumëllojshme informacioni dhe ta çmojnë tekstin si një burim të rëndësishëm, por të pamjaftueshëm për përmbushjen e kompetencave të fushës.

✓ të përdorin TIK-un si mbështetës dhe lehtësues të mësimdhënies dhe të nxënës.

PLANIFIKIMI DITOR

Mësuesi planifikon çdo orë mësimore dhe e hedh këtë në planin e tij ditor. Në përgatitjen e një plani ditor mësuesi duhet të përcaktojë rezultatet e pritshme të asaj ore mësimi, të përgatisë veprimtaritë mësimore, të përzgjedhë metodat dhe strategjitë, të përzgjedhë burimet e të nxënës, të përcaktojë teknikat e vlerësimit të përshtatshme për klasën, të parashikojë punën me klasën, grupet, nxënës të veçantë, të parashikojë lidhjen me lëndët e tjera etj.

Planifikimi i orës mësimore

Tema mësimore:	Situata e të nxënës:
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore:	Fjalët kyçe:
Burimet:	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Organizimi i orës së mësimi, i cili mund të përmbajë: - lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve; - ndërtimin e njohurive të reja; - prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura etj.	
Vlerësimi: Pjesë e vlerësimit është edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gjatë kësaj ore mësimi duke pasur parasysh të dhënat e mbledhura në evidenca e progresit të tij.	
Detyrat dhe puna e pavarur: Detyrat dhe puna e pavarur të planifikohen në mënyrë të tillë që të mos rrisin ngarkesën e nxënësit. Mundësisht sipas rastit të jenë të integruara brenda fushës apo ndërmjet fushave.	

METODAT E PËRDORURA

1. Parashikimi me terma paraprak
2. Stuhi mendimesh
3. Diskutim
4. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje
5. Tabelë konceptesh
6. Klaster
7. Diagrami i venit
8. Insert
9. Ditari tre pjesësh
10. Rrjeti i diskutimit
11. Shkrimi i lirë
12. Leximi i drejtuar
13. Të nxënës në bashkëpunim
14. Shpjegim
15. Turi i galerisë
16. Harta e të pyeturit

PLANI MËSIMOR VJETOR

LËNDA: GJEOGRAFIA 7

KLASA 7, SHKALLA 3

VITI SHKOLLOR: _____

MËSUESJA/-I: _____

MIRATOHET/DREJTORI: _____

SHKOLLA: _____

STRUKTURA E PLANIT MËSIMOR VJETOR

Gjeografi Klasa 7

35 JAVË X 2 ORË/JAVË = 70 ORË

Njohuri të reja	45 orë
Punë praktike	10 orë
Përsëritje	6 orë
Testime	3 orë
Projekte	6 orë

Tematika	Nëntematikat	Orë të sugjeruara
1. Proceset natyrore dhe shoqërore	1.1 Toka në hapësirë	8
	1.2 Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë	54
2. Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve	1.2 Shoqëria dhe ndërveprimi me mjedisin	8

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

PLANI MËSIMOR VJETOR SIPAS SEMESTRAVE-KLASA VII

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI

LËNDA: GJEOGRAFIA 7

TEMATIKA	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS		
Tematika 1	SHTATOR –DHJETOR	JANAR-MARS	PRILL-QERSHOR
Nëntematika 1.1 Toka në hapësirë 8 (orë)	(30 ORË)	(24 ORË)	(16 ORË)
Nëntematika 1.2			
Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë			
1.2.1 Atmosfera 13 (orë)	1. Krijimi i Gjithësisë		
	2. Toka në sistemin tonë diellor		
	3. Forma e Tokës dhe përmasat e saj		
	4. Toka, planeti ku jetojmë		
	5. Rrotullimi i Tokës rreth vetes		
	6. Rrotullimi i Tokës rreth Diellit, formimi i stinëve		
	7.SITUATË E SUGJERUAR 1 Trashëgimia gjeografike zbuluar nga hapësira		
	8. PËRSËRITJE 1 Toka në hapësirë		
	9. Atmosfera. Rëndësia, përbërja dhe struktura		
	10. Rrezatimi diellor dhe temperatura e ajrit në Tokë		
	11. Lagështia e ajrit		
	12. Trysnia atmosferike		
	13. Retë		
	14. Erërat		
	15. Reshjet		
	16. Moti dhe klima		
	17. Atmosfera dhe problemet mjedisore të shkaktuara nga njeriu		
	18. SITUATË E SUGJERUAR 2		
	Shtresat e atmosferës		
	19. SITUATË E SUGJERUAR 3		

	Zonat e ndriçimit dhe temperatura e ajrit në planet		
	20. Projekt: Ndotja mjedisore dhe llojet e saj (ora e parë)		
	21. PËRSËRITJE 2		
	Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë – Atmosfera		
	22. Hidrosfera dhe lidhja e saj me sferat e tjera të gjeosistemit		
	23. Qarkullimi i ujit në natyrë		
	24. Oqeanet dhe detet		
	25. Veçoritë e ujit të deteve dhe oqeanëve		
	26. Lëvizja e ujit të oqeanëve dhe deteve (baticë-zbat-ica, valët detare)		
	27. Rrymat oqeanike si pjesë e lëvizjes së ujit të oqeanëve dhe deteve		
	28. PËRSËRITJE 3 (tremujori i parë)		
	29. TEST (Tremujori i Parë)		
	30. Veprimtaria gërryese, transportuese, depozituese e detit		
Nëntematika 1.2			
Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë			
1.2.2 Hidrosfera 18 (orë)			
Nëntematika 1.2			
Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë			
1.2.3 Litosfera 13 (orë)		1. Projekt: Bregdeti	
		2. Ujërat rrjedhëse sipërfaqësore dhe tiparet e tyre	
		3. Veprimtaria e ujërave rrjedhëse sipërfaqësore	
		4. Projekt : Lumenjtë (Ujërat rrjedhëse sipërfaqësore)	

		5. Liqenet, origjina e formimit të tyre dhe tiparet e tjera	
		6. Ujërat nëntokësore dhe veprimtaria karstike	
		7. Veprimtaria e borës dhe e akujve	
		8. SITUATË E SUGJERUAR	
		4 Identifikimi i oqeanëve, deteve dhe gjireve detare kryesore të botës	
		9. SITUATË E SUGJERUAR 5	
		Rrymat oqeanike	
		10. Projekt: Ndotja mjedisore dhe llojet e saj (ora e dytë)	
		11. Ndërtimi i brendshëm i Tokës 12. Kontinentet dhe formimi i tyre 13. Relievi i kontinenteve si pjesë e relievit të sipërfaqes së Tokës	
		14. Format e relievit në kontinente: malet dhe luginat	
		15. Format e relievit në kontinente: fushat dhe kodrat	
		16. Shkëmbinjtë dhe llojet e tyre	
		17. Tokat (dherat), faktorët e formimit të tyre	
		18. Tërmetet	
		19. Vullkanet	
		20. Projekt: Vullkanet	
		21. SITUATË E SUGJERUAR	
		6 Plotësimi i hartës fizike të botës	
		22.SITUATË E SUGJERUAR 7	
		Plotësimi i hartës së shpërndarjes gjeografike të tërmeteve dhe vull- kaneve	
		23. TEST (Tremujori i Dytë)	
			1. Mjediset jetësore të brezit të nxehtë

			2. Mjedisi jetësor i brezit mesatar 3. Mjediset jetësore të brezit të ftohtë
			4. Mjediset jetësore mesdhetare dhe mjediset jetësore në zonat malore
			5. SITUATË E SUGJERUAR 8 Plotësimi i përhapjes gjeografike i mjedisve jetësore të brezit të nxehtë dhe brezit mesatar 6.SITUATË E SUGJERUAR 9 Plotësimi i përhapjes gjeografike i mjedisve jetësore mesdhetare, malore dhe i mjedisve jetësore të brezit të ftohtë
Nëntematika 1.2			7. PËRSËRITJE 5
Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë			Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë-Biosfera
			8. Hapësirat bregdetare, si hapë- sira të jetës njerëzore dhe mbrojtja e tyre
1.2.4 Biosfera 7 (orë)			9. Ndotjet mjedisore
			10. Ndotja në zonat urbane
			11. Ndotja në zonat rurale
			12. Ndërveprimi njeri-mjedis
			13. SITUATË E SUGJERUAR 10 Harta e problemeve dhe e zgjidhjeve mjedisore
			14. Projekt: Ndotja mjedisore dhe llojet e saj (ora e tretë)
			15. PËRSËRITJE 6 (Tremujori i Tretë)
			16. TEST (Tremujori i Tretë)
Nëntematika: Shoqëria dhe ndërveprimi me mjedisin			
8 (orë)			

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

PLANI MËSIMOR TREMUJORI I (SHTATOR-DHJETOR- 30 ORË)

KLASA VII

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI

LËNDA: GJEOGRAFI

PLAN ANALITIK

SHTATOR - DHJETOR (30 ORË)

Nr	Tematika	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
1	Tematika 1	Krijimi i Gjithësisë	Xhordano Bruno një dijetar i madh i shekullit të XVI.	Stuhi mendimesh- Lexim i drejtuar – Diskutim	Vlerësim individual	Teksti i nxënësit, hartë e gjithësisë, fotografi me ngjyra etj.
			Përse është përmendur ai në këtë temë mësimore?			
	Nëntematika 1.1 Toka në hapësirë					
	8 (orë)					
					Vlerësim i detyrave të shtëpisë	
					Vlerësim i përgjigjeve me gojë	
					Vlerësim i punës në grup	
					Vlerësim mes nxënësish	
					Vlerësim për prezantimin me gojë	
					Vlerësim i debatit në klasë	
					Vlerësim për vëzhgimet e kryera në terren	
					Vlerësim për punët e pavarura	

PLANET MËSIMORE TREMUJORE

2		Toka në sistemin tonë diellor	Nikola Koperniku, Galileo Galilei, Neil Armstrong janë përmendur në këtë temë mësimore. Cilat janë mendimet e tyre për Tokën dhe pozicionin e saj në Sistemin tonë Diellor?	Stuhi mendimesh-Insert-Diskutim		Harta e gjithësisë, fotografi me ngjyra, inf. nga interneti etj.
3		Format e Tokës dhe përmasat e saj	Merrni një top dhe një llambë. Llambën imagjinojeni si Diell, që ndriçon Tokën (topin). Çfarë forme ka hija e topit në (Toke) në mur? Pse ?	Stuhi mendimesh-Shpjegim-Tabelë konceptesh		Teksti i nxënësit, harta e zonave të nxehtësisë, glob etj.
4		Toka, planeti ku jetojmë	Diskutim rreth pyetjes: çfarë e bën të veçantë planetin Tokë nga planetët e tjerë?	Stuhi mendimesh-Të nxënit në bashkëpunim-Klaster		Teksti, atlas i gjeografik ,glob, hartë e botës etj.
5		Rrotullimi i Tokës rreth vetes	Para nxënësve tregohen foto të një sateliti artificial, avioni ushtarak dhe një foto e Tokës nga hapësira. Nxënësve u kërkohet të bëjnë lidhjen mes tyre.	Stuhi mendimesh Harta e të pyeturit Punë me tekstin		Teksti ,glob, atlas i gjeografik, fotografi me ngjyra etj.
6		Rrotullimi i Tokës rreth Diellit, formimi i stinëve	Marrja e informacioneve për shpjegimin e fjalëve: verë astronomike, dimër astronomik, ekuinoks, solstic	Parashikimi me terma paraprak-Shpjegim-Marrëdhëniet pyetje-përgjigje		Teksti, glob, atlas i gjeografik, fotografi me ngjyra etj.

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

7		SITUATË E SUGJERUAR 1 Trashëgimia gjeografike zbuluar nga hapësira	Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	Diskutim		Teksti i nxënësit fq. 26-27, kompjuter, celular, internet, hartë fizike e Tokës, glob etj.
				Punë në grupe		
				Prezantim		
8		PËRSËRITJE 1	• Kuptimi i fjalëve kyçe	Diskutim		Teksti i nxënësit fq. 28-30, glob, hartë e Tokës, atlas gjeografik, tabakë letre, markera etj.
		Toka në hapësirë	• Shpjegimi i ideve kryesore për tematikën	Punë në grupe		
				Turi i galerisë	Vlerësim për realizimin e situatave të sugjeruara	
9		Atmosfera. Rëndësia, përbërja dhe struktura	Çfarë është ajri? Cila është rëndësia e tij për jetën në Tokë?	Stuhi mendimesh klaster ese		Teksti, atlas gjeografik, fotografi me ngjyra etj.
	Nëntematika 1.2					
	Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë					
	1.2.1 Atmosfera 13 (orë)					
					Vlerësim për përforcim njohurish	
	Nëntematika 1.2					
	Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë					
	1.2.2 Hidrosfera 18 (orë)					

PLANET MËSIMORE TREMUJORE

10		Rrezatimi diellor dhe temperatura e ajrit në Tokë.	Informacione ndihmese për kuptimin e fjalëve: valë elektromagnetike, veçoritë topografike	Stuhi mendimesh tabela e koncepteve, punë më tekstin		Teksti i nxënësit, harta e brezave të ndriçimit, atlasit gjeografik etj.
11		Lagështia e ajrit	Ndër elementët që përbëjnë atmosferën janë edhe avujt e ujit, e cila njihet me termin: Lagështi e ajrit.	Stuhi mendimesh, shpjegim, punë me tekstin		Teksti i nxënësit fq. 37-39, fotografitë dhe skicat e tekstit etj.
12		Trysnia atmosferike	Ajri është i tejdukshëm, ai përbëhet nga molekula gazesh të ndryshme. Për këtë shkak ai ka peshën e vet të përcaktuar nga forca tërheqëse e Tokës	Stuhi mendimesh, klaster, punë me tekstin.		Teksti i nxënësit fq. 40-42, barometër, foto dhe skica të tekstit, atlasit gjeografik etj.
13		Retë	Nëse në një masë ajri të ngopur me avuj uji, sasia e avujve rritet edhe më shumë, atëherë ndodh kondensimi i avullit të tepërt. Kondensimi është kalimi i ujit nga gjendja e gaztë në atë të lëngët. Kështu krijohen retë.	Stuhi mendimesh, tabela e koncepteve, diskutim.		Teksti i nxënësve fq. 43-45, atlasit gjeografik, foto dhe skica të tekstit etj.

14		Erërat	Juve mund t'ju ketë rastisur të ndjeni erën që fryn në bregdet gjatë verës. Era është masë ajri që zhvendoset nga një vend ku trysnia atmosferike është më e lartë drejt një vendi ku trysnia atmosferike është më e ulët.	Parashikimi me terma paraprak, shpjegim, punë e pavarur.		Teksti i nxënësit fq. 46-48, atlas i gjeografik, foto dhe skica të tekstit etj.
15		Reshjet	Çfarë kuptoni me termin reshje? Si formohen reshjet? Cilat janë llojet e reshjeve që bien në vendbanimin tuaj?	Stuhi mendimesh, harta e të pyeturit, punë me tekstin.		Teksti i nxënësit fq. 49-51, foto dhe skica të tekstit etj.
16		Moti dhe klima	Vështroji nga dritarja e klasës tuaj. Si është moti sot, mot i mirë apo mot i keq? Përshkruajini këto dy terma duke u ndalur në përshkrimin shkurtimisht të elementëve atmosferik si: temperatura e ajrit, trysni atmosferike, erë dhe reshje.	Stuhi mendimesh, tabela e koncepteve, diagram i venit.		Teksti i nxënësit fq. 52-54, termometër, hartë klimatike e botës, atlas i gjeografik etj.
17		Atmosfera dhe problemet mjedisore të shkaktuara nga njeriu	Çfarë di për efektin serë? Cilat janë pasojat mbi sipërfaqen e Tokës?	Parashikimi me terma paraprak, të nxënit në bashkëpunim, diskutim i lirë.		Teksti i nxënësit fq. 55-57, informacione nga interneti, atlas i gjeografik etj.

PLANET MËSIMORE TREMUJORE

18		SITUATË E SUGJERUAR 2 Shtresat e atmosferës	Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	Diskutim, punë me grupe, turi i galerisë.		Teksti i nxënësit fq. 58, foto e shtresave të atmosferës, glob, karton, markera, ngjyra etj.
19		SITUATË E SUGJERUAR 3 Zonat e ndriçimit dhe temperatura e ajrit në planet	Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	Diskutim, punë me grupe, turi i galerisë.		Teksti i nxënësit fq. 59, foto e brezave të ndriçimit, glob, karton, markera, ngjyra etj.
20		Projekt: Ndotja mjedisore dhe llojet e saj (ora e parë)	Organizimi i veprimtarive të nxënësve për realizimin e projektit.	Diskutim, punë në grupe, prezantim.		Internet, teksti i nxënësit, enciklopedi dhe literatura të ndryshme, vëzhgime në terren, fotografi etj.
21		PËRSËRITJE 2 Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë – Atmosfera	Organizimi i orës së mësimi. Veprimtaritë që do të zhvillohen.	Diskutim, punë në grupe, turi i galerisë.		Teksti i nxënësit fq. 60, foto të tekstit, tabakë letre, markera etj.
22		Hidrosfera dhe lidhja e saj me sferat e tjera të gjeosistemit	Çfarë është hidrosfera? Çfarë rëndësie ka ajo për jetën në Tokë?	Stuhi mendimesh, tabelë konceptesh, diskutim i lirë.		Teksti i nxënësit fq. 61-63, atlas gjeografik, foto dhe skica të tekstit etj.
23		Qarkullimi i ujit në natyrë	Paraqitet para nxënësve një skemë e qarkullimit të ujit në natyrë.	Parashikimi me terma paraprake, klaster, diskutim.		Teksti i nxënësit fq. 64-65, fotot dhe skicat e tekstit, hartë politike e botës etj.
24		Oqeanet dhe detet	Përse Toka njihet si planet blu?	Stuhi mendimesh, insert, punë e pavarur.		Teksti i nxënësit fq. 67-69, atlas gjeografik, harta politike e botës, fotot dhe skicat e tekstit etj.

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

25		Veçoritë e ujit të deteve dhe oqeaneve	Në Detin e Vdekur njerëzit qëndrojnë mbi ujë edhe pa notuar. Pse?	Parashikimi me terma paraprak, shpjegim, punë me tekstin.		Teksti i nxënësit fq. 70-72, hartë e botës, foto dhe skica të tekstit etj.
26		Lëvizja e ujit të oqeaneve dhe deteve (baticë-zbatica, valët detare)	Përpara nxënësve shfaqen sekuenca filmike që tregojnë valët cunami të ndodhura në Japoni më 11 mars 2011.	Stuhi mendimesh, lexim i drejtuar, diagram i venit		Teksti i nxënësit fq. 73-75, f foto dhe skica të tekstit, hartë e botës, videoprojektor, kompjuter etj.
27		Rrymat oqeanike si pjesë e lëvizjes së ujit të oqeaneve dhe deteve	Pjesë nga libri “Mesazh në shishe”. “Dallgët dhe fati, mund ta kishin çuar kudo atë shishe, por në fakt u gjet tri javë pas nisjes së udhëtimit.”	Stuhi mendimesh, shpjegim, punë me tekstin.		Teksti i nxënësit fq. 76-78, harta e rrymave oqeanike, atlas i gjeografik etj.
28		PERSËRITJE 3	• Kuptimi i fjalëve kyçe	Bashkëbisedim	Vlerësimi individual	Teksti klasi 7
		(Tremujori i Parë)	• Shpjegimi i ideve kryesore për tematikën	Punë e pavarur	për përgjigjet	Hartë
			• Të menduarit kritik	Diskutim	e dhëna	Fotografi
			• Lokalizimi i vendeve	Krahasim i punimeve	Vlerësim i punës së pavarur në grup	Internet
29		TEST (tremujori i parë)		Punë individuale	Vlerësim individual	Fletë formati
				Të nxënësit e pavarur	i përgjigjeve	
30		Veprimtaria gërryese, transportuese, depozituese e detit	Përpara nxënësve paraqiten fotografi të cilat përshkruajnë veprimtarinë gërryese të detit.	Stuhi mendimesh, tabela e koncepteve, diskutim i lirë.		Teksti i nxënësit fq. 79-81, harta e botës, atlas i gjeografik, foto dhe skica të tekstit etj.

PLANET MËSIMORE TREMUJORE

PLANI MËSIMOR TREMUJORI II (JANAR-MARS 24 ORË) KLASA VII

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI LËNDA: GJEOGRAFI

PLAN ANALITIK

JANAR-MARS (24 ORË)

Nr	Tematika	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
1	Nëntematika 1.2	Projekt: Bregdeti	Organizimi i orës së mësimi. Paraqitja e projektit.	Diskutim, punë në grupe, turi i galerisë.	Vlerësim individual	Teksti i nxënësit, interneti, enciklopedi, harta gjeografike, tabakë letre, markera, plastelinë, etj.
	Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë					
	1.2.2 Hidrosfera 18 (orë)					
					Vlerësim i detyrave të shtëpisë	
					Vlerësim i përgjigjeve me gojë	
					Vlerësim i punës në grup	
					Vlerësim mes nxënësish	
					Vlerësim për prezantimin me gojë	
					Vlerësim i debatit në klasë	
					Vlerësim për vëzhgimet e kryera në terren	

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

2		Ujërat rrjedhëse sipërfaqësore dhe tiparet e tyre	Nxënësit përshkruajnë karakteristikat kryesore të ujërave rrjedhëse të mjedisit të tyre lokal.	Parashikimi me terma paraprak, klaster, punë me hartën.		Teksti i nxënësit fq. 82-84, atlas i gjeografik, hartë hidrologjike e Shqipërisë, hartë fizike e botës etj.
3		Veprimtaria e ujërave rrjedhëse sipërfaqësore	Paraqiten para nxënësve fotografi me ngjyra të një kanioni, një ujëvare dhe pjesët e një sistemi lumor.	Stuhi mendimesh, klaster, punë me hartën.		Teksti i nxënësit fq. 85-87, hartë fizike e botës, hartë fizike e Shqipërisë.
4		Projekt : Lumenjtë (Ujërat rrjedhëse sipërfaqësore)	Organizimi i orës së mësimi. Paraqitja e projektit.	Diskutim, punë në grupe, prezantim	Vlerësim për punët e pavarura	Teksti i nxënësit, interneti, enciklopedi, harta gjeografike, tabakë letre, markera, plastelinë, ujë etj.
5		Liqenet, origjina e formimit të tyre dhe tiparet e tjera	Çfarë janë liqenet? Si janë formuar ato?	Stuhi mendimesh, klaster, tabele konceptesh.		Teksti i nxënësit fq. 88-90, harta fizike e botës, harta fizike e Shqipërisë, foto dhe skica të tekstit etj.
			Si janë mbushur me ujë gropat e tyre?			
6		Ujërat nëntokësore dhe veprimtaria karstike	Paraqiten para nxënësve foto për secilën nga fjalët kyç.	Parashikimi me terma paraprakë, insert, punë me tekstin.		Teksti i nxënësit fq. 91-93, atlas i gjeografik, foto dhe skica të tekstit etj.
7		Veprimtaria e borës dhe e akujve	Përpara nxënësve paraqitet një fotografi e cila tregon kontinentin e Antarktidës.	Stuhi mendimesh, tabela e koncepteve, diagram i venit..		Teksti i nxënësit fq. 94-96, atlas i gjeografik, foto dhe skica të tekstit etj.

PLANET MËSIMORE TREMUJORE

8		SITUATË E SUGJERUAR 4	Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	Diskutim, punë me grupe, turi i galerisë.		Teksti i nxënësit fq. 98, hartë fizike e botës, atlase, hartë skicë e botës, glob, laps, lapsa me ngjyra, gomë, fletore etj.
		Identifikimi i oqeanëve, deteve dhe gjireve detare kryesore të botës				
9		SITUATË E SUGJERUAR 5 Rrymat oqeanike	Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	Diskutim, punë me grupe, turi i galerisë.		Teksti i nxënësit fq. 99, hartë e shpërndarjes së rrymave oqeanike të botës, atlase, hartë skicë e botës, glob, laps, lapsa me ngjyra, gomë, fletore etj.
10		Projekt: Ndotja mjedisore dhe llojet e saj (ora e dytë)	Organizimi i orës së mësimit dhe veprimtarive qw do tw zhvillohen.	Diskutim, punë me grupe, prezantim.	Vlerësim për realizimin e situatave të sugjeruara	Interneti, teksti i nxënësit, enciklopedi dhe literatura të shkruara etj.
11	Nëntematika 1.2	Ndërtimi i brendshëm i Tokës	Paraqitja e skicës e cila tregon ndërtimin e brendshëm të tokës.	Stuhi mendimesh, shpjegim, tabela e koncepteve.		Teksti i nxënësit fq. 100-102, atlas gjeografi, skicë e ndërtimit të brendshëm të Tokës etj.
12	Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë	Kontinentet dhe formimi i tyre	Paraqitet para nxënësve foto të pozicionit të kontinenteve; a) 250 milion vite më parë, b) 150 milion vite më parë, c) pozicioni aktual i kontinenteve.	Stuhi mendimesh, harta e të pyeturit, punë me hartën.		Teksti i nxënësit fq. 103-105, hartë fizike e botës, hartë e pllakave tektonike, foto dhe skica të tekstit etj.
13		Relievi i kontinenteve si pjesë e relievit të sipërfaqes së Tokës	Nxënësit përshkruajnë peizazhin natyror të mjedisit përreth.	Stuhi mendimesh, ditari tre pjesësh, punë me hartën.		Teksti i nxënësit fq. 106-108, hartë fizike e botës, foto dhe skica të tekstit etj.

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

14	1.2.3 Litosfera 13 (orë)	Format e relievit në kontinente: malet dhe luginat	Nxënësit përshkruajnë format e relievit të mjedisit përreth.	Parashikimi me terma paraprak, klaster, punë me hartën.		Teksti i nxënësit fq. 109-111, hartë e botës, foto dhe skica të tekstit, atlas gjeografik etj.
15		Format e relievit në kontinente: fushat dhe kodrat	Paraqitet përpara nxënësve harta fizike e Shqipërisë.	Stuhi mendimesh, lexim i drejtuar, punë me hartën.		Teksti i nxënësit fq. 112-114, atlas gjeografik, hartë fizike e botës, hartë fizike e Shqipërisë, foto të tekstit etj.
			Nxënësit lokalizojnë shpërndarjen gjeografike të fushave dhe kodrave.			
16		Shkëmbinjtë dhe llojet e tyre	Paraqitet përpara nxënësve foto e një fosili.	Stuhi mendimesh, ditari tre pjesësh, diagram i venit.		Teksti i nxënësit fq. 115-117, foto dhe skica të tekstit etj.
17		Tokat (dherat), faktorët e formimit të tyre	Diskutim mes nxënësish për të shpjeguar konceptin “tokë”.	Stuhi mendimesh, shpjegim, punë me tekstin.	Vlerësim për përforsim njohurish	Teksti i nxënësve fq. 118-120, foto dhe skica të tekstit etj.
18		Tërmetet	Paraqiten pamje filmike të tërmeteve të ndryshme në botë.	Stuhi mendimesh, klaster, punë me hartën.		Teksti i nxënësit fq. 121-123, hartë e botës, atlas gjeografik, foto dhe skica të tekstit, videoprojektor, kompjuter etj.
19		Vullkanet	Paraqitja e një vullkani në një foto.	Stuhi mendimesh, hartë e të pyeturit, klaster.		Teksti i nxënësit fq. 124-126, harta e botës, foto dhe skica të tekstit etj.

PLANET MËSIMORE TREMUJORE

20		Projekt: Vullkanet	Organizimi i orës së mësimi.	Diskutim, punë me grupe, turi i galerisë.		Teksti i nxënësit, interneti, enciklopedi, harta gjeografike, tabakë letre, markera, plastelinë, letër me ngjyrë etj.
			Paraqitja e projektit.			
21		SITUATË E SUGJERUAR 6 Plotësimi i hartës fizike të botës	Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	Diskutim, punë me grupe, turi i galerisë.		Teksti i nxënësit fq. 127, hartë fizike e botës, hartë skicë e botës, atlas, glob, laps, lapsa me ngjyra, gomë, fletore etj.
22		SITUATË E SUGJERUAR 7 Plotësimi i hartës së shpërndarjes gjeografike të tërmeteëve dhe vull- kaneve	Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	Diskutim, punë me grupe, turi i galerisë.		Teksti i nxënësit fq. 127, hartë fizike e botës, hartë skicë e botës, atlas, glob, laps, lapsa me ngjyra, gomë, fletore etj.
23		PËRSËRITJE 4	• Kuptimi i fjalëve kyçe	Bashkëbisedim	Vlerësimi individual	Teksti klasa 7
		(tremujori i dytë)	• Shpjegimi i ideve kryesore për tematikën	Punë e pavarur	për përgjigjet	Hartë
			• Të menduarit kritik	Diskutim	e dhëna	Fotografi
			• Lokalizimi i vendeve	Krahasim i	Vlerësim i punës së pavarur në grup	Internet
				punimeve		
24		TEST (tremujori i dytë)		Punë individuale	Vlerësim individual	Fletë formati
				Të nxënësit e pavarur	i përgjigjeve	

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

PLANI MËSIMOR TREMUJORI III (PRILL-QERSHOR 17 ORË) KLASA VII

FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI LËNDA: GJEOGRAFI

PLANI ANALITIK

PRILL-QERSHOR (16 ORË)

Nr	Tematika	Temat mësimore	Situata e të nxënit	Metodologjia e mësimdhënies	Teknikat e vlerësimit	Burimet
1	Nëntematika 1.2	Mjediset jetësore të brezit të nxehtë	Paraqiten përpara nxënësve foto të fjalëve kyç.	Parashikimi me terma paraprak, tabele konceptesh, shkrimi i lirë.	Vlerësim individual	Teksti i nxënësit fq. 129-132, hartë e mjediseve jetësore të botës, atlas gjeografik, foto të tekstit etj.
	Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë					
	1.2.4 Biosfera 7 (orë)					
					Vlerësim i detyrave të shtëpisë	
					Vlerësim i përgjigjeve me gojë	
					Vlerësim i punës në grup	
					Vlerësim mes nxënësish	
					Vlerësim për prezantimin me gojë	
					Vlerësim i debatit në klasë	
					Vlerësim për vëzhgimet e kryera në terren	

PLANET MËSIMORE TREMUJORE

2		Mjedisi jetësor i brezit mesatar	Lexohet leximi i pjesës së dhënë në tekst	Stuhi mendimesh, tabelë konceptesh, diskutim i lirë.		Teksti i nxënësit fq. 133-135, hartë e mjediseve jetësore të botës, atlas gjeografik, foto të tekstit etj.
3		Mjediset jetësore të brezit të ftohtë	Shpjegimi i termave, pinguin dhe eskimez.	Parashikimi me terma paraprak, tabelë konceptesh, marrëdhëniet pyetje-përgjigje.		Teksti i nxënësit fq. 133-136, hartë e mjediseve jetësore të botës, atlas gjeografik, foto të tekstit etj.
4		Mjediset jetësore mesdhetare dhe mjediset jetësore në zonat malore	Çfarë dini për florën dhe faunën që rriten në Shqipëri?	Stuhi mendimesh, tabelë konceptesh, marrëdhëniet pyetje-përgjigje.	Vlerësim për punët e pavarura	Teksti i nxënësit fq. 137-139, hartë e mjediseve jetësore të botës, atlas gjeografik, foto të tekstit etj.
5		SITUATË E SUGJERUAR 8 Plotësimi i përhapjes gjeografike i mjediseve jetësore të brezit të nxehtë dhe brezit mesatar	Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	Diskutim, punë në grupe, diskutim.		Teksti i nxënësit fq. 142, hartë fizike e botës, hartë skicë e botës, hartë e mjediseve jetësore të botës, atlas, glob, laps, lapsa me ngjyra, gomë, fletore etj.

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

6		SITUATË E SUGJERUAR 9 Plotësimi i përhapjes gjeografike i mjediseve jetësore mesdhetare, malore dhe i mjediseve jetësore të brezit të ftohtë	Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	Diskutim, punë në grupe, diskutim.		SITUATË E SUGJERUAR 9 Plotësimi i përhapjes gjeografike i mjediseve jetësore mesdhetare, malore dhe i mjediseve jetësore të brezit të ftohtë
7		PËRSËRITJE 5: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë-Biosfera	Organizimi i orës së mësimi. Veprimtaritë që do të zhvillohen.	Diskutim, punë me grupe, turi i galerisë.		Teksti i nxënësit fq. 144, atlas gjeografik, hartë fizike e botës, tabakë letre, markera, etj.
8	Tematika 2	Hapësirat bregdetare, si hapësira të jetës njerëzore dhe mbrojtja e tyre	Paraqitja para nxënësve e hartës fizike të Shqipërisë.	Stuhi mendimesh, ditari tre pjesësh, diskutim.	Vlerësim për realizimin e situatave të sugjeruara	Teksti i nxënësit fq. 146-148, hartë fizike e Shqipërisë, foto të tekstit etj.
9	Nëntematika : Shoqëria dhe ndërveprimi me mjedisin	Ndotjet mjedisore	Leximi i pjesës së dhënë në tekst.	Diskutim, kllaster, marrëdhëniet pyetje-përgjigje.		Teksti i nxënësit fq. 149-151, foto të tekstit, informacione të internetit etj.
10	8 (orë)	Ndotja në zonat urbane	Leximi i pjesës së dhënë në tekst.	Stuhi mendimesh, ditari tre pjesësh, diskutim.		Teksti i nxënësit fq. 152-154, foto të tekstit etj.
11		Ndotja në zonat rurale	Krahasim midis zonës urbane dhe zonës rurale.	Stuhi mendimesh, tabelë konceptesh, diskutim.		Teksti i nxënësit fq. 155-157, foto të tekstit etj.
12		Ndërveprimi njeri-mjedis	Trajtimi i mbetjeve të ngurta (MNU)	Parashikimi me terma paraprakë, lexim i drejtuar, punë me tekstin.		Teksti i nxënësit fq. 158-160, foto të tekstit etj.

PLANET MËSIMORE TREMUJORE

13		SITUATË E SUGJERUAR 10	Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	Diskutim, punë në grupe.	Vlerësim për përfundim njohurish	Teksti i nxënësit fq. 143, hartë fizike e botës, hartë skicë e botës, hartë e mjedisve jetësore të botës, atlas, glob, laps, lapsa me ngjyra, gomë, fletore etj.
		Harta e problemeve dhe e zgjidhjeve mjedisore				
14		Projekt: Ndotja mjedisore dhe llojet e saj (ora e tretë)	Paraqitja e produktit (projektit) nga secili grup.	Prezantim.		Interneti, videoprojektor, Power -Point, postera, broshura, fletë palosje, album me fotografi.
15		PËRSËRITJE 6 (Tremujori i Tretë)	• Kuptimi i fjalëve kyçe	Bashkëbisedim	Vlerësimi individual	Teksti klasa 7
			• Shpjegimi i ideve kryesore për tematikën	Punë e pavarur	për përgjigjet	Hartë
			• Të menduarit kritik	Diskutim	e dhëna	Fotografi
			• Lokalizimi i vendeve	Krahasim i punimeve	Vlerësim i punës së pavarur në grup	Internet
16		TEST (Tremujori i Tretë)		Punë individuale	Vlerësim individual	Fletë formati
				Të nxënësit e pavarur	i përgjigjeve	

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Krijimi i Gjithësisë		Situata e të nxënësve: Xhordano Bruno një dijetar i madh i shekullit të XVI. Përse është përmendur ai në këtë temë mësimore?	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përshkruan me fjalët e tekstit se çfarë është Gjithësia. - Rendit disa nga karakteristikat e Diellit. - Shpjegon krijimin e Gjithësisë sipas shkrimeve të shenjta dhe astronomëve. - Përshkruan karakteristikat e Gjithësisë të zbuluar nga Xhordano Bruno.		Koncepte kyçe: Gjithësi , Galaktika jonë, Rruga e Qumështit	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori , Astronomi, Fizikë, Matematikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit, fq. 8-10, hartë e gjithësisë, foto dhe skicat e tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIË E NXËNËSVE

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënësve. Në këtë fazë të mësimimit për të lidhur njohuritë që nxënësit kanë, me temën e re, zhvillohet një stuhi mendimesh me fjalën kyç të mësimimit. Pyeten nxënësit: Çfarë dini për Diellin?



» Mirëpreiten idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i drejtuar

Në këtë fazë të mësimimit përdoret teknika lexim i drejtuar. Nxënësit të ndarë në 2 grupe udhëzohen të lexojnë pjesët përkatëse:

Ndërkohë në tabelë vendosen pyetjet e shkruara më parë nga mësuesi në flipçart.

Grupi 1-Universi dhe Gjithësia

1. Çfarë është Dielli dhe cilat janë karakteristikat e tij?
2. Sa yje ka në Gjithësi?
3. Çfarë është Galaktika?
4. Çfarë është Gjithësia dhe nga çfarë përbëhet ajo?

Grupi 2-Krijimi i Gjithësisë

1. Cilat janë teoritë që shpjegojnë krijimin e Gjithësisë?
2. Cilat janë shpjegimet e astronautëve për krijim e Gjithësisë?
3. Si u krijua Gjithësia sipas librave fetarë?

Përgjigjet e nxënësve plotësohen dhe qartësohen nga mësuesi. Këto përgjigje ilustrohen edhe nëpërmjet hartës së Gjithësisë dhe fotove me ngjyra të tekstit.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim

Në këtë fazë të mësimimit ftohen nxënësit në një diskutim rreth pyetjes:

Cili nga shpjegimet e krijimit të Gjithësisë ju duket më i drejtë? Pse?

» Mirëpreiten idetë dhe mendimet e nxënësve.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimimit dhe dhënies së përgjigjeve të sakta prej tyre.

Detyrat e shtëpisë: Informacion për zbulimet e dijetarëve Nikola Kopernikut, Galileo Galileit, Neil Armstrong për qendrën e sistemit tonë diellor.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Toka në sistemin tonë diellor.		Situata e të nxënësve: Nikola Koperniku, Galileo Galilei, Neil Armstrong janë përmendur në këtë temë mësimore. Cilat janë mendimet e tyre për Tokën dhe pozicionin e saj në Sistemin tonë Diellor?	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përshkruan me pak fjalë sistemin diellor dhe përbërjen e tij. - Rendit sipas largësisë nga dielli tetë planetët e sistemit diellor. - Përcakton pozicionin e Tokës në sistemin diellor. - Vlerëson veprën e Kopernikut si një revolucion në dijet njerëzore.		Koncepte kyçe: Sistemi diellor, rruga e qumështit, pozicioni i tokës.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Fizikë, Matematikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 11-13, harta e gjithësisë, foto dhe skica të tekstit, inf. nga interneti etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënësve. Përpara nxënësve paraqiten fotot e Nikola Kopernikut, Galileo Galileut dhe Neil Armstrong.

Pyeten nxënësit: Përse janë përmendur ata në këtë mësim?

» Mirëpritën mendimet e nxënësve duke evidentuar mendimet më të mira.

Ndërtimi i njohurive të reja: Insert

Në këtë fazë të mësimin përdoret teknika Insert sepse i ndihmon nxënësit të aktivizojnë se çfarë dinë që më parë, të bëjnë parashikime mbi atë që do të lexojnë nëpërmjet pyetjeve që dalin dhe që atyre do t'u pëlqente t'u përgjigjeshin.

U kërkohet nxënësve të lexojnë përmbledhjen dhe ti kategorizojnë njohuritë sipas tabelës së teknikës Insert.

	+	-	?
Informacioni që nxënësit dinë më parë	Informacioni i ri	Informacioni i lexuar është ndryshe nga informacioni që nxënësit dinë	Informacioni i paqartë për nxënësit

» Vlerësime, sugjerime, komente dhe zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim

Në këtë fazë të mësimin nxënësit në një diskutim rreth temës:

Ballafaqoni qëndrimin e dijetarit Ptoleme dhe të dijetarit Nikolla Kopernik, për temën:

"Pozicioni i planetit Tokë në sistemin tonë diellor". Cili është qëndrimi më i saktë sipas mendimit tuaj?

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, përgjigjeve të sakta dhe plotësimit të teknikës Insert

Detyrat e shtëpisë: Rubrika "Mendo në mënyrë kritike". "Ky është një hap i vogël për një njeri, por një hap gjigant për njerëzimin", ka thënë Neil Armsrong. Shpjegoni në një paragraf se si e kuptoni këtë thënie të tij.

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Format e Tokës dhe përmasat e saj.		Situata e të nxënit: Merrni një top dhe një llambë. Llambën imagjinojeni si Diell, që ndriçon Tokën (topin). Çfarë forme ka hija e topit në (Tokë) në mur? Pse?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përcakton formën e Tokës. - Tregon përmasat e Tokës. - Shpjegon se si dijetari grek Eratosteni llogariti perimetrin e Tokës - Tregon në hartë zonat e nxehtësisë		Koncepte kyçe: Forma e Tokës, sferë, gjeoid, përmasat e Tokës, zona të nxehtësisë, eklipsi i Hënës	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Fizikë, Matematikë, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 14-16, hartë e zonave të nxehtësisë, foto dhe skica të tekstit, glob etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Mësuesi realizon në klasë një eksperiment: Merr një top dhe një llambë. Llambën e drejton drejt topit (duke udhëzuar fëmijët të imagjinojnë, (Diellin që ndriçon Tokën)

Pyeten nxënësit: Çfarë formë ka hija e topit "Tokë" në mur? Pse?

» Mirëpritën mendimet dhe idetë e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim

Në këtë fazë të mësimin realizohet teknika e shpjegimit e cila ka si qëllim të ndihmojë nxënësit të kuptojnë se çfarë forme ka Toka dhe përmasat e saj.

Që shpjegimi të jetë i suksesshëm përdoren një varg strategjish si:

- * Teknika e pyetjeve
- * Përdorimi i shembujve
- * Përdorimi i mjeteve mësimore.

Shpjegimi nis me shkrimin në tabelë të temës së mësimin dhe çështjeve kryesore të saj. Shpjegimi shoqërohet me ilustrime para nxënësve nëpërmjet fotografive dhe skicave të tekstit.

TEMA: Forma e Tokës dhe përmasat e saj

- * Forma e Tokës
- * Përmasat e Tokës
- * Rëndësia gjeografike e formës dhe e përmasave të Tokës

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Tabelë konceptesh

Pas shpjegimit të mësimin për të parë shkallën e përvetësimit të njohurive nxënësit të ndarë në grupe plotësojnë tabelën e koncepteve të skicuar në tabelën e zezë nga mësuesi:

Forma e Tokës	Përmasat e Tokës	Rëndësia gjeografike e formës dhe e përmasave të Tokës
Grupi i parë	Grupi i dytë	Grupi i tretë

» Vlerësime, sugjerime, komente dhe zgjidhje problemesh.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, përgjigjeve të sakta dhe plotësimit të tabelës së koncepteve.

Detyrat e shtëpisë: Rubrika "Zgjidhni situatën" (2) Si është klima në zonën ku jetoni dhe mësoni? Pse? Bëni një intervistë me një të moshuar për ta treguar saktë atë.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE


Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Toka, planeti ku jetojmë.		Situata e të nxënësve: Diskutim rreth pyetjes: Çfarë e bën të veçantë planetin Tokë nga planetët e tjerë?	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përshkruan disa nga karakteristikat fizike të Tokës. - Analizon rëndësinë e karakteristikave fizike të saj për jetën në Tokë. - Shpjegon nëpërmjet shembujve ndryshimin e vazhdueshëm të pamjes së Tokës. - Shpjegon nëpërmjet fakteve ndryshimin e planetit Tokë nga planetët e tjerë		Koncepte kyçe: Forca e rëndësës, forca magnetike, pol magnetik, "ikja nga Toka".	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kimi, Biologji, Fizikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 17-19, atlas gjeografik, glob, hartë e botës, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënësve. Zhvillohet një stuhi mendimesh për vjeljen e informacionit që nxënësit kanë rreth temës së mësimi.

Pyeten nxënësit: Çfarë e bën të veçantë planetin Tokë nga planetët e tjerë?



Mirëpriten idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Te nxënësve në bashkëpunim

Në këtë fazë të mësimi duke u mbështetur tek njohuritë që nxënësit kanë rreth kësaj teme përdoret teknika të nxënësve në bashkëpunim.

HAPI I PARË: Cilat janë karakteristikat fizike të Tokës?

- » Si klasifikohen lëndët prej të cilave përbëhet Toka dhe nga se përbëhen ato?
- Çfarë kuptoni me forcë tërheqëse të Tokës?

Po forcë magnetike?


HAPI I DYTË:

- Çfarë e bën të veçantë planetin Tokë nga planetët e tjerë?
- Cilët janë dy elementët kryesorë të

Tokës?

- Pse ndryshon vazhdimisht pamja e Tokës?

Pas përgjigjeve të nxënësve mësuesi plotëson dhe sqaron konceptet kryesore të mësimi.



Demonstrimi i rezultateve të arritura: Klaster

Në këtë fazë të mësimi u kërkohet nxënësve të plotësojnë klasterin e ndërtuar në tabelë nga mësuesi.

Vlerësime, sugjerime, komente dhe zgjidhje problemesh.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimi, dhënies së përgjigjeve të plota e të sakta dhe plotësimit të klasterit.

Detyrat e shtëpisë: Rubrika "Mendo në mënyrë kritike" Pse është e rëndësishme ruajtja e planetit ku jetojmë? Shkruani pesë veprime, që mund të bëni për mbrojtjen e mjedisit natyror ku jetoni.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Rrotullimi i Tokës rreth vetes.		Situata e të nxënit: Para nxënësve tregohen foto të një sateliti artificial, avioni ushtarak dhe një foto të Tokës nga hapësira. Nxënësve u kërkohet të bëjnë lidhjen mes tyre.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Liston provat që tregojnë rrotullimin e Tokës rreth vetes. - Përcakton saktë kohën që i duhet Tokës për të bërë rrotullimin rreth vetes. - Përshkruan rrjedhojat gjeografike të rrotullimit të Tokës rreth vetes.		Koncepte kyçe: Boshti i Tokës, rrymë oqeanike, kohë zonale, kohë lokale.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Matematikë ,Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 20-22,glob, atlas i gjeografik, foto dhe skica të tekstit etj.	



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh


Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Para nxënësve paraqiten foto të një sateliti artificial, avioni ushtarak dhe një foto të Tokës nga hapësira.

Nxënësve u kërkohet të bëjnë lidhjen mes tyre dhe temës së mësimi.


Ndërtimi i njohurive të reja: Harta e të pyeturit

Në këtë fazë të mësimi nxënësit të ndarë në dy grupe udhëzohen të lexojnë mësimin për të plotësuar hartën e të pyeturit duke iu dhënë përgjigje pyetjeve në të.

Grupi i parë



Grupi i dytë:



» Përgjigjet e nxënësve plotësohen dhe shpjegohen nga mësuesi.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me tekstin

Në këtë fazë të mësimi punohet rubrika e tekstit "Mendo në mënyrë kritike".

Nxënësi:

» Përcakton në glob vendin ku është natë, ndërkohë që tek ne është ditë. Pse ndodh kështu?

Pse vende të ndryshme marrin dritë dhe nxehtësi nga Dielli, në kohë të ndryshme?

Pse përdorimi i kohës lokale është më i përshtatshëm se koha zonale?

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimi, plotësimit të hartës së të pyeturit.

Detyrat e shtëpisë: Rubrika "Zgjidhni situatën". Jepni shembuj që tregojnë lidhjen ndërmjet rrotullimit të Tokës rreth vetes dhe gjatësisë së ditës ose të natës.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Rrotullimi i Tokës rreth Diellit, formimi i stinëve.		Situata e të nxënit: Marrja e informacioneve për shpjegimin e fjalëve: verë astronomike, dimër astronomik, ekuinoks, solstic	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përshkruan me pak fjalë treguesit kryesore të rrotullimit të Tokës rreth Diellit. - Tregon në hartë rrugën që përshkon Toka rreth Diellit. - Rendit katër ditët më të rëndësishme të rrotullimit të Tokës rreth Diellit. - Shpjegon me fjalët e tekstit mënyrën e formimit të stinëve. - Përshkruan disa nga pasojat e rrotullimit të Tokës rreth Diellit.		Koncepte kyçe: Eklips, ekuatori i Tokës, plani i ekuatorit të Tokës, ekuinoks, solstic	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, TIK.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti nxënës, fq. 23-25, glob, atlas i gjeografik, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Parashikimi me terma paraprak

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në tabelë shkruhen fjalët kyç të mësimin për të cilat kërkohet një shpjegim nga nxënësit:

Eklips- ekuatori i Tokës- plani i ekuatorit të Tokës- ekuinoks- solstic

Nxënësit japin mendimet e tyre duke bërë kështu lidhjen e njohurive të mëparshme me njohuritë e reja.

Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim

Në këtë fazë të mësimin realizohet teknika e shpjegimit e cila ka si qëllim të ndihmojë nxënësit të kuptojnë se si Toka kryen rrotullimin rreth Diellit dhe cilat janë pasojat e rrotullimit të Tokës rreth Diellit.

Që shpjegimi të jetë i suksesshëm përdoren një varg strategjish si:

- * Teknika e pyetjeve
- * Përdorimi i shembujve
- * Përdorimi i mjeteve mësimore.

Shpjegimi nis me shkrimin në tabelë të temës së mësimin dhe çështjeve kryesore të saj. Shpjegimi shoqërohet me ilustrimet para nxënësve të fotografive dhe skicave të tekstit.

TEMA: Rrotullimi i Tokës rreth Diellit, formimi i stinëve

- Toka rrotullohet rreth Diellit
- Pasojat e rrotullimit të Tokës rreth Diellit

Demonstrimi i rezultateve të arritura:

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Në këtë fazë të mësimin për të parë shkallën e përvetësimit të njohurive të reja përdoret teknika: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

- Përse në çdo katër vjet viti ka 366 ditë?
- Përse Dielli nuk perëndon fare mbi paralelin 66° 33' të Hemisferës Veriore në 22 qershor?

• Çfarë ndodh në këtë datë në Hemisferën Jugore mbi këtë paralel?

- Çfarë ndodh më 21 mars dhe 23 shtator, në të dyja hemisferat e Tokës?

• Çfarë ndodh më 22 qershor dhe 22 dhjetor, në të dyja hemisferat e Tokës?

• Pse rrezet e diellit nuk e ngrohin njëllot Tokën, brenda të njëjtës stinë?

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin dhe dhënies së përgjigjeve të plota e të sakta.

Detyrat e shtëpisë: Rubrika "Mendo në mënyrë kritike". Toka lëviz rreth Diellit. Si ndikon kjo lëvizje në jetën e njerëzve? Pse?

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: SITUATË E SUGJERUAR 1 Trashëgimia gjeografike zbuluar nga hapësira.		Situata e të nxënës: Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: • Përshkruan evoluimin e historisë së fotografimit të sipërfaqes së Tokës nga satelitët. • Përcakton se çfarë është i aftë të bëjë sateliti artificial "Landrat". • Përcakton saktë pamjet e dhëna në tekst të marra nga satelitët. • Demonstron aftësi në përdorimin e TIK-ut.		Koncepte kyçe: Hapësirë, univers, satelitë artificialë, duna me rërë, gropa shkretinore, tokë e thatë, rezervuare naftë etj.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Astronomi, TIK.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 26-27, kompjuter, celular, internet, hartë fizike e Tokës, glob etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Faza e parë. Diskutim

Njihen nxënësit me orën e mësimi dhe veprimtaritë që do të kryen. Në këtë fazë zhvillohet një diskutim i lirë mes nxënësve për evoluimin e historisë së fotografimit të sipërfaqes së Tokës nga satelitët.

Nxënësit përcaktojnë se çfarë është i aftë të bëjë sateliti artificial "Landsat".

Faza e dytë. Punë në grupe

- Klasa do të ndahet në tre grupe.
- Zgjidhen kryetarët e grupeve.
- Secilit grup i jepet një detyrë për ta realizuar.
- *Grupi i parë. Çfarë shikoni në foton 1-alga apo duna me rërë?*
- *Grupi i dytë. Çfarë shikoni në foton 2-gropa shkretëtire apo tokë të thatë?*
- *Grupi i tretë. Çfarë shikoni në foton 3-sipërfaqe toke e thatë apo rezervuare naftë?*

Nxënësit punojnë në grupe për një kohë rreth 20 min. Për realizimin e detyrës nxënësit udhëzohen të përdorin kompjuterin duke vizituar faqet në "Google"

❖ http://cse/ssl/Berkeley/edu/SegayEd/lessons/third_from_sun/index.htm.

Faza e tretë. Prezantim

Në këtë fazë të mësimi nxënësit sipas grupeve paraqesin punët e tyre përpara klasës. Nxënësit u japin përgjigje pyetjeve në bazë të së cilës kanë punuar dhe hulumtuar në internet.

❖ Krahasohen punët midis grupeve duke përcaktuar grupin më të mirë.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të punës në grup, zgjidhjes së situatës së dhënë, paraqitjes dhe interpretimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: PËRSËRITJE 1 Toka në hapësirë.		Situata e të nxënësve: Organizimi i orës së mësimimit. Njohja me veprimtaritë që do të kryen.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Njeh fakte interesante rreth Tokës. - Shpjegon rrotullimin e Tokës rreth Diellit duke përshkruar pasojat e kësaj lëvizjeje. - Përcakton në mënyrë të saktë largësinë e Tokës nga Dielli. - Përshkruan zbulimet e dijetarëve të shquar në astronomi.		Koncepte kyçe: Galaktikë, rruga e qumështit, sistemi diellor, boshti i Tokës, “Landsat”, orbitë, ekuinoks, solstic, kohë zonale, pol magnetik, trupa qiellore.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Astronomi, Fizikë, Matematikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësve fq. 28-30, glob, hartë e Tokës, atlas gjeografik, tabakë letre, markera etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Veprimi 1: Diskutim

Njihen nxënësve me orën e mësimimit dhe veprimtaritë që do të kryhen.

Ftohen nxënësve të lexojnë dhe diskutojnë informacionet e rubrikës “Fakte rreth Tokës”.

Pyeten nxënësve:

- Cilat prej fakteve të lexuara janë të njohura nga ju?
- Cili prej fakteve është më interesante për ju?

Diskutim mes nxënësve: “Mendoni në mënyrë kritike”

- Rrotullimi i Tokës rreth Diellit.

Veprimi 2: Punë në grupe

Nxënësve ndahen në katër grupe të mëdha.

Secilit grup i caktohet si detyrë zgjidhja e një situatë:

Grupi i parë: Largësia e Tokës nga Dielli

Grupi i dytë: Madhësia e Tokës e krahasuar me Hënë.

Grupi i tretë: Toka rrotullohet rreth Diellit.

Grupi i katërt: Dijetarë të shquar.

Secili grup pajiset me mjetet e nevojshme për realizimin e detyrës.

Veprimi 3: Turi i galerisë

Pas përfundimit të punës grupet, nëpërmjet turit të galerisë prezantojnë punën përpara klasës.

- Krahasohen punimet midis grupeve.
- Evidentohen punët më të mira.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimimit, punës në grup, realizimit dhe prezantimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Atmosfera. Rëndësia, përbërja dhe struktura.		Situata e të nxënësve: Çfarë është ajri? Cila është rëndësia e tij për jetën në Tokë?	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përshkruan me pak fjalë se çfarë është atmosfera. - Rendit gazet përbërëse të atmosferës. - Shpjegon se përse temperatura në Tokë nuk është as shumë e lartë dhe as shumë e ulët. - Shpjegon mënyrën e evoluimit të atmosferës. - Ndërton një diagram të thjeshtë për strukturën e atmosferës.		Koncepte kyçe: Atmosferë, troposferë, stratosferë, mezosferë, termosferë, rrezet ultravjollcë	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kimi, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti nxënësit, fq. 31-33, atlas i gjeografik, glob, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënësve. Në këtë fazë të mësimin zhvillohet një stuhi mendimesh me pyetjet:

Çfarë dini për atmosferën?


Çfarë rëndësie ka ajo për jetën në Tokë?



» Mirëpreiten idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Klaster

Në këtë fazë të mësimin përdoret teknika e klasterit. Ftohen nxënësit të lexojnë tekstin ndërkohë që mësuesi ndërton klasterin në tabelën e zezë.



» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Ese

Në këtë fazë të mësimin u kërkohet nxënësve shkrimi i një eseje mbi temën: "Efekti serë".

Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur në shkrimin e esesë duke përshkruar shkaqet dhe pasojat e saj.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, në plotësimin e klasterit dhe shkrimin e esesë.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën: Vizatojeni strukturën e atmosferës, sipas shtresave të saj duke i emërtuar ato.

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Rrezatimi diellor dhe temperatura e ajrit në Tokë.		Situata e të nxënit: Informacione ndihmëse për kuptimin e fjalëve: valë elektromagnetike, veçoritë topografike.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përcakton faktorët që ndikojnë në ndryshimin e atmosferës. - Përshkruan shpërndarjen e energjisë diellore mbi sipërfaqen e Tokës. - Shpjegon se përse Toka e kthen mbrapsht një pjesë të energjisë diellore. - Shpjegon faktorët që përcaktojnë temperaturën.		Koncepte kyçe: Gradient, termik, fotosintezë.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Fizikë, Matematikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 34-36, harta e brezave të ndriçimit, glob, atlas i gjeografik etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Lexohet pjesa e dhënë në tekst në bazë të së cilës u drejtohen pyetjet nxënësve:

Çfarë e bën atmosferën të ndryshojë?

Çfarë është energjia diellore?

Çfarë është rrezatimi diellor?

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e koncepteve

Në këtë fazë të mësimit përdoret teknika tabela e koncepteve. Udhëzohen nxënësit të ndarë në tre grupe të lexojnë më vëmendje pjesët përkatëse të tekstit për të plotësuar tabelën.

Grupi i parë:

Faktorët nga të cilët varet këndi i rënies së rrezeve të Diellit			
Forma sferike e Tokës	Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të vet	Pjerrësia e boshtit të Tokës	Veçoritë e relievit

Grupi i dytë:

Brezat e ndriçimit		
Brezi i nxehtë	Brezi mesatar	Brezi i ftohtë

Grupi i tretë:

Faktorët që përcaktojnë temperaturën			
Gjerësia e ndryshme gjeografike	Lartësia mbi nivelin e detit	Shpërndarja midis tokës dhe detit	Prania e bimësisë

» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me tekstin

Nxënësit punojnë me rubrikën e tekstit "Mendo në mënyrë kritike".

"Toka ngrohet dhe ftohet më shpejt, ndërsa uji ngrohet dhe ftohet më ngadalë". Pse është e rëndësishme kjo? Shkruani argumentet tuaja në tri fjali dhe diskutojini në klasë.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimit dhënies së përgjigjeve të sakta, plotësimit të tabelës së koncepteve.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Pse majat e maleve të larta kanë borë edhe në stinën e verës?

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Lagështira e ajrit.		Situata e të nxënit: Ndër elementët që përbëjnë atmosferën janë edhe avujt e ujit, e cila njihet me termin: Lagështi e ajrit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: • Përshkruan se çfarë është lagështia në ajër. • Përcakton treguesit e matjes së saj. • Demonstron të kuptuarit e koncepteve të lagështisë absolute dhe lagështisë relative. • Përcakton dy faktorët që bëjnë të mundur ndryshimin e lagështisë relative.		Koncepte kyçe: Kufiri i ngopjes, lagështirë relative, lagështirë absolute, igrometër, igrograf.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kimi, Matematikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 37-39, fotografitë dhe skicat e tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në këtë fazë të mësimin zhvillohet një stuhi mendimesh rreth pyetjes:

Çfarë kuptoni me termin lagështi e ajrit

» Mirëpreiten idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim

Në këtë fazë të mësimin realizohet teknika e shpjegimit e cila ka si qëllim të ndihmojë nxënësit të kuptojnë lagështinë absolute, lagështinë relative dhe teknikat e matjes së saj.

Që shpjegimi të jetë i suksesshëm përdoren një varg strategjish si:

- Teknika e pyetjeve
- Përdorimi i shembujve
- Përdorimi i mjeteve mësimore.

Shpjegimi nis me shkrimin në tabelë të temës së mësimin dhe çështjeve kryesore të saj. Shpjegimi shoqërohet me ilustrimet para nxënësve të fotografive dhe skicave të tekstit.

Tema: Lagështia e ajrit

- Lagështia absolute dhe kufiri i ngopjes
- Lagështia relative
- Teknikat e matjes së lagështisë

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me tekstin

Në këtë fazë nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur me ushtrimin e tekstit:

Punoni me diagramin. “Vëzhgoni figurën 1. Përshkruani në katër fjali se çfarë dukurie ndodh aty”.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, në dhënien e përgjigjeve të sakta.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën: Vëzhgoni diagramet 1, 2, mbi ndryshimin e lagështisë relative të ajrit. Vizatoni nga një të ngjashëm, por me të dhëna të tjera. Titulloni secilën prej tyre.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Trysnia atmosferike.		Situata e të nxënit: Ajri është i tejdukshëm, ai përbëhet nga molekula gazesh të ndryshme. Për këtë shkak ai ka peshën e vet të përcaktuar nga forca tërheqëse e Tokës.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e konceptit për trysinë atmosferike. - Përcakton teknikat e matjes së trysnisë atmosferike. - Rendit faktorët që përcaktojnë trysinë atmosferike. - Shpjegon me fjalët e tekstit se çfarë është izobari. - Përcakton zonat me tryzni të ndryshme në një hartë të izobareve.		Koncepte kyçe: Trysni atmosferike, barometër, izobare.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Fizikë, Kimi, Matematikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 40-42, barometër, foto dhe skica të tekstit, atlas i gjeografik etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh


Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Lexohet pjesa e dhënë në tekst në bazë të së cilës nxënësit do ti japin përgjigje pyetjes:

Çfarë është trysnia atmosferike?

» Përgjigjet e nxënësve plotësohen nëpërmjet përkufizimit të dhënë nga mësuesi.

Ndërtimi i njohurive të reja: Klaster

Në këtë fazë të mësimin përdoret teknika e klasterit. Udhëzohen nxënësit të lexojnë me vëmendje mësimin ndërkohë që mësuesi ndërton klasterin në tabelë, të cilën e plotësojnë së bashku.



Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me tekstin

Në këtë fazë të mësimin merret një hartë e izobareve të Shqipërisë. Nxënësit do të përcaktojnë në hartë izobaret që tregojnë tryzni të lartë dhe izobaret që tregojnë tryzni të ulët.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, dhënies së përgjigjeve të sakta, plotësimit të klasterit.

Detyrat e shtëpisë: Lidheni me matematikën: Vendoseni veten në rolin e një alpinisti. Jeni duke u ngjitur në malin e Jezercës. Ju kërkoni të dini se sa mb do të ulet trysnia atmosferike kur të mbërrini në majën e tij. Barometrin nuk e keni marrë me vete, por ju e dini se trysnia atmosferike në çdo 11 m lartësi ulet me 1 mb. Mali i Jezercës është 2694m i lartë. Sa mb është ulur trysnia atmosferike në majën e malit të Jezercës, në raport me nivelin e detit?

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Retë.		Situata e të nxënit: Nëse në një masë ajri të ngopur me avuj uji, sasia e avujve rritet edhe më shumë, atëherë ndodh kondensimi i avullit të tepërt. Kondensimi është kalimi i ujit nga gjendja e gaztë në atë të lëngët. Kështu krijohen retë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përcakton shkaqet e formimit të reve. - Tregon se deri në çfarë lartësie formohen retë. - Rendit llojet e ndryshme të reve. - Shpjegon dukurinë e rënies së breshrit.		Koncepte kyçe: Kondensim, retë e lartësive mesatare, mjegull.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kimi, Matematikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësve fq. 43-45, atlas gjeografik, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Lexohet pjesa e dhënë në libër për të përcaktuar më mirë mënyrën e formimit të reve.

Pyeten nxënësit:

- Çfarë janë retë?
- Si formohen ato?



» Mirëpreiten mendimet dhe idetë e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e koncepteve

Në këtë fazë të mësimit përdoret teknika tabela e koncepteve ku nxënësit udhëzohen të lexojnë me vëmendje mësimin për plotësimin e saj.

Retë		
Mekanizmi i krijimit të reve	Përbërja e reve	Llojet e reve

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim

Në këtë fazë të mësimit ftohen nxënësit në një diskutim mes tyre rreth temës:

Kur tejkalohe ngopja, lagështia relative tenton të kalojë vlerën 100%. Kjo bën që një pjesë e avullit të pranishëm në ajër të dalë i tepërt dhe kështu fillon kondensimi.

Si e kuptoni ju këtë dukuri?

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimit dhënies së përgjigjeve të sakta dhe plotësimin të tabelës së koncepteve.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Si ndikojnë retë në dukuritë tokësore?

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Era.		Situata e të nxënit: Juve mund t'ju ketë rastisur të ndjeni erën që fryn në bregdet gjatë verës. Era është masë ajri që zhvendoset nga një vend ku trysnia atmosferike është më e lartë drejt një vendi ku trysnia atmosferike është më e ulët.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e konceptit të erës dhe formimit të saj. - Përshkruan llojet e ndryshme të erërave. - Përcakton drejtë shkaku të krijimit të musoneve. - Rendit mjetet matëse të erës.		Koncepte kyçe: Erë, brizë, anemometër, musone.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Matematikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 46-48, atlas i gjeografik, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Parashikimi me terma paraprakë Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në tabelë shkruhen fjalët e mëposhtme, për të cilat u kërkohet nxënësve nga një shpjegim.

Erëra të përhershme

Erëra periodike

Erëra të ndryshme

» Mendimet e nxënësve plotësohen dhe qartësohen nga mësuesi.

Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim

Në këtë fazë të mësimin realizohet teknika e shpjegimit e cila ka si qëllim të ndihmojë nxënësit të kuptojnë llojet e erërave, qarkullimin e përgjithshëm të ajrit dhe tiparet e erërave.


Që shpjegimi të jetë i suksesshëm përdoren një varg strategjish si:

- » Teknika e pyetjeve
- » Përdorimi i shembujve
- » Përdorimi i mjeteve mësimore.

Shpjegimi nis me shkrimin në tabelë të temës së mësimin dhe çështjeve kryesore të saj. Shpjegimi shoqërohet me ilustrimet para nxënësve të fotografive dhe skicave të tekstit.

Tema: Era

- » Llojet e erërave
- » Qarkulli i përgjithshëm i ajrit në planet




» Tiparet e erërave dhe mjetet matëse

Shpjegimi i mësimi realizohet nëpërmjet ilustrimeve nga fotografitë dhe skicat e tekstit.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur

Ndërtohet në tabelë nga mësuesi trëndafili i erës.

Fig.1a- Trëndafili vjetor i erës për Shkodrën
($Q=60.7\%$, shpejtësia= 1.8m/s)



Nxënësit duke u mbështetur tek skica e ndërtuar nga mësuesi i trëndafilit të erës përcaktojnë elementët e erës (shpejtësi, drejtim). Përfundimet diskutohen mes nxënësve.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimi, përgjigjeve të sakta, interpretimit të trëndafilit të erës.

Detyrat e shtëpisë: Mendoni në mënyrë kritike: “Nëse Toka nuk do të rrotullohej, çfarë do të ndodhte në atmosferë me qarkullimin e ajrit”? Shkruajeni mendimin tuaj në dy fjali.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Reshjet.		Situata e të nxënësve: Çfarë kuptoni me termin reshje? Si formohen reshjet? Cilat janë llojet e reshjeve që bien në vendbanimin tuaj?	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përshkruan me pak fjalë mënyrën se si formohen reshjet. - Përcakton llojet e reshjeve sipas mënyrës së formimit të tyre. - Analizon rolin pozitiv të reshjeve në jetën e njeriut. - Shpjegon me fjalët e tekstit regjimin shumëvjeçar të reshjeve.		Koncepte kyçe: Kondensim, sublimim, pluviometër.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Kimi, Matematikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 49-51, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënësve. Në këtë fazë zhvillohet një stuhi mendimesh rreth pyetjeve:


1. Çfarë janë reshjet?
2. Si formohen ato?
3. Cilat janë llojet e reshjeve që bien në vendbanimin tuaj?



» Mirëpreiten mendimet dhe idetë e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Harta e të pyeturit

Në këtë fazë të mësimin zhvillohet teknika harta e të pyeturit. Udhëzohen nxënësit të lexojnë me vëmendje mësimin ndërkohë që mësuesi vendos në tabelë pyetjet e përgatitura me parë në flipçart.



Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me tekstin

Nxënësit punojnë me rubrikën e tekstit “Mendo në mënyrë kritike”.

Shkruani nga një fjalë për dëmet që mund t’i shkaktojë njeriut, shiu, bora, breshëri.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin dhënies së përgjigjeve të sakta prej tyre.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. “Ne Shqipëri sasia vjetore e reshjeve shkon nga 600 mm në vit në zonën e Korçës, deri në 3100 mm në vit në Bogë të Alpeve Shqiptare”. Sa është sasia mesatare vjetore e reshjeve?

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Moti dhe klima		Situata e të nxënit: Vështroni nga dritarja e klasës tuaj. Si është moti sot, mot i mirë apo mot i keq? Përshkruajini këto dy terma duke u ndalur në përshkrimin shkurtimisht të elementëve atmosferik si: temperatura e ajrit, trysni atmosferike, erë dhe reshje.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e koncepteve për motin dhe klimën. - Vlerëson rëndësinë e parashikimit të motit. - Përshkruan elementët që përcaktojnë klimën. - Shpjegon faktorët që përcaktojnë tiparet e ndryshme të një brezi klimatik.		Koncepte kyçe: Satelitë meteorologjike, harta sinoptike.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Matematikë, Fizikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 52-54, termometër, hartë klimatike e botës, atlas i gjeografik etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në tabelë shkruhen termat e mëposhtme për të cilat u kërkohet nxënësve ti përshkruajnë ato:

Mot i mirë

Mot i keq

» Mirëpriten idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e koncepteve

Në këtë fazë të mësimin udhëzohen nxënësit të ndare në grupe, të lexojnë me vëmendje pjesët përkatëse për të plotësuar tabelën e koncepteve.

Grupi i parë:

Moti dhe elementët e tij	Stacionet meteorologjike	Satelitët meteorologjike

Grupi i dytë:

Klima	Faktorët që ndikojnë në formimin e klimës			
	Afërsia me sipërfaqet ujore	Lartësia mbi nivelin e detit	Drejtimi i lëvizjes së masave ajrore	Rrymat oqeanike

» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diagrami i venit

Në këtë fazë të mësimin nxënësit udhëzohen të plotësojnë diagramin e venit. Nxënësit bëjnë krahasimin midis motit dhe klimës duke përshkruar karakteristikat e përbashkëta dhe të veçanta midis tyre.

Moti	Të përbashkëtat	Klima
Të veçantat		Të veçantat

Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, plotësimit të tabelës së koncepteve dhe diagramit të venit.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Përshkruani:

1. Një stacion meteorologjik, satelitë meteorologjike.

Faktorët që përcaktojnë tiparet e ndryshme të një brezi klimatik.

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Atmosfera dhe problemet mjedisore të shkaktuara nga njeriu.		Situata e të nxënit: Çfarë di për efektin serë? Cilat janë pasojat mbi sipërfaqen e Tokës?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Shpjegon se çfarë është ndotja atmosferike. - Përcakton një nga burimet më të rrezikshme vdekjeprurëse të ndotjes së ajrit në Shqipëri. - Evidenton pasojat që vijnë nga hollimi i shtresës së ozonit stratosferik.		Koncepte kyçe: “smog”, emetime acide, acidifikim, burim energjetik “i ripërtëritshëm”.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kimi, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 55-57, informacione nga interneti, atlas gjeografik etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Parashikimi me terma paraprak Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në tabelë shkruhen termat e mëposhtme. Nxënësve u kërkohet nga një shpjegim për secilën prej tyre duke bërë lidhjen me mësimin.

Shtresa e ozonit	Smog	Efekti serë	Shiu acid	Energjitë e ripërtëritshme
------------------	------	-------------	-----------	----------------------------

» Mirëpritën idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Të nxënit në bashkëpunim

Në këtë fazë të mësimin duke u mbështetur tek njohuritë paraprake të nxënësve realizohet teknika e të nxënit në bashkëpunim.

HAPI I PARË:

- Çfarë kuptoni me termin ndotje atmosferike?
- Cilët janë faktorët që ndikojnë në shtimin e ndotjes atmosferike?
- Cili është një nga burimet më të rrezikshme vdekjeprurëse të ndotjes së ajrit në Shqipëri?
- Çfarë është shiu acid? Cilat janë pasojat e tij?

HAPI I DYTË:

Ç’dukuri ndodh që shtohet rrezatimi i rrezikshëm ultravjollcë, i cili mbërrin nga Dielli në Tokë?

- Cilët janë faktorët që ndikojnë në hollimin e shtresës së ozonit?
- Cilat janë pasojat që vijnë nga hollimi i shtresës së ozonit?

HAPI I TRETË:

- Çfarë kuptoni me termin “burime të ripërtëritshme”?
- Cilat janë disa nga burimet e ripërtëritshme?

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim i lirë

Në këtë fazë të mësimin ftohen nxënësit në një diskutim të lirë rreth pyetjes:

Çfarë rruge mund të përdorim për të frenuar ndryshimet klimatike?

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, përgjigjeve të sakta të dhëna prej tyre dhe pjesëmarrjes në diskutim.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. “Smogu ka pasoja të rënda në shëndetin e njeriut”.

Jepni shembuj që tregojnë lidhjen ndërmjet smogut dhe shëndetit të njeriut.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: SITUATË E SUGJERUAR 2 Shtresat e atmosferës.		Situata e të nxënësve: Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Rendit dhe vizaton shtresat e atmosferës. - Përshkruan veçoritë kryesore të shtresave të atmosferës. - Përcakton saktë ndryshimin e shtresave të atmosferës nga njëra tjetra.		Koncepte kyçe: Atmosferë, troposferë, stratosferë, mezosferë, termosferë,	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK, Arte pamore.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 58, foto e shtresave të atmosferës, glob, karton, markera, ngjyra etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Faza e parë: Diskutim

Njihen nxënësit me orën e mësimi dhe veprimtaritë që do të kryen. Në këtë fazë zhvillohet një diskutim i lirë mes nxënësve për atmosferën, rëndësinë e saj për jetën në Tokë.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Cila është shtresa e parë më afër Tokës?
- Cila është shtresa që përmban edhe “shtresën e ozonit”?
- Cilat janë shtresat e tjera të atmosferës?

Faza e dytë: Punë në grupe

- Klasa ndahet ne grupe me nga 4 anëtarë.
- Zgjidhet kryetari i grupit.
- Ndahen detyrat brenda grupit.

Në karton nxënësit udhëzohen të vizatojnë një glob dhe përreth globit shtresat e atmosferës, duke pasur parasysh:

- Vendosjen e tyre sipas radhës.
- Lartësisë së tyre duke pasur parasysh ndryshimin e trashësisë së troposferës në Pole dhe Ekuator.

Faza e tretë: Turi i galerisë

Në këtë fazë të mësimi grupet nëpërmjet turit të galerisë paraqesin punët e tyre para klasës.

- Krahasohen punët midis grupeve.
- Përcaktohet puna më e mirë midis grupeve.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të punës në grup, realizimit dhe interpretimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: SITUATË E SUGJERUAR 3 Zonat e ndriçimit dhe temperatura e ajrit në planet.		Situata e të nxënësve: Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përcakton tre brezat e ndriçimit. - Përshkruan veçoritë e secilës prej tyre. - Shpjegon faktorët që ndikojnë në formimin e brezave të ndriçimit.		Koncepte kyçe: Breza të nxehtësisë, zonë e nxehtë, zonë mesatare, zonë e ftohtë.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Art pamor, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 59, foto e brezave të ndriçimit, glob, karton, markera, ngjyra etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Faza e parë: Diskutim

Njihen nxënësit me orën e mësimi dhe veprimtari të që do të kryen. Në këtë fazë zhvillohet një diskutim i lirë mes nxënësve për brezat e ndriçimit, faktorët e formimit të tyre.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Ku ndodhet zona e nxehtë?
- Në cilën gjerësi gjeografike?
- Ku ndodhet zona mesatare veriore?
- Ku ndodhet zona mesatare jugore?
- Ku ndodhet brezi polar verior dhe brezi polar jugor?

Faza e dytë: Punë në grupe

- » Klasa ndahet në grupe me nga 4 anëtarë.
- » Zgjidhet kryetari i grupit.
- » Ndahen detyrat brenda grupit.

Në një karton nxënësit udhëzohen të vizatojnë një glob duke vendosur vijëzimet e brezave të ndriçimit duke pasur parasysh:

- Ngjyrosjen me ngjyra të ndryshme secilin brez të nxehtësisë.
- Për secilin brez të nxehtësisë shkruajnë arsyet që e përcaktojnë atë si të tillë.

Faza e tretë: Turi i galerisë

Në këtë fazë të mësimi grupet nëpërmjet turit të galerisë paraqesin punët e tyre para klasës.

- » Krahason punët midis grupeve.
- » Përcaktohet puna më e mirë midis grupeve.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të punës në grup, realizimit dhe interpretimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: <i>Projekt: Ndotja mjedisore dhe llojet e saj.</i> <i>(ora e parë)</i>		Situata e të nxënësve: Organizimi i veprimtarive të nxënësve për realizimin e projektit.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Hulumton dhe vëzhgon nga burime të ndryshme mbi ndotjen e mjedisit në vendbanimin e tij. - Ndërton njohuri mbi mjedisin lokal mbi llojet e ndotjes së tij. - Grumbullon, sintetizon, analizon dhe vlerëson të dhënat dhe zhvillon një përfundim apo një gjetje kyç mbi ndotjen e mjedisit lokal.		Koncepte kyçe: Ndotja e mjedisit, ndotja e ajrit, ndotja e tokës, ndotja e ujit.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Matematikë, Fizikë, Biologji, Qytetari		Burimet dhe mjetet mësimore: Internet, teksti i nxënësit, enciklopedi dhe literatura të ndryshme, vëzhgime në terren, fotografi etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

FAZA E PARË (ora e parë)

Veprimi 1:

Prezantohet tema e projektit para nxënësve dhe rezultatet e të nxënësve të projektit.

Sqarohen nxënësit për veprimtaritë mësimore që do të zhvillohen në çdo fazë, afatet kohore dhe për produktet e pritshme.

Miratohen së bashku me nxënësit tematikat që do të trajtohen nga gjeografia 7, kryesisht kapitulli 6 dhe tema të veçanta nga kapitulli i atmosferës, litosferës dhe hidrosferës.

Bëhet ndarja e punës në grupe, caktimi i kryetarëve dhe ndarja e detyrave.

Veprimi 2:

Caktimi i detyrave për secilin grup.

Grupi i parë: Shkaktarët kryesorë të ndotjes së ajrit, dukuritë dhe efektet që lë ndotja e ajrit në botën e gjallë.

Grupi i dytë: Format kryesore të ndotjes së Tokës dhe pasojat e saj. Rreziku dhe mundësitë e zgjidhjes së problemeve.

Grupi i tretë: Llojet e ndotjes së ujit dhe pasojat e ndotjes së tij.

Grupi i katërt: Rrugët që më mund të ndjekim për parandalimin dhe minimizimin e ndojës mjedisore.

Veprimi 3:

Marrja e mendimit brenda grupit (kutia e sugjerimeve, anketim, diskutim).

Shpallja e vendimit dhe hartimi i planit të veprimtarive.

Vlerësimi:

Detyrat e shtëpisë: Udhëzime për plotësimin e punës në projekt për orën e ardhshme.


Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: PËRSËRITJE 2 Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë – Atmosfera		Situata e të nxënit: Organizimi i orës së mësimi. Veprimtaritë që do të zhvillohen.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Rendit dhe vizaton shtresat e atmosferës. - Përshkruan veçoritë kryesore të shtresave të atmosferës. - Përcakton saktë ndryshimin e shtresave të atmosferës nga njëra tjetra.		Koncepte kyçe: Atmosferë, troposferë, stratosferë, mezosferë, termosferë, ekzosferë.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Art pamor, Kimi.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 60, foto të tekstit, tabakë letre, markera etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Veprimi 1:: Diskutim

Njohja e nxënësve me orën e mësimi dhe veprimtaritë që do të kryhen.

Diskutim mes nxënësish rreth njohurive të marra në mësimet e tematikës “Atmosfera”.



» Skema plotësohet hap pas hapi me përgjigjet e nxënësve.

Veprimi 2: Punë në grupe

Nxënësit ndahen në pesë grupe të mëdha.

Secilit grup i caktohet një detyrë:

Grupi i parë: Troposfera

Grupi i dytë: Stratosfera

Grupi i tretë: Mezosfera

Grupi i katërt: Termosfera

Grupi i pestë: Ekzosfera

Secili grup pajiset me mjetet e nevojshme për realizimin e detyrës.

Veprimi 3: Turi i galerisë

Pas përfundimit të punës grupet, nëpërmjet turit të galerisë prezantojnë punën përpara klasës.

- Krahasohen punimet midis grupeve.
- Evidentohen punët më të mira.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimi, punës në grup, realizimit dhe prezantimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Hidrosfera dhe lidhja e saj me sferat e tjera të gjeosistemit.		Situata e të nxënit: Çfarë është hidrosfera? Çfarë rëndësie ka ajo për jetën në Tokë?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Rendit katër sferat e Tokës. - Përshkruan me fjalët e tekstit se çfarë është hidrosfera. - Përshkruan format e shfaqjes së ujit në Tokë. - Përcakton disa nga vetitë e ujit.		Koncepte kyçe: Hidrosferë, biotik, abiotik, "sfera" të Tokës, gjendje fizike e ujit, veti të ujit.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kimi, Biologji, Fizikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 61-63, atlas i gjeografik, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Ftohen nxënësit në një stuhi mendimesh rreth pyetjeve:



- Cilat janë katër sferat e Tokës?
- Çfarë është hidrosfera?
- Çfarë rëndësie ka ajo për jetën në Tokë?

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e koncepteve

Në këtë fazë të mësimi nxënësit të ndarë në grupe udhëzohen të lexojnë me vëmendje pjesët përkatëse të tekstit për të plotësuar tabelën e koncepteve.

Hidrosfera		
Hidrosfera dhe rëndësia e saj për jetën në Tokë	Gjendja e ujit në Tokë	Vetitë e ujit në Tokë

» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim i lirë

Në këtë fazë të mësimi ftohen nxënësit në një diskutim të lirë rreth pyetjeve:

- Përse gjatë stinës së dimrit, në temperaturat nën 0°C, mund të ndodh çarja e tubave të ujit?
- Përse në natyrë rrallë mund të gjendet ujë i pastër? Me cilin veti të ujit lidhet ky fakt?


Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimi, dhënies së përgjigjeve të sakta dhe plotësimit të tabelës së koncepteve.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Mblidhni të dhëna dhe argumentoni përse uji është një e mirë më vlerë, e cila duhet ruajtur dhe mirë menaxhuar?

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Qarkullimi i ujit në natyrë.		Situata e të nxënit: Paraqitet para nxënësve një skemë e qarkullimit të ujit në natyrë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Shpjegon termin “Qarkullimi i ujit në natyrë”. - Demonstron nëpërmjet një skice të thjeshtë qarkullimin e ujit në natyrë. - Tregon në hartë shpërndarjen gjeografike të oqeanëve në hartën e Botës.		Koncepte kyçe: Avullim, evapotranspirim, kondensim, ujë i ëmbël, infiltrim, rrjedhje ujore, sipërfaqësore.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kimi, Fizikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 64-65, fotot dhe skicat e tekstit, hartë politike e botës etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:


Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Parashikim me terma paraprak Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në tabelë shkruhen fjalët kyç të skicës së paraqitur në tekstin e nxënësit.



Kërkohet nga nxënësit të japin kuptimin për këto fjalë duke i lidhur me temën e mësimi.

Ndërtimi i njohurive të reja: Klaster

Në këtë fazë të mësimi udhëzohen nxënësit të lexojnë me vëmendje mësimin për të plotësuar së bashku klasterin e ndërtuar nga mësuesi në tabelën e zezë.



Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim

Duke vlerësuar informacionin nga mësimi i kaluar, ftohen nxënësit të vëzhgojnë me kujdes figurën 3 dhe të analizojnë shpërndarjen e ujërave të ëmbla dhe të kripura; të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore. Si ndikon kjo shpërndarje në shoqërinë moderne?

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimi, përgjigjeve të sakta dhe plotësimit të klasterit.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Duke përdorur kompetencën digjitale, nëpërmjet internetit, mblidhni informacione dhe gjeni fakte rreth: “Përse duhet ta përshtatni Tokën si një planet ujor?”.


MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Oqeanet dhe detet.		Situata e të nxënit: Përse Toka njihet si planet blu?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e koncepteve “hemisferë ujore”, “hemisferë tokësore”. - Tregon në hartë oqeanet e planetit tonë duke i renditur sipas madhësisë. - Përkufizon termin det. - Përshkruan llojshmërinë e deteve.		Koncepte kyçe: Oqean, det, gji detar.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Kimi.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 67-69, atlas gjeografik, harta politike e botës, fotot dhe skicat e tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në këtë fazë të mësimin ftohen nxënësit në një stuhi mendimesh rreth fjalës:



» Skema plotësohet hap pas hapi me përgjigjet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Insert

Në këtë fazë të mësimin përdoret teknika insert sepse i ndihmon nxënësit të aktivizojnë se çfarë dinë që më parë, të bëjnë parashikime mbi atë që do të lexojnë nëpërmjet pyetjeve që dalin dhe që atyre do t'u pëlqente t'u përgjigjeshin.

U kërkohet nxënësve të lexojnë përmbledhjen dhe ti kategorizojnë njohuritë sipas tabelës së teknikës Insert.

	+	-	?
Informacioni që nxënësit dinë më parë	Informacioni i ri	Informacioni i lexuar është ndryshe nga informacioni që nxënësit dinë	Informacioni i paqartë për nxënësit

» Vlerësime, sugjerime, komente dhe zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë e pavarur

Nxënësit udhëzohet të punojnë në mënyrë të pavarur me hartën politike të Botës për të plotësuar:

- Përcakton vendndodhjen e oqeanëve.
- Evidenton dete, gjiret kryesore të secilit oqean.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, plotësimit të tabelës insert dhe përdorimit të hartës.

Detyrat e shtëpisë: Mendoni në mënyrë kritike: Vëzhgoni globin, në të dy polet e tij, duke iu referuar poleve dhe rrathëve polarë arktikë dhe antarktikë. Shkruani se çfarë vini re dhe krahasoni informacionin e gjetur.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Veçoritë e ujit të deteve dhe oqeanëve.		Situata e të nxënësve: Në Detin e Vdekur njerëzit qëndrojnë mbi ujë edhe pa notuar. Pse?	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Dallon karakteristikat fizike të ujit të deteve dhe oqeanëve. - Shpjegojnë karakteristikat fizike të deteve si kripësia, temperatura dhe densiteti. - Përcaktojnë ndryshimin e kripësisë së ujit të oqeanëve sipas gjerësisë gjeografike. - Shpjegojnë nëpërmjet skicës zonat batimetrike të relievit të fundit të oqeanëve.		Koncepte kyçe: Kripësi e ujit të deteve, temperaturë e ujit të deteve, densiteti i ujit të deteve, zonë litorale (bregdetare), shpati kontinental.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kimi, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësve fq. 70-72, hartë e botës, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Parashikimi me terma paraprak Nxënësist njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënësve. Në tabelë shkruhen fjalët e mëposhtme, për të cilat u kërkohet nxënësve një shpjegim dhe lidhjen e tyre me temën e mësimi.

Kripësi

Temperaturë

Densitet

» Mirëprehen idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim

Në këtë fazë të mësimi realizohet teknika e shpjegimit e cila ka si qëllim të ndihmojë nxënësist të kuptojnë karakteristikat fizike të deteve: kripësia, temperatura, densiteti dhe relievin e zonat batimetrike të deteve dhe të oqeanëve .

Që shpjegimi të jetë i suksesshëm përdoren një varg strategjish si:

- Teknika e pyetjeve
- Përdorimi i shembujve
- Përdorimi i mjeteve mësimore.

Shpjegimi nis me shkrimin në tabelë të temës së mësimi dhe çështjeve kryesore të saj. Shpjegimi shoqërohet me ilustrimet nëpërmjet hartës së Botës dhe fotografive dhe skicave të tekstit.

Tema: Veçoritë e ujit të deteve dhe të oqeanëve

- Karakteristikat fizike të deteve: kripësia, temperatura, densiteti.
- Relievi dhe zonat batimetrike të deteve dhe të oqeanëve.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me tekstin

Vëzhgoni hartën e deteve dhe të gjireve detare kryesore nga mësimi i kaluar dhe përgjigjuni pyetjeve:

- Ku ndodhen Deti i Kuq, Deti Baltik, Gjiri Persik, Deti i Vdekur?
- Pjesë e cilave oqeanë janë ato?
- Përse kripësia paraqitet në vlera ekstreme në këto dete?

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimi, përgjigjeve të sakta të tyre.

Detyrat e shtëpisë: Mendoni në mënyrë kritike. Nën kujdesin e të rriturve (mësues ose prindër), ngrohni një enë me ujë deri në 90°C. Më pas lëreni ujin të ftohet dhe matni temperaturën e tij çdo 5 minuta për rreth gjysmë ore. Përsëriteni veprimin, por në vend të ujit përdorni rërë. Të dhënat shprehini në një grafik.

Analizoni grafikët për të treguar se si uji ngrohet dhe ftohet në krahasim me tokën (rërën në rastin tonë). Pse ndodh kjo?

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Lëvizja e ujit të oqeanëve dhe deteve (baticë-zbatica, valët detare).		Situata e të nxënësve: Përpara nxënësve shfaqen sekuenca filmike që tregojnë valët cunami të ndodhura në Japoni më 11 mars 2011.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Demonstron të kuptuarit e koncepteve baticë-zbaticë dhe valë detare. Përcakton faktorët që ndikojnë në formimin e tyre. Përshkruan pasojat e veprimit të baticë-zbaticave në brigjet detare. Analizon masat e mara nga njeriu për të shmangur pasojat negative të valëve cunami.		Koncepte kyçe: Baticë, zbaticë, valë detare, cunami, sistem i paralajmërimit të hershëm.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Matematikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 73-75, f foto dhe skica të tekstit, hartë e botës, videoprojektor, kompjuter etj.	

METODOLOGJIA DHE

VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënësve. Përpara nxënësve shfaqen sekuenca filmike që tregojnë valët cunami të ndodhura në Japoni më 11 mars 2011.

Pyeten nxënësit:

1. Çfarë patë në këto pamje filmike?
2. Si formohen valët cunami?
3. Çfarë pasojash sjellin ato?

Mirëpritën mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i drejtuar

Në këtë fazë të mësimi përdoret teknika lexim i drejtuar. Nxënësit të ndarë në 2 grupe udhëzohen të lexojnë pjesët përkatëse:

Ndërkohë në tabelë vendosen pyetjet e shkruara më parë nga mësuesi në flipçart.

Grupi i parë:

- » Çfarë kuptoni me termin baticë-zbaticë?

Baticë-zbatica	Të përbashkëtat	Valë detare
Të veçantat		Të veçantat

- » Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimi, përgjigjeve të sakta dhe plotësimit të diagramit të venit.

Detyrat e shtëpisë: Mendoni në mënyrë kritike.

1. Përse shumica e cunameve ndodhin rreth Unazës së Zjarrit të Paqësorit?

Mblidhni të dhëna mbi madhësinë e valëve detare dhe oqeanike, foto apo informacione të ndryshme nga internet apo literaturë tjetër. Përpiquni të argumentoni se çfarë shprehin ato.

- » Cilat janë forcat që krijojnë baticë-zbaticat?
- » A mund të përfitojmë ekonomikisht nëse përdorim veprimin e baticë-zbaticave?
- » Përshkruani modelimin e brigjeve detare nga veprimi i baticë-zbaticave.

Grupi i dytë:

- » Çfarë janë valët detare?
- » Si formohen ato dhe si lëvizin përgjatë oqeanit?
- » Ç'quajmë cunam?
- » Cilët janë faktorët që çojnë në krijimin e cunamit?
- » Cilat janë pasojat e tyre?
- » Çfarë janë "sistemet e lajmërimit të hershëm"?

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diagrami i venit

Në këtë fazë të mësimi nxënësit udhëzohen të plotësojnë diagramin e venit. Nxënësit bëjnë krahasimin midis baticë-zbaticës dhe valëve detare duke përshkruar karakteristikat e përbashkëta dhe të veçanta midis tyre.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Rrymat oqeanike si pjesë e lëvizjes së ujit të oqeanëve dhe deteve.		Situata e të nxënësve: Pjesë nga libri “Mesazh në shishe”. “Dallgët dhe fati, mund ta kishin çuar kudo atë shishe, por në fakt u gjet tri javë pas nisjes së udhëtimit.”	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e konceptit rrymë oqeanike. - Rendit llojet e rrymave oqeanike. - Tregon në hartë disa nga rrymat oqeanike të botës. - Shpjegon se si ndikojnë këto rryma oqeanike në klimën e rajoneve ku kalojnë.		Koncepte kyçe: Rrymë oqeanike, rrymë sipërfaqësore, rrymë thellësie, qarkullim temoalin.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kimi, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësve fq. 76-78, harta e rrymave oqeanike, atlas i gjeografik etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësve njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënësve. Lexohen përpara nxënësve pjesë nga libri “Mesazh në shishe”. “Dallgët dhe fati, mund ta kishin çuar kudo atë shishe, por në fakt u gjet tri javë pas nisjes së udhëtimit.

Pyeten nxënësve:

- » Si mendoni si ka mundur që shishja e cila mbante mesazhin ka bërë gjithë atë lëvizje?
 - » Si lidhet kjo ngjarje me mësimin e ditës?
- Mirëpritën idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim

Në këtë fazë të mësimin realizohet teknika e shpjegimit e cila ka si qëllim të ndihmojë nxënësve të kuptojnë se çfarë janë rrymat oqeanike, cilët janë faktorët që ndikojnë në formimin e tyre, cilat janë disa nga veçoritë e tyre dhe si ndikojnë në klimën e vendeve pranë të cilave ato kalojnë..

Që shpjegimi të jetë i suksesshëm përdoren një varg strategjish si:

- » Teknika e pyetjeve
- » Përdorimi i shembujve
- » Përdorimi i mjeteve mësimore.

Shpjegimi nis me shkrimin në tabelë të temës së mësimin dhe çështjeve kryesore të saj. Shpjegimi shoqërohet me ilustrimet para nxënësve të fotografive dhe skicave të tekstit.

Tema: Rrymat oqeanike si pjesë e lëvizjes së ujit të oqeanëve dhe deteve.

- Veçori të përgjithshme të rrymave oqeanike
- A ndikojnë rrymat oqeanike në klimë?

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me tekstin

Në këtë fazë të mësimin nxënësve udhëzohen të punojnë në mënyrë të pavarur në plotësimin e hartës së tyre të rrymave oqeanike të botës.

- Nxënësve gjejnë dy rryma të ngrohta dhe të ftohta.
- Përshkruajnë vendndodhjen dhe drejtimin e tyre të lëvizjes.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, përgjigjeve të sakta dhe plotësimit të hartës së rrymave oqeanike.

Detyrat e shtëpisë: Mendoni në mënyrë kritike.

- Përse brigjet perëndimore të kontinenteve të Hemisferës Jugore janë më të ftohta?
- Nga cilat rryma oqeanike ndikohen ato?


MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Veprimtaria gjërryese, transportuese, depozituese e detit.		Situata e të nxënësve: Përpara nxënësve paraqiten fotografi të cilat përshkruajnë veprimtarinë gjërryese të detit.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e termave “vijë bregdetare” dhe “zonë bregdetare”. - Rendit veprimtaritë që kryen deti. - Përshkruan pasojat e veprimtarisë gjërryese të detit. - Përcakton kohën e gjërryerjes së shkëmbinjve nga veprimtaria e detit. - Shpjegon mënyrën e formimit të plazhit dhe luginave.		Koncepte kyçe: Vijë bregdetare, bregdet i lartë, bregdet i ulët, abrazion, kep, ledh bregor, laguna, duna bregdetare.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kimi, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësve fq. 79-81, harta e botës, atlasit gjeografik, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësve njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënësve. Përpara nxënësve paraqiten fotografi të cilat përshkruajnë veprimtarinë gjërryese të detit.



Pyeten nxënësve:

- Çfarë shikoni në këto fotografi?
- Si janë formuar forma të tilla të relievit?

Mirëpritën idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e koncepteve

Në këtë fazë të mësimin zhvillohet teknika tabela e koncepteve. Udhëzohen nxënësve të lexojnë me vëmendje mësimin për të plotësuar tabelën e koncepteve.

Veprimtaria gjërryese e detit	Veprimtaria transportuese e detit	Veprimtaria depozituese e detit

» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim i lire

Në këtë fazë të mësimin ftohen nxënësve në një diskutim të lirë rreth temës:

“Në rast se një zonë urbane ose turistike do të ishte e rrezikuar nga veprimtaria e detit, çfarë mendoni t’u sugjeroni planifikuesve dhe vendimmarrësve?

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, përgjigjeve të sakta dhe plotësimit të tabelës së koncepteve.

Detjrat e shtëpisë: Udhëzohen nxënësve për pajisjen e tyre me materialet e nevojshme për realizimin e orës së ardhshme.

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: <i>Projekt :Bregdeti</i>		Situata e të nxënit: Organizimi i orës së mësimi, paraqitja e projektit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Mbledh, përzgjedh dhe regjistron të dhëna gjeografike mbi bregdetet duke shfrytëzuar burime si interneti, enciklopedi, harta etj. - Ndërton njohuri mbi proceset që modelojnë brigjet: (baticë-zbaticë, dallgët detare, rrymat oqeanike, ndryshimi i nivelit të detit). - Prezanton modelimin e një vije bregdetare duke evidentuar format kryesore të krijuara përgjatë tij nga veprimtaria gërryese dhe depozituese e detit. - Përdor fjalor të përshtatshëm gjeografik.		Koncepte kyçe: Bregdet, gji detar, shpellë, kep, plazh, duna, lagunë, fjarde, baticë-zbaticë, dallgë detare, rryma oqeanike.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Art pamor, TIK.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit, interneti, enciklopedi, harta gjeografike, tabakë letre, markera, plastelinë, etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Diskutim

Zhvillohet një diskutim i lirë midis nxënësve rreth njohurive që ata kanë për bregdetet.

- Çfarë janë bregdetet?
- Çfarë tiparesh evidentohen në një bregdet?
- Përshkruaj proceset që modelojnë brigjet?
- Çfarë dini për veprimtarinë gërryese dhe depozituese të detit?

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe

Ndarja e nxënësve në tre grupe të mëdha. Përcaktimi i detyrave për secilin grup.

Grupi i parë: Çfarë tiparesh evidentoni në një bregdet (evidentojini nëpërmjet fotove dhe ngjitini ato në një tabak letre: gji detar, shpellë, kep, plazh, duna, fjarde, shkëmbinj etj.). Krijoni një album fotografish me tipare fizike të vijës bregdetare.

Grupi i dytë: Cilat procese modelojnë brigjet? (baticë-zbaticë, dallgët detare, rrymat oqeanike, ndryshimi i nivelit të detit). Modelimi i zhvillimit të një kepi nga veprimtaria gërryese e detit.

Grupi i tretë: Modelimi i një vije bregdetare duke evidentuar format kryesore të krijuara përgjatë tij nga veprimtaria gërryese dhe depozituese e detit.

Grupet pajisen me mjetet e nevojshme dhe punojnë për realizimin e projektit.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Prezantim

Në këtë fazë nxënësit prezantojnë projektet e tyre sipas grupeve përkatëse. Prezantimi bëhet me, tabakë letre, album me foto dhe modelimit me plastelinë.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për:

- Vlerësim pozitiv për të gjithë nxënësit që arrijnë të përfundojnë projektin.
- Punën në grup dhe punën individuale.
- Realizimit të projektit.
- Prezantimin dhe paraqitjen e punës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Ujërat rrjedhëse sipërfaqësore dhe tiparet e tyre.		Situata e të nxënës: Nxënësit përshkruajnë karakteristikat kryesore të ujërave rrjedhëse të mjedisit të tyre lokal.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e konceptit “Ujëra rrjedhëse sipërfaqësore”. - Shpjegon mënyrën e formimit të rrëkeve, përrunjve dhe lumenjve. - Përshkruan me pak fjalë karakteristikat e një rrjedhëje ujore duke treguar njësitë matëse të tyre. - Tregon pellgjet ujëmbledhëse të lumenjve në hartën e Shqipërisë.		Koncepte kyçe: Rrëke, përrua, lum, pellg ujëmbledhës, vijë ujëndarëse.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Matematikë, Biologji, Kimi.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 82-84, atlas i gjeografik, hartë hidrologjike e Shqipërisë, hartë fizike e botës etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Parashikimi me terma paraprak Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënës. Në tabelë mësuesi shkruan termat:

Rrëke	Përrua	Lum
-------	--------	-----


Pyeten nxënësit:

- Çfarë kuptoni me këto terma?
- Cila nga këto ujëra rrjedhëse kalon në vendbanimin tuaj?
- Përshkruani disa nga karakteristikat e tyre.

Mirëpritën idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Klaster

Në këtë fazë të mësimt udhëzohen nxënësit të lexojnë me vëmendje mësimin për të plotësuar së bashku klasterin e ndërtuar në tabelë nga mësuesi.



» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me hartën

Në këtë fazë të mësimt për të parë shkallën e përvetësimit të informacionit, nxënësit punojnë me hartën.

- Tregojnë pellgjet ujëmbledhëse të lumenjve në hartën e Shqipërisë.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e orës së mësimt, përgjigjeve të sakta, plotësimit të klasterit dhe përdorimit të hartës.

Detyrat e shtëpisë: Mendoni në mënyrë kritike. Mblidhni informacione dhe të dhëna sasiore mbi prurjet e lumenjve të vendit tonë. Cila është ecuria e vlerave të tyre gjatë viti? Pse?

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Veprimtaria e ujërave rrjedhëse sipërfaqësore.		Situata e të nxënit: Paraqiten para nxënësve fotografi me ngjyra të një kanioni, një ujëvare dhe pjesët e një sistemi lumor.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përcakton veprimtaritë që kryejnë ujërat rrjedhëse sipërfaqësore. - Përshkruan dy llojet e erozionit lumor. - Përkufizon termin kanion. - Përcakton pjesët përbërëse të një lumi. - Vlerëson rëndësinë e shfrytëzimit të lumenjve.		Koncepte kyçe: Erozion vertikal, erozion anësor, meander, grykëderdhje, deltë, estuar.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Kimi.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 85-87, hartë fizike e botës, hartë fizike e Shqipërisë.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Paraqiten para nxënësve fotografi me ngjyra të një kanioni, një ujëvare dhe pjesët e një sistemi lumor.



Pyeten nxënësit:


- Çfarë janë kanionet dhe ujëvarat?
- Si janë krijuar ato?
- Duke vështruar fotot mund të përcaktoni se cilët janë pjesët e një sistemi lumor?

Mirëprehen idetë dhe mendimet e nxënësve.


Ndërtimi i njohurive të reja: Klaster

Në këtë fazë të mësimit realizohet teknika e klasterit. Nxënësit ndahen në dy grupe. Udhëzohen nxënësit të lexojnë me vëmendje pjesët përkatëse të mësimit për të plotësuar së bashku klasterin e ndërtuar në tabelë nga mësuesi.

Grupi i parë:



Grupi i dytë:



» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me hartën

Në këtë fazë të mësimin nxënësit punojnë me hartën:

1. Në hartën fizike të botës gjejnë disa nga lumenjtë kryesorë të saj.
2. Në hartën fizike të Shqipërisë gjejnë lumenjtë që kanë ndikuar në formimin e fushave bregdetare.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, përgjigjeve të sakta, plotësimin të klasterit dhe punës në hartë.

Detyrat e shtëpisë: Udhëzohen nxënësit për pajisjen e tyre me materialet e nevojshme për realizimin e orës së ardhshme.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: <i>Projekt : Lumenjtë (Ujërat rrjedhëse sipërfaqësore)</i>		Situata e të nxënësve: Organizimi i orës së mësimin, paraqitja e projektit.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Mbledh, përzgjedh dhe regjistron të dhëna gjeografike mbi lumenjtë duke shfrytëzuar burime si interneti, enciklopedi, harta etj. - Ndërton njohuri mbi përdorimin e lumenjve. - Prezanton modelimin e një pellgu lumor duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.		Koncepte kyçe: Lum, pellg lumor, rrjedhë ujore, erozion i tokave, mbulesë bimore, grykëderdhje.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Art pamor, TIK.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësve, interneti, enciklopedi, harta gjeografike, tabakë letre, markera, plastelinë, ujë etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Diskutim

Zhvillohet një diskutim i lirë midis nxënësve rreth njohurive që ata kanë për lumenjtë.

- Çfarë janë lumenjtë?
- Çfarë rëndësie kanë ato?
- Përse përdoren lumenjtë?
- Cilët janë pjesët e një sistemi lumor?

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe

Ndarja e nxënësve në tre grupe të mëdha. Përcaktimi i detyrave për secilin grup.

Grupi i parë: Fakte mbi lumenjtë (koncepti lum, lumenjtë më të gjatë, lumenjtë më të mëdhenj).

Grupi i dytë: Përse përdoren lumenjtë? (Foto ilustruese, si përdoren lumenjtë për kalimin e kohës së lirë? Rrjedhjet ujore, erozioni i tokave dhe mbulesa bimore).

Grupi i tretë: Modelimi i një pellgu lumor duke evidentuar pjesët e një rrjedhje ujore sipërfaqësore nga burimi deri në grykëderdhje.

Grupet pajisen me mjetet e nevojshme dhe punojnë për realizimin e projektit.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Prezantim

Në këtë fazë nxënësit prezantojnë projektet e tyre sipas grupeve përkatëse. Prezantimi bëhet me tabakë letre, album me foto dhe modelimit me plastelinë.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për:

- » Vlerësim pozitiv për të gjithë nxënësit që arrijnë të përfundojnë projektin.
- » Punën në grup dhe punën individuale.
- » Realizimit të projektit.
- » Prezantimin dhe paraqitjen e punës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Liqenet, origjina e formimit të tyre dhe tiparet e tjera.		Situata e të nxënit: Çfarë janë liqenet? Si janë formuar ato? Si janë mbushur me ujë gropat e tyre?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron te kuptuarit e konceptit liqen. - Përcakton mënyrën e formimit të liqeneve. - Klasifikon liqenet sipas mënyrës së formimit. - Tregon në hartë shpërndarjen gjeografike të liqeneve. - Përshkruan me fjalët e tekstit rëndësinë e liqeneve.		Koncepte kyçe: Liqen tektonik, liqen vullkanik, liqen karstik, liqen akullnajor, liqen artificial, kënetë.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 88-90, harta fizike e botës, harta fizike e Shqipërisë, foto dhe skica të tekstit etj.	


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në këtë fazë ftohen nxënësit në një stuhi mendimesh rreth pyetjeve:


- Çfarë janë liqenet?
- Si janë formuar ato?
- Si janë mbushur me ujë gropat e tyre?

Skema plotësohet hap pas hapi me mendimet e nxënësve.



Ndërtimi i njohurive të reja: Klaster

Në këtë fazë të mësimt realizohet teknika e klasterit. Udhëzohen nxënësit të lexojnë me vëmendje mësimin për të plotësuar së bashku klasterin e ndërtuar në tabelë nga mësuesi.



Demonstrimi i rezultateve të arritura: Tabela e koncepteve

Në këtë fazë të mësimt udhëzohen nxënësit të plotësojnë tabelën e koncepteve.

Liqen tektonik	Liqen karstik	Liqen vullkanik	Liqen akullnajor

» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimt, përgjigjeve të sakta, plotësimit të klasterit dhe plotësimit të tabelës së koncepteve.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Vizatoni një peizazh liqenor, duke treguar vlerat dhe rëndësinë që kanë liqenet.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Ujërat nëntokësore dhe veprimtaria karstike.		Situata e të nxënësve: Paraqiten para nxënësve foto për secilën nga fjalët kyç.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përshkruan me fjalët e tekstit se çfarë janë ujërat nëntokësor. - Shpjegon mënyrën e formimit të tyre. - Shpjegon kuptimin e peizazheve karstike. - Liston disa nga format e relievit të formuara nga veprimtaria karstike.		Koncepte kyçe: Ujëra nëntokësor, ujëra freatike, ujëra arteziane, gejzerë, reliev karstik, burim karstik, ujëra minerale.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Kimi, Fizikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 91-93, atlas gjeografik, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Parashikimi me terma paraprakë Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënësve. Në tabelë shkruhen fjalët e mëposhtme:

Për secilën prej tyre nxënësit do të japin një shpjegim si dhe të bëjnë lidhjen e tyre me mësimin që do të marrin.

Ujëra nëntokësore

Burime karstike

Gejzere

Ujëra minerale

» Mirëpreiten idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Insert

Në këtë fazë të mësimin përdoret teknika insert sepse i ndihmon nxënësit të aktivizojnë se çfarë dinë që më parë, të bëjnë parashikime mbi atë që do të lexojnë nëpërmjet pyetjeve që dalin dhe që atyre do t'u pëlqente t'u përgjigjeshin.

U kërkohet nxënësve të lexojnë përmbledhjen dhe ti kategorizojnë njohuritë sipas tabelës së teknikës Insert.

	+	-	?
Informacioni që nxënësit dinë më parë	Informacioni i ri	Informacioni i lexuar është ndryshe nga informacioni që nxënësit dinë	Informacioni i paqartë për nxënësit

» Vlerësime, sugjerime, komente dhe zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me hartën

Në këtë fazë nxënësit punojnë me hartën:

» Në hartën fizike të botës, gjeni disa rajone ku dallohet veprimtaria karstike.

» Në hartën fizike të Shqipërisë, gjeni vendndodhjen e disa burimeve karstike.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, përgjigjeve të sakta, plotësimit të teknikës insert dhe punës me hartën.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Vizatoni një peizazh karstik dhe vlerësoni se si mund të shfrytëzohen disa forma të relievit karstik.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Veprimtaria e borës dhe e akujve.		Situata e të nxënësve: Përpara nxënësve paraqitet një fotografi e cila tregon kontinentin e Antarktidës.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Shpjegon me fjalët e tekstit mënyrën e formimit të borës së përhershme. - Rendit faktorët që ndikojnë në formimin e akullnajave. - Krahason akullnajat kontinentale me akullnajat malore. - Përcakton format e relievit të krijuara nga veprimtaria e akullnajave.		Koncepte kyçe: Borë e përhershme, ortek, akullnajë kontinentale, akullnajë malore, morenë, cirqe akullnajore, ajsberg.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Fizikë.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 94-96, atlasit gjeografik, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënësve. Përpara nxënësve paraqitet një fotografi e cila tregon kontinentin e Antarktidës.


Pyeten nxënësit:

- Çfarë tregon kjo pamje?
- Çfarë dini ju për kontinentin e Antarktidës?

Skema plotësohet hap pas hapi me mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabela e koncepteve

Në këtë fazë të mësimin realizohet tabela e koncepteve. Nxënësit të ndarë në pesë grupe udhëzohen të lexojnë me vëmendje pjesët përkatëse për të plotësuar tabelën e koncepteve.



Veprimtaria e borës dhe e akujve				
Bora dhe ortekët	Akullnajat dhe kushtet e krijimit	Llojet e akullnajave	Format e relievit akullnajor	Rëndësia e njohjes së akullnajave
<i>Grupi i pare</i>	<i>Grupi i dytë</i>	<i>Grupi i tretë</i>	<i>Grupi i katërt</i>	<i>Grupi i pestë</i>

» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diagrami i venit

Në këtë fazë të mësimin nxënësit udhëzohen të plotësojnë diagramin e venit. Nxënësit bëjnë krahasimin midis akullnajave kontinentale me akullnajave malore.

Akullnajë kontinentale	Të përbashkëtat	Akullnajë malore
Të veçantat		Të veçantat

Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, përgjigjeve të sakta, plotësimit të tabelës së koncepteve dhe diagramit të venit.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Çfarë do të ndodhte nëse shkrijnë akujt e Antarktidës? Po vetë Antarktida, çfarë do të pësonte nëse akujt do të shkrinin?

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: SITUATË E SUGJERUAR 4 Identifikimi i oqeanëve, deteve dhe gjireve detare kryesore të botës.		Situata e të nxënës: Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: • Përforcon konceptet: oqean, det, gji detar. • Saktëson shtrirjen gjeografike të oqeanëve të botës. • Pozicionon vendndodhjen e deteve dhe të gjireve kryesore detare. • Analizon veçoritë e ujit të deteve dhe oqeanëve.		Koncepte kyçe: Oqean, det, gji detar etj.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Art pamor.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 98, hartë fizike e botës, atlase, hartë skicë e botës, glob, laps, lapsa me ngjyra, gomë, fletore etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Faza e parë: Diskutim

Njihen nxënësit me orën e mësimi dhe veprimtari të që do të kryen. Në këtë fazë zhvillohet një diskutim i lirë mes nxënësve për të përforcuar njohuritë kryesore të temave:

- “Oqeanet dhe detet”.
- “Veçoritë e ujit të deteve dhe oqeanëve”.

Faza e dytë: Punë në grupe

- Klasa ndahet në grupe me nga 4 anëtarë.
- Zgjidhet kryetari i grupit.
- Ndahen detyrat brenda grupit.

Nxënësit plotësojnë në hartën skicë të botës:

- » Oqeanet
- » Detet
- » Gjiret detare

Faza e tretë: Diskutim

Në këtë fazë të mësimi diskutohet mbi punën e përfunduar, duke rregulluar gabimet e bëra.

- Krahasohen punët midis grupeve.
- Përcaktohet puna më e mirë midis grupeve.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të punës në grup, realizimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: SITUATË E SUGJERUAR 5 Rrymat oqeanike.		Situata e të nxënësve: Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: • Përforcon konceptet: rrymë oqeanike e ngrohtë dhe e ftohtë. • Skicon në hartën skicë drejtimin e lëvizjes dhe rrugën që ndjekin disa rryma oqeanike.		Koncepte kyçe: Rrymë oqeanike, rrymë oqeanike e ngrohtë, rrymë oqeanike e ftohtë.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Art pamor, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 99, hartë e shpërndarjes së rrymave oqeanike të botës, atlase, hartë skicë e botës, glob, laps, lapsa me ngjyra, gomë, fletore etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Faza e parë: Diskutim

Njihen nxënësit me orën e mësimi dhe veprimtari që do të kryen. Në këtë fazë zhvillohet një diskutim i lirë mes nxënësve për të përforcuar njohuritë kryesore të temës:

- “Rrymat oqeanike, si pjesë e lëvizjes së ujit të oqeanëve dhe deteve”.

Faza e dytë: Punë në grupe

- Klasa ndahet ne grupe me nga 4 anëtarë.
- Zgjidhet kryetari i grupit.
- Ndahen detyrat brenda grupit.

Nxënësit plotësojnë në hartën skicë të botës:

➤ Rrymat oqeanike të ngrohta dhe të ftohta.

Faza e tretë: Diskutim

Në këtë fazë të mësimi diskutohet mbi punën e përfunduar, duke rregulluar gabimet e bëra.

- Krahasohen punët midis grupeve.
- Përcaktohet puna më e mirë midis grupeve.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të punës në grup, realizimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: PËRSËRITJE 3 Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë-Hidrosfera		Situata e të nxënësve: Organizimi i orës së mësimimit. Veprimtaritë që do të zhvillohen.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: • Interpreton lidhjen e hidrosferës me sferat e tjera të Tokës. • Identifikon veçoritë e ujërave të deteve dhe oqeanëve. • Përcakton dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të deteve dhe oqeanëve. • Krahason liqenet sipas mënyrës së formimit. • Identifikon pasojat e veprimtarive të ujërave rrjedhëse.		Koncepte kyçe: Hidrosferë, oqean, det, liqen, lum, borë, akull, veprimtari e ujërave rrjedhëse etj.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Art pamor, Kimi.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 99, atlas gjeografik, hartë fizike e botës, tabakë letre, markera etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Veprimi 1: Diskutim

Njohja e nxënësve me orën e mësimimit dhe veprimtaritë që do të kryhen.

Diskutim mes nxënësish rreth njohurive të marra në mësimet e tematikës “Hidrosfera”.

Pyeten nxënësit:

1. Cila është lidhja e hidrosferës me sferat e tjera të Tokës?
2. Përshkruani veçoritë kryesore të ujërave të deteve dhe oqeanëve.
3. Cilët janë faktorët që ndikojnë në formimin e valëve detare, rrymave oqeanike, baticave dhe zbaticave?
4. Krahasoni liqenet sipas mënyrës së formimit.
5. Përcaktimi i formave të ndryshme të relievit nga veprimtaria gërryese, transportuese dhe depozituese e ujërave rrjedhëse, e lëvizjes së ujit të deteve dhe borës e akujve.

Veprimi 2: Punë në grupe

Nxënësit ndahen në tre grupe të mëdha.

Grupeve u caktohet të realizojnë nga një detyrë:

Grupi i parë:

❖ Në hartën skicë të Shqipërisë nxënësit përcaktojnë drejtimin kryesor të lumenjve të saj.

Grupi i dytë:

❖ Në mjedisin e tyre lokal përcaktojnë llojet e burimeve, duke përshkruar llojin dhe përdorimin e tyre.

Grupi i tretë:

❖ Përcaktojnë një problem mjedisor që lidhet me përdorimin e ujërave të mjedisit:

- Identifikon problemin.
- Përcakton faktorët e mundshëm që e shkakton.
- Ofron zgjidhje.
- Vlerëson përfitimet dhe riskun e zgjidhjeve të mundshme.

Secili grup pajiset me mjetet e nevojshme për realizimin e detyrës.

Veprimi 3: Turi i galerisë

Pas përfundimit të punës grupet, nëpërmjet turit të galerisë prezantojnë punën përpara klasës.

- Krahasohen punimet midis grupeve.
- Evidentohen punët më të mira.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimimit, punës në grup, realizimit dhe prezantimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: <i>Projekt: Ndotja mjedisore dhe llojet e saj (ora e dytë).</i>		Situata e të nxënit: Organizimi i orës së mësimimit dhe veprimtarive që do të zhvillohen.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Ndërton njohuri për mjedisin lokal dhe llojet e ndotjes së tij. - Shikon, vlerëson, sintetizon dhe analizon materialin e grumbulluar. - Përdor mjetet dhe shkathtësitë gjeografike si: vëzhgimet në terren, fotografitë, hartat, informacione nga interneti, etj. Për të mbledhur informacione të besueshme mbi ndotjen e mjedisit përreth.		Koncepte kyçe: Ndotja e mjedisit, ndotja e Tokës, ndotja e ujit.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kimi, Fizikë, Biologji, Matematikë, TIK. Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Interneti, teksti i nxënësit, enciklopedi dhe literatura të shkruara etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

FAZA E DYTË (ORA E DYTË)

Në këtë fazë të mësimimit do të zhvillohen këto veprimtari:

- Grumbullim dhe shikim, të materialit të mbledhur nga anëtarët e secilit grup.
- Sintetizim, vlerësim dhe analizim të materialit të mbledhur.
- Krijimi i dosjes nga grupet me materialet e grumbulluara dhe ti vlerësuar si të besueshme për informacionin që përmbajnë mbi detyrën që ju është dhënë.
- Përcaktim nga grupet të veprimeve të mëtejshme të punimit të projektit.
- Krijimi i strukturës së paraqitjes së projektit në bazë të materialeve të mbledhura nga secili anëtar i grupit.
- Diskutim midis anëtarëve të grupit mbi materialet e dosjes (*së projektit*), dhe punës së kryer deri në këtë fazë të projektit nga secili anëtar i grupit.

Vlerësimi:

Detyrat e shtëpisë: Udhëzime nga mësuesi për orën e ardhshme, që do të jetë dhe ora e prezantimit të projektit, nxënësit duhet të respektojnë afatin kohor të përcaktuar që në fillim të projektit.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Ndërtimi i brendshëm i Tokës.		Situata e të nxënit: Paraqitja e skicës e cila tregon ndërtimin e brendshëm të tokës.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e temës “litosferë”. - Përcakton tre shtresat kryesore të planetit tonë. - Përshkruan tiparet e secilës prej shtresave. - Shpjegon karakteristikat e astenosferës.		Koncepte kyçe: Bërthamë e Tokës, mantel, astenosferë, litosferë, kore kontinentale, kore oqeanike.	

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:

Kimi, Matematikë, Fizikë.

Burimet dhe mjetet mësimore:

Teksti i nxënësit fq. 100-102, atlas gjeografi, skicë e ndërtimit të brendshëm të Tokës etj.


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në këtë fazë zhvillohet një stuhi mendimesh rreth skicës së paraqitur përpara nxënësve.

Pyeten nxënësit:

1. Çfarë paraqet skica me ngjyrat dhe prerjet e saj?
2. Mund të përcaktoni se cilat janë shtresat kryesore në brendësi të Tokës?



» Mirëpreiten idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Shpegim

Në këtë fazë të mësimit realizohet teknika e shpjegimit e cila ka si qëllim të ndihmojë nxënësit të kuptojnë ndërtimin e brendshëm të Tokës, shtresave kryesore të saj.

Që shpjegimi të jetë i suksesshëm përdoren një varg strategjish si:

- ✓ Teknika e pyetjeve
- ✓ Përdorimi i shembujve
- ✓ Përdorimi i mjeteve mësimore.

Shpjegimi nis me shkrimin në tabelë të temës së mësimit dhe çështjeve kryesore të saj.

Shpjegimi shoqërohet me ilustrimet para nxënësve të fotografive dhe skicave të tekstit.

Tema: Ndërtimi i brendshëm i Tokës.

1. Ndërtimi i brendshëm i Tokës.
2. Korja e Tokës.
3. Manteli i Tokës.
4. Bërthama e Tokës.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Tabela e koncepteve

Në këtë fazë të mësimit nxënësit udhëzohen të plotësojnë tabelën e koncepteve të ndërtuar nga mësuesi në tabelën e zezë.

Ndërtimi i brendshëm i Tokës.		
Korja e Tokës	Manteli i Tokës.	Bërthama e Tokës.

» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimit, përgjigjeve të sakta dhe plotësimit të tabelës së koncepteve.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Sillni shembuj të dukurive natyrore, që ndryshojnë pamjen e planetit Tokë në ditët e sotme. Krijoni një album me tri faqe, për këtë qëllim.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Kontinentet dhe formimi i tyre.		Situata e të nxënit: Paraqitet para nxënësve foto të pozicionit të kontinenteve; a) 250 milion vite më parë, b) 150 milion vite më parë, c) pozicioni aktual i kontinenteve.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e konceptit “kontinent”. - Lokalizon në hartën fizike të botës kontinentet sipas hemisferave. - Shpjegon shkaku të lëvizjes së kontinenteve e cila ka çuar në ndryshimin e pozicionit të tyre në periudha të ndryshme kohore. - Përcakton në hartë pllakat më të mëdha të kores tokësore duke përshkruar llojet e lëvizjeve të tyre.		Koncepte kyçe: Kontinent, pllaka tektonike, tektonika, rryma konvektive.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 103-105, hartë fizike e botës, hartë e pllakave tektonike, foto dhe skica të tekstit etj.	


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendmesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në këtë fazë zhvillohet një stuhi mendimesh rreth skicës së paraqitur përpara nxënësve.

Pyeten nxënësit duke u bazuar në fotot:


- Çfarë paraqesin fotot para jush?



» Mirëpriten idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Harta e të pyeturit

Në këtë fazë të mësimin zhvillohet teknika harta e të pyeturit. Udhëzohen nxënësit të lexojnë me vëmendje mësimin ndërkohë që mësuesi vendos në tabelë pyetjet e përgatitura me parë në flipçart.



» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me hartën

Në këtë fazë të mësimi nxënësit punojnë me hartën e zhvendosjes së pllakave.

Nxënësit udhëzohen të vërejnë drejtimin e lëvizjes së pllakës euroaziatike dhe asaj afrikane.

Pyeten nxënësit:

- Çfarë ndryshimesh mund të ndodhin në detin Mesdhe dhe Detin e Kuq në 200 milion vitet e ardhshme?

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimi, përgjigjeve të sakta, dhe punës me hartën.

Detyrat e shtëpisë: Mendoni në mënyre kritike: përse Artur Vegener mendoi se pllakat tektonike lëviznin? Hulumtoni për të dhe gjetjet i diskutoni në klasë.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Relieve i kontinenteve si pjesë e relievit të sipërfaqes së Tokës.		Situata e të nxënit: Nxënësit përshkruajnë peizazhin natyror të mjedisit përreth.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Shpjegon me fjalët e tekstit konceptin “reliev”. - Përshkruan mënyrat e studimit të relievit sot. - Përkufizon termin “izohips”. - Përshkruan tri klasat e relievit.		Koncepte kyçe: Reliev, izohipse, klasa të relievit, lartësi absolute dhe relative, batimetri, altimetër.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Matematikë, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 106-108, hartë fizike e botës, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në këtë fazë zhvillohet një stuhi mendimesh ku nxënësve u kërkohet të përshkruajnë peizazhin natyror të mjedisit përreth.

Peizazhe gjeografike	
Peizazhe natyrore	Peizazhe njerëzore

Pyeten nxënësit: Përse përgjigjet tuaja janë ndarë në dy kolona?

» Mirëpriten idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Ditari tre pjesësh

Në këtë fazë të mësimin përdoret teknika “ditarët e të nxënit për të nxitur nxënësit të lexojnë në mënyrë të qëllimshme, të lidhin ngushtë materialin e tekstit me kureshtjen dhe përvojat e tyre. Nxënësit udhëzohen të lexojnë me vëmendje mësimin për të plotësuar ditarin e ndërtuar nga mësuesi në tabelë. Kolona e dytë plotësohet nga nxënësi, kurse kolona e tretë plotësohet nga mësuesi i cili plotëson dhe thëllon më shumë njohuritë e tyre.

Citati	Komenti i nxënësit	Komenti i mësuesit
Relievi i sipërfaqes së Tokës.		
Studimi i relievit.		
Klasat e relievit.		
Lartësia absolute dhe relative e relievit.		

Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me hartën

Në këtë fazë nxënësit punojnë me hartën. Në hartën fizike të botës, dalloni relieve të ndryshme në varësi të ngjyrave që i shprehin ato. Identifikoni në të vende me lartësi absolute të ndryshme.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, përgjigjeve të sakta, plotësimit të ditarit trepjesësh dhe punës me hartën.

Detyrat e shtëpisë: Mendoni në mënyrë kritike. Përdorni “Google Earth” TM, atlase, ose konsultohuni me harta për të parë larminë e formave të relievit të zonës suaj. Komentoni se si relieve ka ndikuar në stilin tuaj të jetesës, në aktivitetet ekonomike, në transport. Shpjegoni nëse relieve ka ndikuar në historinë e zonës suaj.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Format e relievit në kontinente: malet dhe luginat.		Situata e të nxënit: Nxënësit përshkruajnë format e relievit të mjedisit përreth.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e konceptit “mal”. - Klasifikon malet sipas shtrirjes së sipërfaqes së tyre. - Përshkruan karakteristikat e maleve sipas moshës së tyre. - Lokalizon në hartën e botës disa nga malet kryesore të saj.		Koncepte kyçe: Mal, orogjeneza, male të reja, male të vjetra, luginë malore.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Kimi.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 109-111, hartë e botës, foto dhe skica të tekstit, atlas gjeografik etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Parashikimi me terma paraprak


Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në tabelë shkruhen fjalët e mëposhtme për të cilat u kërkohet nxënësve nga një shpjegim dhe lidhjen e tyre me mësimin.

Mal	Kodër	Luginë
-----	-------	--------

» Mirëpreiten idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Klaster

Në këtë fazë të mësimin u kërkohet nxënësve të lexojnë me vëmendje mësimin për plotësimi i klasterit të ndërtuar nga mësuesi në tabelë.



» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me hartën

Në këtë fazë të mësimin nxënësit orientohen të punojnë me hartën.

📍 Në hartën fizike të botës, përcaktoni vendndodhjen e vargjeve malore kryesore.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin përgjigjeve të sakta, plotësimin të klasterit dhe punës me hartën.

Detyrat e shtëpisë: Mendoni në mënyrë kritike: Duke përdorur internetin, shihni videon e mëposhtme: <https://vimeo.com/59683503> dhe diskutoni procesin e formimit të maleve si rrjedhojë e përplasjes së pllakave tektonike.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Format e relievit në kontinente: fushat dhe kodrat.		Situata e të nxënit: Paraqitet përpara nxënësve harta fizike e Shqipërisë. Nxënësit lokalizojnë shpërndarjen gjeografike të fushave dhe kodrave.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e koncepteve “fushë”, “kodër”. - Klasifikon fushat sipas origjinës së formimit të tyre. - Lokalizon në hartën e botës dhe të Shqipërisë fushat më të mëdha.		Koncepte kyçe: Fushë, pllajë, rrafshnaltë, fushëgropë, kodër.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 112-114, atlas gjeografik, hartë fizike e botës, hartë fizike e Shqipërisë, foto të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Paraqitet përpara nxënësve harta fizike e Shqipërisë.

Nxënësit lokalizojnë shpërndarjen gjeografike të fushave dhe kodrave të saj. Përgjigjet e tyre vendosen në tabelë nga mësuesi.



Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i drejtuar

Në këtë fazë të mësimin përdoret teknika “lexim i drejtuar”. Nxënësit udhëzohen të lexojnë me vëmendje mësimin:

Ndërkohë në tabelë vendosen pyetjet e shkruara më parë nga mësuesi në flipçart.

HAPI I PARË:

- Çfarë janë fushat?
- Si paraqiten në hartën fizike?
- Cilat janë disa nga fushat që ju njihni? Në Shqipëri? Në botë?

HAPI I DYTË:

- Si klasifikohen fushat sipas lartësisë?
- Po sipas origjinës së tyre të formimit?

HAPI I TRETË:

- Çfarë janë kodrat?
 - Cilat janë llojet e kodrave sipas shtrirjes mbi sipërfaqen e tokës?
 - Cilat janë kodrat me shtrirje më të madhe në Shqipëri?
- » Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me hartën

Pas përfundimit të dy fazave të para të mësimin, për të parë shkallën e përvetësimit të njohurive dhe zbatimin e tyre në praktikë nxënësit do të gjejnë në hartë këto vende:

Fusha e Rosisë, fushën e Evropës Perëndimore, fushën e Holandës, rrafshnaltën e Tibetit, rrafshnaltën e Dekani, fushën e Myzeqesë, pllajën e Dumresë, kodrat e Kërrabës, kodrat e Mallakastrës.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin përgjigjeve të sakta dhe lokalizimit të vendeve në hartë.

Detyrat e shtëpisë: Mendoni në mënyrë kritike. Duke ditur që fushat mund të jenë pjesë e problemeve mjedisore si p.sh., ndotja e tyre, jepni mendimin tuaj se si të mirëkujdesemi për to. Shfrytëzoni burime nga interneti apo botime të ndryshme gjeografike.

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT


Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Shkëmbinjtë dhe llojet e tyre.		Situata e të nxënit: Paraqitet përpara nxënësve foto e një fosili.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përshkruan me pak fjalë se çfarë janë mineralet. - Rendit grupet e shkëmbinjve. - Shpjegon mënyrën e formimit të shkëmbinjve sedimentarë. - Shpjegon mënyrën e formimit të shkëmbinjve magmatikë dhe metamorfikë. - Përcakton rëndësinë e njohjes dhe studimit të fosileve.		Koncepte kyçe: Mineral, shkëmbinj metamorfikë, shkëmbinj magmatikë, shkëmbinj sedimentarë, fosil.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kimi, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 115-117, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Paraqitet përpara nxënësve foto e një fosili. Pyeten nxënësit:

- Çfarë tregon kjo foto?
- Çfarë janë fosilet?
- Si janë formuar ato?
- Çfarë informacionesh marrim prej tyre?



Skema plotësohet hap pas hapi me mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Ditarët tre pjesësh

Në këtë fazë të mësimit përdoret teknika “ditarët e të nxënit” për të nxitur nxënësit të lexojnë në mënyrë të qëllimshme, të lidhin ngushtë materialin e tekstit me kureshtjen dhe përvojat e tyre. Nxënësit udhëzohen të lexojnë me vëmendje mësimin për të plotësuar ditarin e ndërtuar nga mësuesi në tabelë. Kolona e dytë plotësohet nga nxënësi, kurse kolona e tretë plotësohet nga mësuesi i cili plotëson dhe thëllon më shumë njohuritë e tyre.

Citati	Komenti i nxënësit	Komenti i mësuesit
Shkëmbinjtë dhe mineralet		
Shkëmbinjtë magmatikë		
Shkëmbinjtë sedimentarë		
Shkëmbinjtë metamorfikë		
Fosilet		

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diagrami i venit

Në këtë fazë të mësimi udhëzohen nxënësit të ndarë në dy grupe të plotësojnë diagramin e venit për të bërë krahasimin midis “shkëmbinjve magmatikë plutonikë nga shkëmbinjve magmatikë efuzivë” dhe “shkëmbinjve sedimentarë nga shkëmbinjve metamorfikë”.

Grupi i parë:

Shkëmbinjte magmatikë plutonikë	Të përbashkëtat	Shkëmbinjte magmatikë efuzivë
Të veçantat		Të veçantat

Grupi i dytë:

Shkëmbinjte sedimentarë	Të përbashkëtat	Shkëmbinjte metamorfikë
Të veçantat		Të veçantat

» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimi përgjigjeve të sakta, plotësimi të ditarit trepjesësh dhe diagramit të venit.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Përdorni internetin, apo burime të tjera gjeografike, për të grumbulluar informacione rreth fosileve. Përcaktoni rëndësinë e njohjes dhe studimit të tyre.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Tokat. Faktorët e formimit të tyre.		Situata e të nxënit: Diskutim mes nxënësish për të shpjeguar konceptin “tokë”.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e konceptit “tokë”. - Përshkruan me pak fjalë shtresëzimin e tokave. - Përcakton faktorët që ndikojnë në formimin e tokave. - Shpjegon se si ndikon era dhe bakteret në formimin e tokave.		Koncepte kyçe: Profili i një toke, tokë bujqësore, humus, klasifikimi i tokave në Shqipëri sipas lartësisë.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Kimi, Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësve fq. 118-120, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:


Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në këtë fazë zhvillohet një stuhi mendimesh rreth fjalës “TOKË”.

Pyeten nxënësit:

- » Çfarë janë tokat?
- » Nga çfarë përbëhen ato?
- » Çfarë rëndësie ka toka për zhvillimin e jetës?

Skema plotësohet hap pas hapi me mendimet e nxënësve.



Ndërtimi i njohurive të reja: Shpjegim

Në këtë fazë të mësimin realizohet teknika e shpjegimit e cila ka si qëllim të ndihmojë nxënësit të kuptojnë se çfarë janë tokat, shtresëzimi i tokave dhe faktorët që ndikojnë në formimin e tyre.

Që shpjegimi të jetë i suksesshëm përdoren një varg strategjish si:

- Teknika e pyetjeve
- Përdorimi i shembujve
- Përdorimi i mjeteve mësimore.

Shpjegimi nis me shkrimin në tabelë të temës së mësimin dhe çështjeve kryesore të saj.

Shpjegimi shoqërohet me ilustrimet para nxënësve të fotografive dhe skicave të tekstit.

Tema: Tokat, faktorët e formimit të tyre.

- » Tokat dhe tiparet e tyre.
- » Shtresëzimi i tokave.
- » Faktorët që ndikojnë në formimin e tokave.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me tekstin

Në këtë fazë të mësimin nxënësit udhëzohen të punojnë me rubrikën e tekstit “Punoni me figurën”.

» Duke vëzhguar fig. 2, ndërtoni në drejtkëndorin bosh profilin ideal të tokave, duke treguar horizontet dhe karakteristikat e tyre. Ku ndryshon horizonti A nga horizonti B?

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, përgjigjeve të sakta dhe plotësimit të punës me tekstin.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Përse nuk do të kishte toka, nëse nuk do të ekzistonte atmosfera? Shkruani një ese të shkurtër.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Tërmetet.		Situata e të nxënit: Paraqiten pamje filmike të tërmeteve të ndryshme në botë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përkshkruan me pak fjalë se çfarë ndodh gjatë një tërmeti. - Përcakton shkaqet e krijimit të një tërmeti. - Analizon ndikimin që kanë tërmetet në peizazh. - Lokalizon në hartën e botës zonat ku hasen më shumë tërmetet.		Koncepte kyçe: Tërmet, hipoqendër, epiqendër, valë sizmike, sizmograf.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 121-123, hartë e botës, atlas gjeografik, foto dhe skica të tekstit, videoprojektor, kompjuter etj.	


METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në këtë fazë shfaqen pamje filmike nga rënia e një tërmeti ku tregohen pasojat e tij. Zhvillohet një stuhi mendimesh rreth fjalës "tërmet".

Pyeten nxënësit:


- Çfarë shikoni në këto pamje?
- Si shkaktohen tërmetet?
- Cilat janë pasojat e tyre?



Skema plotësohet hap pas hapi me mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Klaster

Në këtë fazë të mësimin udhëzohen nxënësit të lexojnë me vëmendje mësimin për të plotësuar klasterin e ndërtuar nga mësuesi në tabelë.



» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Pumë me hartën

- Në këtë fazë të mësimin nxënësit orientohen të punojnë me hartën.
- Në hartën fizike të botës, përcaktoni shpërndarjen gjeografike të tërmeteve.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, dhënies së përgjigjeve të sakta dhe plotësimit të klasterit dhe punës me hartën.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën.

Duke përdorur internetin dhe "website"-et që tregojnë tërmetet në kohë reale, gjeni se cilat janë tërmetet e rëna në zonën tuaj gjatë javës së fundit. Jepni karakteristikat e tyre: koordinatat gjeografike dhe vlerën e magnitudës.

Gjeni informacione për tërmetet e vitit 2010 dhe 2011 në Haiti, Kili, Japoni dhe diskutoni ato në klasë.

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Vullkanet.		Situata e të nxënit: Paraqitja e një vullkani në një foto.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përshkruan me fjalët e tekstit termin “vullkan”. - Tregon nëpërmjet një skice pjesët e një vullkani. - Lokalizon në hartën e botës përhapjen gjeografike të vullkaneve. - Përcakton pasojat e vullkaneve në mjedis.		Koncepte kyçe: Vullkan, magmë, produkte të vullkaneve, vullkan i fjetur, vullkan i shuar, krater.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Histori, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 124-126, harta e botës, foto dhe skica të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në këtë fazë mësuesi u tërheq vëmendjen nxënësve për termin “vullkan” i cili ka lidhje me temën e mësimin.

Pyeten nxënësit:


☐ Çfarë shikoni, mendoni dhe ndjeni kur shikoni pamje të një vullkani veprues?



Skica plotësohet hap pas hapi nga mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Harta e të pyeturit


Në këtë fazë të mësimin zhvillohet teknika “harta e të pyeturit”. Udhëzohen nxënësit të lexojnë me vëmendje mësimin ndërkohë që mësuesi vendos në tabelë pyetjet e përgatitura më parë në flipçart.



» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Klaster

Në këtë fazë të mësimit u kërkohet nxënësve plotësimi i klasterit të ndërtuar më parë nga mësuesi në tabelë.



» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimit, dhënies së përgjigjeve të sakta dhe plotësimit të klasterit.

Detyrat e shtëpisë: Udhëzime për orën e ardhshme për realizimin e projektit 'Vullkanet'.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: <i>Projekt: Vullkanet</i>		Situata e të nxënit: Organizimi i orës së mësimt, paraqitja e projektit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Mbledh, përzgjedh dhe regjistron të dhëna gjeografike mbi vullkanet: vullkanet aktivë, të fjetur, zonat vullkanike si dhe shpërthimet vullkanike duke shfrytëzuar burime si interneti, enciklopedi, harta etj. - Ndërton njohuri mbi përhapjen gjeografike të zonave vullkanike në hartën botës . - Prezanton modelimin e një vullkani me pjesët përbërëse të tij. - Përdor fjalorin e përshtatshëm gjeografik.		Koncepte kyçe: Vullkan i fjetur, vullkan aktiv, zona vullkanike, shpërthim vullkanik.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Art pamor, TIK		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit, interneti, enciklopedi, harta gjeografike, tabakë letre, markera, plastelinë, letër me ngjyrë etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Diskutim

Zhvillohet një diskutim i lirë midis nxënësve rreth njohurive që ata kanë për vullkanet.

- Çfarë janë vullkanet?
- Si janë formuar?
- Cilët janë pjesët përbërëse të një vullkani?
- Si gjenden të përhapura në hartën e botës zonat vullkanike?

Ndërtimi i njohurive të reja: Punë në grupe

Ndarja e nxënësve në tre grupe të mëdha. Përcaktimi i detyrave për secilin grup.

Grupi i parë: Cilët janë vullkanet e fjetur? Po ata aktivë? (modeloni pjesët e një vullkani me mjete të ndryshme: plastelinë, letër me ngjyra).

Grupi i dytë: Cilët janë vullkanet më aktivë sot në botë? Sillni fakte dhe foto nga shpërthimet e tyre më të fundit.

Grupi i tretë: Paraqitja e përhapjes gjeografike e zonave vullkanike në një hartë të botës, të shkicuar nga nxënësit, ku evidentohen oqeanet dhe kontinentet.

Grupet pajisen me mjetet e nevojshme dhe punojnë për realizimin e projektit.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Prezantim

Në këtë fazë nxënësit prezantojnë projektet e tyre sipas grupeve përkatëse. Prezantimi bëhet me tabakë letre, album me foto dhe modelimit me plastelinë dhe me letra me ngjyrë.

Të tria punimet e grupeve mund të bashkëngjiten në një të vetme dhe të ekspozohen në muret e klasës, duke i shoqëruar nxënësit gjatë gjithë vitit.

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për:

- Vlerësim pozitiv për të gjithë nxënësit që arrijnë të përfundojnë projektin.
- Punën në grup dhe punën individuale.
- Realizimit të projektit.
- Prezantimin dhe paraqitjen e punës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: SITUATË E SUGJERUAR 6 Plotësimi i hartës fizike të botës.		Situata e të nxënit: Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përforcon konceptet: male, vargmale, fushë, rrafshnaltë, kodër. - Përcakton në hartën skicë të botës shpërndarjen gjeografike të maleve, fushave, kodrave, pllajave e rrafshnaltave.		Koncepte kyçe: Mal, vargmal, fushë, rrafshnaltë, kodër.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Art pamor.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 127, hartë fizike e botës, hartë skicë e botës, atlas, glob, laps, lapsa me ngjyra, gomë, fletore etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Faza e parë: Diskutim

Njihen nxënësit me orën e mësimi dhe veprimtaritë që do të kryen. Në këtë fazë zhvillohet një diskutim i lirë mes nxënësve për të përforcuar njohuritë kryesore të temave:

- “Relievi i kontinenteve si pjesë e relievit të sipërfaqes së Tokës”.
- “Format e relievit në kontinente: malet dhe luginat”.
- “Format e relievit në kontinente: fushat dhe kodrat”.

Faza e dytë: Punë në grupe

- Klasa ndahet në grupe me nga 4 anëtarë.
- Zgjidhet kryetari i grupit.
- Ndahen detyrat brenda grupit.

Nxënësit plotësojnë në hartën skicë të botës:

- Format e relievit: malet, vargmalet, kodrat, fushat, pllajajat, rrafshnalta.

Faza e tretë: Diskutim

Në këtë fazë të mësimi diskutohet mbi punën e përfunduar, duke rregulluar gabimet e bëra.

- Krahasohen punët midis grupeve.
- Përcaktohet puna më e mirë midis grupeve.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të punës në grup, realizimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: SITUATË E SUGJERUAR 7 Plotësimi i hartës së shpërndarjes gjeografike të tërmeteve dhe vullkaneve.		Situata e të nxënës: Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: • Përfillon konceptet: tërmet dhe vullkan. • Përcakton shpërndarjen gjeografike të vullkaneve dhe tërmeteve në hartën skicë të botës. • Përcakton vendndodhjen e disa vullkaneve aktive në detin e Mesdheut.		Koncepte kyçe: Vullkan, tërmet.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Art pamor.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 127, hartë fizike e botës, hartë skicë e botës, atlas, glob, laps, lapsa me ngjyra, gomë, fletore etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Faza e parë: Diskutim

Njihen nxënësit me orën e mësimi dhe veprimtari të që do të kryen. Në këtë fazë zhvillohet një diskutim i lirë mes nxënësve për të përfunduar njohuritë kryesore të temave:

- "Tërmetet".
- "Vullkanet".

Faza e dytë: Punë në grupe

- Klasa ndahet në grupe me nga 4 anëtarë.
- Zgjidhet kryetari i grupit.
- Ndahen detyrat brenda grupit.

Nxënësit plotësojnë në hartën skicë të botës:

- Përcaktojnë shpërndarjen gjeografike të vullkaneve dhe të tërmeteve.

Faza e tretë: Diskutim

Në këtë fazë të mësimi diskutohet mbi punën e përfunduar, duke rregulluar gabimet e bëra.

- Krahasohen punët midis grupeve.
- Përcaktohet puna më e mirë midis grupeve.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të punës në grup, realizimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: PËRSËRITJE 3 Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë-Litosfera		Situata e të nxënësve: Organizimi i orës së mësimi. Veprimtaritë që do të zhvillohen.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përshkruan veçoritë kryesore të shtresave të Tokës. - Klasifikon shkëmbinjtë magmatik, sedimentar dhe metamorfik. - Përcakton faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e dherave. - Përshkruan ndryshimet e sipërfaqes së Tokës si pasojë e lëvizjeve të ngadalta dhe i proceseve të shpejta.		Koncepte kyçe: Hidrosferë, oqean, det, liqen, lum, borë, akull, veprimtari e ujërave rrjedhëse etj.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Art pamor, Kimi.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 129, atlas gjeografik, hartë fizike e botës, tabakë letre, markera, kompjuter, internet etj.	
METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:			
Veprimi 1: Diskutim Njohja e nxënësve me orën e mësimi dhe veprimtaritë që do të kryhen. Diskutim mes nxënësish rreth njohurive të marra në mësimet e tematikës “Hidrosfera”. Diskutohen me nxënësit çështjet e mëposhtme: - Përshkruan veçoritë kryesore të shtresave të Tokës. - Klasifikon shkëmbinjtë magmatik, sedimentar dhe metamorfik. - Përcakton faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e dherave. - Përshkruan ndryshimet e sipërfaqes së Tokës si pasojë e lëvizjeve të ngadalta dhe i proceseve të shpejta.			
Veprimi 2: Punë në grupe Nxënësit ndahen në tre grupe të mëdha. Grupeve u caktohet të realizojnë nga një detyrë: Grupi i parë: - Argumenton rëndësinë e materialeve që përbëjnë Tokën (p.sh., shkëmbinjtë, mineralet) për njerëzimin. Shkruani një përmbledhje të shkurtër mbi përdorimin e mineraleve të nëntokës së vendit tonë.. Grupi i dytë: - Vëzhgoni në zonën (qytetin/fshatin) tuaj praninë e tokave dhe diskutoni mbi ndikimin e tyre në ekonomi. Grupi i tretë: Hulumton linkun http://www.emcs.org/Earthquake/Map/zoom , i cili trajton tërmetet në kohe reale. Vëzhgoni hartën dhe përcaktoni zonat me më tepër tërmete. Evidentoni vendndodhjet e tyre duke treguar vlerat e magnitudës. Secili grup pajiset me mjetet e nevojshme për realizimin e detyrës.			
Veprimi 3: Turi i galerisë Pas përfundimit të punës grupet, nëpërmjet turit të galerisë prezantojnë punën përpara klasës. - Krahasohen punimet midis grupeve. - Evidentohen punët më të mira. Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimi, punës në grup, realizimit dhe prezantimit të detyrës. Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.			

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Mjediset jetësore të brezit të nxehtë.		Situata e të nxënit: Paraqiten përpara nxënësve foto të fjalëve kyç.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e konceptit “biosferë”. - Përcakton faktorët kufizues të mjediseve jetësore. - Përshkruan me fjalët e tekstit veçoritë kryesore të mjediseve jetësore të brezit të nxehtë. - Lokalizon në hartën e mjediseve jetësore të botës mjediset e brezit të nxehtë.		Koncepte kyçe: Pyje ekuatoriale, savana, shkretëtira.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 129-132, hartë e mjediseve jetësore të botës, atlas gjeografik, foto të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Parashikimi me terma paraprakë Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në këtë fazë mësuesi u tërheq vëmendjen nxënësve për termat e vendosura në tabelë:

Liane

Druri i palmës

Baobab

Shkretëtira e Saharasë

Oazë

Pyeten nxënësit:

- Çfarë dini për to?
- Çfarë lidhje kanë me mësimin e ri?

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabelë konceptesh

Në këtë fazë të mësimin udhëzohen nxënësit të lexojnë me vëmendje mësimin për të plotësuar tabelën e koncepteve të ndërtuar në tabelën e zezë nga mësuesi.

Nxënësit përshkruajnë veçoritë dalluese të pyjeve ekuatoriale, savaneve dhe shkretëtirave.

Mjediset jetësore të brezit të nxehtë	Klima	Bota bimore	Bota shtazore
Pyjet ekuatoriale			
Savanet			
Shkretëtirat			

» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Shkrimi i lirë

Në këtë fazë të mësimin ftohen nxënësit në një shkrim të lirë me temë:

- “Një udhëtim imagjinar në xhungël”.

Në këtë shkrim nxënësit do të përshkruajnë veçoritë kryesore të mjediseve jetësore të brezit të ngrohtë duke përmendur pjesë të florës dhe faunës së saj.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, dhënies së përgjigjeve të sakta, plotësimit të tabelës së koncepteve dhe realizimit të shkrimit të lirë.

Detyrat e shtëpisë: Punoni me hartën. Në të tria hartat e tekstit nxënësit do të përcaktojnë vendndodhjen e pyjeve ekuatoriale, savaneve dhe shkretëtirave të ngrohta.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Mjedisi jetësor i brezit mesatar.		Situata e të nxënësve: Lexohet leximi i pjesës së dhënë në tekst.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përcakton mjediset jetësore të brezit mesatar. - Përshkruan veçoritë kryesore të mjediseve jetësore të brezit mesatar. - Lokalizon në hartën e mjediseve jetësore të botës mjediset e brezit mesatar.		Koncepte kyçe: Pyje gjetherënëse, pyje halore, preri, shkretëtirë e gjerësive mesatare.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 133-135, hartë e mjediseve jetësore të botës, atlas gjeografik, foto të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënësve. Lexohet leximi i pjesës së dhënë në tekst në bazë të së cilës nxënësit përcaktojnë:

- Shtrirjen gjeografike të mjediseve jetësore të brezit mesatar.
- Në cilën hemisferë kanë shtrirje më të madhe.
- Përcaktojnë mjediset kryesore të brezit mesatar.

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabelë konceptesh

Në këtë fazë të mësimin udhëzohen nxënësit të lexojnë me vëmendje mësimin për të plotësuar tabelën e koncepteve të ndërtuar në tabelën e zezë nga mësuesi.

Nxënësit përshkruajnë veçoritë dalluese të pyjeve gjetherënëse, pyjeve konifere, prerive dhe shkretëtirave të gjerësive mesatare.

Mjediset jetësore të brezit mesatar	Klima	Bota bimore	Bota shtazore
Pyjet gjetherënëse			
Pyjet konifere			
Preritë			
Shkretëtirat e gjerësive mesatare			

Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diagrami i venit

Në këtë fazë të mësimin udhëzohen nxënësit, të plotësojnë diagramin e venit për të bërë krahasimin midis “shkretëtirave të ngrohta dhe shkretëtirave të ftohta”.

Shkretëtira të ftohta	Të përbashkëtat	Shkretëtira të ngrohta
Të veçantat		Të veçantat

- Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, dhënies së përgjigjeve të sakta, plotësimit të tabelës së koncepteve dhe diagramit të venit.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Krijoni një album të vogël me foto të bimëve dhe kafshëve që rriten në zonën e gjerësive mesatare për të përzgjedhur albumin më të mirë.

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Mjediset jetësore të brezit të ftohtë.		Situata e të nxënit: Shpjegimi i termave, pinguin dhe eskimez.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përcakton mjediset jetësore të brezit të ftohtë. - Përshkruan veçoritë kryesore të florës dhe faunës të brezit të ftohtë. - Lokalizon në hartën e mjediseve jetësore të botës mjediset e brezit të ftohtë.		Koncepte kyçe: Tundër, mjedis jetësor i zonave polare, eskimez.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 133-136, hartë e mjediseve jetësore të botës, atlas gjeografik, foto të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Parashikimi me terma paraprakë Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në tabelën e zezë mësuesi shkruan fjalët kyç. Për secilën prej tyre nxënësve u kërkohet një shpjegim si dhe të bëjnë lidhjen me mësimin e ri.

Pinguinë

Eskimez

Mirëpritën idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabelë konceptesh

Në këtë fazë të mësimin udhëzohen nxënësit të lexojnë me vëmendje mësimin për të plotësuar tabelën e koncepteve të ndërtuar në tabelën e zezë nga mësuesi.

Nxënësit përshkruajnë veçoritë dalluese të tundrës dhe zonave polare.

Mjediset jetësore të zonës të ftohtë	Klima	Bota bimore	Bota shtazore
Tundra			
Zona polare			

- Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Në këtë fazë të mësimin për të kuptuar shkallën e përvetësimit të njohurive të reja zhvillohet teknika "Marrëdhëniet pyetje-përgjigje".

- Përse bimësia në zonën e tundrës është vetëm në formën e likeneve, myshqeve dhe luleve?
- Përse nuk mund të rriten drurë në zonën e tundrës?
- Si u është përshtatur bota shtazore kushteve klimatike të zonave polare?

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, dhënies së përgjigjeve të sakta, plotësimit të tabelës së koncepteve.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Krijoni një album me foto të bimëve dhe kafshëve që rriten në zonën e tundrës dhe zonën polare duke përzgjedhur albumin më të mirë.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Mjediset jetësore mesdhetare dhe mjediset jetësore në zonat malore.		Situata e të nxënit: Çfarë dini për florën dhe faunën që rriten në Shqipëri?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përcakton mjediset jetësore mesdhetare. - Demonstron të kuptuarit e termit “mjedis jetësor i zonave malore”. - Përshkruan veçoritë kryesore të florës dhe faunës të mjediseve jetësore mesdhetare. - Përshkruan veçoritë kryesore të florës dhe faunës të zonave malore. - Lokalizon në hartën e mjediseve jetësore të botës mjediset jetësore mesdhetare dhe të zonave malore.		Koncepte kyçe: Mjedis jetësor mesdhetar, mjedis jetësor në zonat malore, klima në zonat mesdhetare, klima në zonat malore.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 137-139, hartë e mjediseve jetësore të botës, atlas gjeografik, foto të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në këtë fazë të mësimin për të lidhur njohuritë që nxënësit dinë me njohuritë e reja zhvillohet një stuhi mendimesh:

Shqipëria ndodhet në zonën e klimës mesdhetare.

- Çfarë dini për florën dhe faunën që rriten në Shqipëri?

Flora	Fauna

» Idetë dhe mendimet e nxënësve shkruhen në tabelë.

Ndërtimi i njohurive të reja: Tabelë konceptesh

Në këtë fazë të mësimin udhëzohen nxënësit të lexojnë me vëmendje mësimin për të plotësuar tabelën e koncepteve të ndërtuar në tabelën e zezë nga mësuesi.

Nxënësit përshkruajnë veçoritë dalluese të mjediseve jetësore mesdhetare dhe të zonave malore.

Mjediset jetësore të zonës së nxehtë	Klima	Bota bimore	Bota shtazore
Mjediset jetësore mesdhetare			
Mjediset jetësore në zonat malore			

Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Në këtë fazë të mësimin për të kuptuar shkallën e përvetësimit të njohurive të reja zhvillohet teknika “Marrëdhëniet pyetje-përgjigje”.

- Cilat janë mjediset jetësore mesdhetare?
- Ç’kuptoni me mjedis jetësor të zonave malore?
- Si janë përshtatur bimët dhe kafshët me kushtet klimatike në zonat malore?

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, dhënies së përgjigjeve të sakta, plotësimit të tabelës së koncepteve.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën.

- Gjeni informacione të ndryshme për florën dhe faunën përreth detit Mesdhe.

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: SITUATË E SUGJERUAR 8 Plotësimi i përhapjes gjeografike i mjediseve jetësore të brezit të nxehtë dhe brezit mesatar.		Situata e të nxënës: Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përforcon konceptet për mjediset jetësore të nxehta e mesatare. - Përcakton në hartën skicë të botës shpërndarjen gjeografike të mjediseve jetësore të nxehta e mesatare.		Koncepte kyçe: Mjedise jetësore të brezit të nxehtë, mjedise jetësore të brezit mesatar.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Art pamor, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 142, hartë fizike e botës, hartë skicë e botës, hartë e mjediseve jetësore të botës, atlas, glob, laps, lapsa me ngjyra, gomë, fletore etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Faza e parë: Diskutim

Njihen nxënësit me orën e mësimi dhe veprimtaritë që do të kryen. Në këtë fazë zhvillohet një diskutim i lirë mes nxënësve për të përforcuar njohuritë kryesore të temave:

- “Mjediset jetësore të brezit të nxehtë”.
- “Mjediset jetësore të brezit mesatar”.

Faza e dytë: Punë në grupe

- Klasa ndahet në grupe me nga 4 anëtarë.
- Zgjidhet kryetari i grupit.
- Ndahen detyrat brenda grupit.

Nxënësit plotësojnë në hartën skicë të botës:

- Mjediset jetësore të brezit të nxehtë
- ✓ Pyjet ekuatoriale
- ✓ Savanet
- ✓ Shkretëtirat
- Mjediset jetësore të brezit mesatar
- ✓ Pyjet gjethërenëse
- ✓ Pyjet konifere
- ✓ Preritë
- ✓ Shkretëtirat e gjerësive mesatare

Faza e tretë: Diskutim

Në këtë fazë të mësimi diskutohet mbi punën e përfunduar, duke rregulluar gabimet e bëra.

- Krahasohen punët midis grupeve.
- Përcaktohet puna më e mirë midis grupeve.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të punës në grup, realizimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: SITUATË E SUGJERUAR 9 Plotësimi i përhapjes gjeografike i mjediseve jetësore mesdhetare, malore dhe i mjediseve jetësore të brezit të ftohtë.		Situata e të nxënësve: Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përforcon konceptet për mjediset jetësore mesdhetare, malore dhe të ftohta. - Përcakton në hartën skicë të botës shpërndarjen gjeografike të mjediseve jetësore mesdhetare, malore dhe të ftohta.		Koncepte kyçe: Mjedise jetësore mesdhetare, mjedise jetësore malore, mjedise jetësore të brezit të ftohtë.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Art pamor, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësve fq. 143, hartë fizike e botës, hartë skicë e botës, hartë e mjediseve jetësore të botës, atlas, glob, laps, lapsa me ngjyra, gomë, fletore etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Faza e parë: Diskutim

Njihen nxënësit me orën e mësimi dhe veprimtaritë që do të kryen. Në këtë fazë zhvillohet një diskutim i lirë mes nxënësve për të përforcuar njohuritë kryesore të temave:

- “Mjediset jetësore të brezit të ftohtë”.
- “Mjediset jetësore mesdhetare dhe mjediset jetësore në zonat malore”.

Faza e dytë: Punë në grupe

- Klasa ndahet në grupe me nga 4 anëtarë.
- Zgjidhet kryetari i grupit.
- Ndahen detyrat brenda grupit.

Nxënësit plotësojnë në hartën skicë të botës:

- Mjediset jetësore mesdhetare.
- Mjediset jetësore të brezit të ftohtë.
- ✓ Tundra
- ✓ Zonat polare
- Mjediset jetësore malore.

Faza e tretë: Diskutim

Në këtë fazë të mësimi diskutohet mbi punën e përfunduar, duke rregulluar gabimet e bëra.

- Krahasohen punët midis grupeve.
- Përcaktohet puna më e mirë midis grupeve.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të punës në grup, realizimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: PËRSËRITJE 5: Proceset dhe dukuritë natyrore në Tokë-Biosfera.		Situata e të nxënit: Organizimi i orës së mësimi. Veprimtaritë që do të zhvillohen.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përcakton lidhjen e biosferës me sferat e tjera të Tokës. - Identifikon mjediset jetësore nga ekuatori në pole. - Përcakton karakteristikat klimatike të secilës zonë. - Krahason botën bimore dhe shtazore të mjediseve jetësore.		Koncepte kyçe: Pyje ekuatoriale, savana, shkretëtira, pyje gjethërenëse, preri, shkretëtirë e gjerësive mesatare, tundër, mjedis jetësor i zonave polare, i zonave mesatare, në zonat malore etj.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Art pamor, Kimi.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 144, atlas gjeografik, hartë fizike e botës, tabakë letre, markera, etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Veprimi 1: Diskutim

Njohja e nxënësve me orën e mësimi dhe veprimtaritë që do të kryhen.

Diskutim mes nxënësish rreth njohurive të marra në mësimet e tematikës “Biosfera”.

Diskutohen me nxënësit çështjet e mëposhtme:

- Përshkruan lidhjen e biosferës me litosferën, atmosferën dhe hidrosferën.
- Tregon në hartë mjediset jetësore nga ekuatori në pole.
- Përcakton karakteristikat kryesore klimatike të mjediseve jetësore.
- Krahason botën bimore me atë shtazore të mjediseve jetësore.
- Analizon përshtatjen e bimëve dhe të kafshëve ndaj kushteve klimatike të secilit mjedis.

Veprimi 2: Punë në grupe

Nxënësit ndahen në disa grupe.

Grupeve u caktohet nga një mjedis jetësor për të plotësuar në tabelën e paraqitur më poshtë.

Mjedis jetësor	Shtirja gjeografike	Temperaturat	Reshjet	Bimësi	Kafshët

Secili grup pajiset me mjetet e nevojshme për realizimin e detyrës.

Veprimi 3: Turi i galerisë

Pas përfundimit të punës grupet, nëpërmjet turit të galerisë prezantojnë punën përpara klasës.

- Krahasohen punimet midis grupeve.
- Evidentohen punët më të mira.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimi, punës në grup, realizimit dhe prezantimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Hapësirat bregdetare, si hapësira të jetës njerëzore dhe mbrojtja e tyre.		Situata e të nxënësve: Paraqitja para nxënësve e hartës fizike të Shqipërisë.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e koncepteve “bregdet” dhe “zonë bregdetare”. - Përshkruan disa nga pasojat e ndotjes së bregdetit. - Vlerëson rëndësinë e bregdetit për njeriun. - Përcakton vlerat e veçanta mjedisore të zonave bregdetare në Shqipëri.		Koncepte kyçe: Bregdet, zonë bregdetare, toka të lagura, eutrofikimi, park detar, park kombëtar, biodiversitet, laguna.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 146-148, hartë fizike e Shqipërisë, foto të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Parashikimi me terma paraprak Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënësve. Në tabelën e zezë mësuesi shkruan fjalët kyç. Për secilën prej tyre, nxënësve u kërkohet një shpjegim si dhe të bëjnë lidhjen me mësimin e ri.

Zonë bregdetare

Zonë portuale

Ndotje alarmante e bregdetit

» Mirëpriten idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Ditarët tre pjesësh

Në këtë fazë të mësimin përdoret teknika “ditarët e të nxënësve” për të nxitur nxënësit të lexojnë në mënyrë të qëllimshme, të lidhin ngushtë materialin e tekstit me kureshtjen dhe përvojat e tyre. Nxënësit udhëzohen të lexojnë me vëmendje mësimin për të plotësuar ditarin e ndërtuar nga mësuesi në tabelë. Kolona e dytë plotësohet nga nxënësi, kurse kolona e tretë plotësohet nga mësuesi i cili plotëson dhe thellon më shumë njohuritë e tyre.

Citati	Komenti i nxënësit	Komenti i mësuesit
Domethënia e termit “bregdet” dhe “zonë bregdetare”		
Rëndësia e bregdetit dhe ndotja e tij.		
Zonat bregdetare me vlera të veçanta mjedisore		

» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim

Ftohen nxënësit në një diskutim të lirë rreth temës:

- Në lagunën e Karavastasë rritet pelikani kaçurrel, shpend në rrezik zhdukjeje. Vitet e fundit numri i tij ka ardhur duke u rritur?

- Pse? Jepni dy arsye.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, dhënies së përgjigjeve të sakta dhe plotësimit të ditarit të të nxënësve.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Mblidhni të dhëna (foto, të dhëna sasiore) për zonën bregdetare të Durrësit. Në bazë të përpunimit të të dhënave, shkruani katër fjali për problemet e ndotjes që mendoni se gjenden në këtë zonë.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Ndotjet mjedisore.		Situata e të nxënit: Leximi i pjesës së dhënë në tekst.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Shpjegon kuptimin e termit “ndotje mjedisore”. - Përcakton se cilat janë pasojat e ndotjes së mjedisit. - Rendit llojet e ndotjes. - Analizon burimet e ndotjes së ajrit.		Koncepte kyçe: Ndotje mjedisore, ndotës parësorë, ndotës dytësorë, PM(particulate matter), smog fotokimik, stacione monitorimi.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 149-151, foto të tekstit, informacione të internetit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:


Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Diskuti i lirë

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Pas leximit të pjesës së dhënë në tekst nxënësit ftohen në një diskutim të lirë rreth pyetjeve:

- Çfarë kuptoni me termin “ndotje mjedisore”?
- Kur themi që një mjedis është i ndotur?
- Cilat janë pasojat e ndotjes mjedisore?
- » Mirëpreiten idetë dhe mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Klaster

Në këtë fazë të mësimit udhëzohen nxënësit të lexojnë me vëmendje mësimin për të plotësuar klasterin e ndërtuar nga mësuesi në tabelë.



» Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Në këtë fazë të mësimit për të kuptuar shkallën e përvetësimit të njohurive të reja zhvillohet teknika “Marrëdhëniet pyetje-përgjigje”.

- Cili është kuptimi i termit “ndotje mjedisore”?
- Cilat janë pasojat e ndotjes mjedisore?
- Pse themi që ndotja është një emër i ri për një problem të vjetër?
- Cilat janë llojet e ndotjes?
- Cilat janë burimet e ndotjes së ajrit?
- Nga se shkaktohet smogu?
- Cili është smogu tipik në Shqipëri?

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimit, dhënies së përgjigjeve të sakta dhe plotësimit të klasterit.

Detyrat e shtëpisë: Mendoni në mënyrë kritike. Gjeni foto të ngjashme me fotot e mësimit, për mjedisin ku ju jetoni. Shkruani se çfarë problemesh vutë re për ndotjen e mjedisit tuaj.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE


Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Ndotja në zonat urbane.		Situata e të nxënit: Leximi i pjesës së dhënë në tekst.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përcakton ritmet e rritjes së urbanizimit në bashkinë e tij. - Shpjegon se përse qytetet quhen “ishuj urbanë të nxehtësisë”. - Rendit pasojat e ndotjes nga mbetjet urbane dhe ujërat e përdorura. - Analizon mënyrat e kontrollimit të ndotjes së ajrit në qytete. - Përcakton rrugët e përmirësimit të mjedisit në qytet.		Koncepte kyçe: Ndotje urbane, valët e të nxehtit, mbetje urbane, ujërat e zeza, standarde të cilësisë së ajrit, pika trafiku, riciklimi i mbetjeve.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 152-154, foto të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Pas leximit të pjesës së dhënë në tekst nxënësit ftohen në një stuhi mendimesh rreth pyetjes:

- Cilat janë problemet mjedisore që krijohen nga rritja e urbanizimit?



- Skica plotësohet hap pas hapi nga mendimet e nxënësve.

Ndërtimi i njohurive të reja: Ditarët tre pjesësh

Në këtë fazë të mësimi përdoret teknika “ditarët e të nxënit” për të nxitur nxënësit të lexojnë në mënyrë të qëllimshme, të lidhin ngushtë materialin e tekstit me kureshtjen dhe përvojat e tyre. Nxënësit udhëzohen të lexojnë me vëmendje mësimin për të plotësuar ditarin e ndërtuar nga mësuesi në tabelë. Kolona e dytë plotësohet nga nxënësi, kurse kolona e tretë plotësohet nga mësuesi i cili plotëson dhe thëllon më shumë njohuritë e tyre.

Citati	Komenti i nxënësit	Komenti i mësuesit
Qytetet, konsumatorë të energjisë dhe “ishuj të nxehtësisë”		
Mbetjet urbane dhe ujërat e përdorura		
Ndotja e ajrit dhe hapësirat e gjelbra		

- Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje ndotja? problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim i lirë

Në këtë fazë të mësimi ftohen nxënësit në një diskutim të lirë rreth temës:

- “Në qytetet shqiptare, orari me ajrin më të ndotur është gjatë mesditës deri në orën 16:00”, dhe rëndohet sidomos gjatë muajve të nxehtë.

- Si duhet ta mbrojmë shëndetin nga

Nxënësit mendimet e tyre i shkruajnë me tri fjali.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimi, dhënies së përgjigjeve të sakta dhe plotësimit të ditarit tri pjesësh.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Shkruani propozimet për përmirësimin e mjedisit në zonën më të ndotur të bashkisë suaj. Bëni një letër si klasë dhe dërgojeni në bashki.


Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Ndotja në zonat rurale.		Situata e të nxënit: Krahasim midis zonës urbane dhe zonës rurale.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Demonstron të kuptuarit e konceptit “zonë rurale”. - Përshkruan tiparet e zonës rurale. - Shpjegon me fjalët e tekstit konceptin “zhvlerësim të tokës bujqësore”. - Përcakton rastet kur ndodh degradimi i tokës bujqësore. - Shpjegon mënyrën e ndotjes së ujërave nga përdorimi i plehrave kimike në bujqësi. - Shpjegon procesin e eutrofikimit të ujërave.		Koncepte kyçe: Degradimi i tokës, toka të varfra, ujëra të mbiushqyera, ujëra të eutrofikuar, përmblytje, rrëshqitje.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Biologji, Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 155-157, foto të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Stuhi mendimesh

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në këtë fazë të mësimin për të tërhequr vëmendjen e nxënësve zhvillohet një stuhi mendimesh rreth pyetjeve:

- Ç’kuptoni me zonë rurale?
- Cilat janë disa nga tiparet e zonës rurale?
- Nga ndryshon zona rurale nga zona urbane?
- » Skica plotësohet hap pas hapi nga mendimet e nxënësve.



Ndërtimi i njohurive të reja: Tabelë konceptesh

Në këtë fazë të mësimin udhëzohen nxënësit të ndarë në grupe të lexojnë me vëmendje pjesët përkatëse për të plotësuar tabelën e koncepteve të ndërtuar nga mësuesi në tabelën e zezë.

Ndotja në zonat rurale		
Degradimi i tokës bujqësore	Përmblytjet dhe rrëshqitjet	Ndotja e ujit nga bujqësia
<i>Grupi i parë</i>	<i>Grupi i dytë</i>	<i>Grupi i tretë</i>

Vlerësime, komente, sugjerime, zgjidhje problemesh.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Diskutim i lirë

Ftohen nxënësit në një diskutim të lirë rreth temës:

- “Ndryshe nga të parët tanë, që e vlerësonin tokës si “tokë buke”, (për nga rëndësia), në ditët e sotme, toka e punueshme përdoret për ndërtim”.
- Cili brez ka vepruar më mirë?

Mendimet e nxënësve shkruhen në katër fjali.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, dhënies së përgjigjeve të sakta, plotësimit të tabelës së koncepteve dhe dhënies së mendimit në diskutimin e lirë.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Pesticidet dhe herbicidet janë substanca helmuese dhe duhen përdorur në sasi të kontrolluar. Kërkoni informacionin se si përdoren kimikatet në territorin rural të bashkisë suaj. Shkruajeni përgjigjen tuaj në katër fjali.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: Ndërveprimi njeri-mjedisi.		Situata e të nxënit: Trajtimi i mbetjeve të ngurta (MNU)	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Shpjegon kuptimin e konceptit “mbetje”. - Përshkruan mënyrën e klasifikimit të mbetjeve. - Shpjegon mënyrat e ndryshme të trajtimit të mbetjeve.		Koncepte kyçe: Ripërdorim, riciklim “oqeanet po vdesin”, rikuperim.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 158-160, foto të tekstit etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve: Parashikimi me terma paraprakë

Nxënësit njihen me temën e re dhe rezultatet e të nxënit. Në tabelën e zezë shkruhen termat e mëposhtëm:

- ☐ Trajtimi i mbetjeve të ngurta (MNU).
- ☐ Reduktim-Ripërdorim-Riciklim-Rikuperim.

Nxënësit do të shpjegojnë me fjalët e tyre secilën prej termave dhe do të bëjnë lidhjen me temën e mësimi.

Ndërtimi i njohurive të reja: Lexim i drejtuar

Në këtë fazë të mësimi realizohet teknika “lexim i drejtuar” ku nxënësit të ndarë në grupe udhëzohen të lexojnë pjesët përkatëse për t’ju përgjigjur pyetjeve të hartuara më parë nga mësuesi në flipçart:

HAPI I PARË: Mbetjet dhe trajtimi i tyre.

- Çfarë janë mbetjet?
- Sa mbetje prodhojmë?
- Përse shkencëtarët përdorin shprehjen “oqeanet po vdesin”?

HAPI I DYTË: Llojet e mbetjeve.

- Si klasifikohen mbetjet sipas origjinës?
- Si klasifikohen mbetjet sipas rrezikshmërisë?
- Si klasifikohen mbetjet sipas përbërjes?

HAPI I TRETË: Trajtimi i mbetjeve të ngurta (MNU).

- Çfarë kuptoni me termin “reduktim”?
- Çfarë është ripërdorimi?
- Çfarë është riciklimi?
- Si ndodh procesi i rikuperimit?
- Cilat janë përfitimet e përdorimit të MNU-ve?

Mendimet e nxënësve plotësohen dhe sqarohen nga mësuesi.

Demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë me tekstin

Nxënësit në këtë fazë të mësimi udhëzohen të punojnë me rubrikën në tekst: “Mendoni në mënyrë kritike”.

“Në Shqipëri, çdo banor prodhon mesatarisht mbi 0.5 kg mbetje në ditë. Pjesa më e madhe e tyre hidhet nëpër oborre, rrugë, trotuare, fusha, kodra, male, lugina. Më pas, mbetjet përfundojnë në lumenj, liqene, dete dhe oqeanet”.

Nxënësit do të shkruajnë katër fjali ku do të tregojnë:

- » Pasojat që sjellin këto veprime të njerëzve për jetën.
- » Propozimin tuaj për përmirësimin e kësaj situatë në vendbanimin tuaj.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimi, dhënies së përgjigjeve të sakta.

Detyrat e shtëpisë: Zgjidhni situatën. Kërkoni informacion se si trajtohen mbetjet spitalore të spitalit në bashkinë tuaj. Gjetjet tuaja i shkruani në katër fjali.

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: SITUATË E SUGJERUAR 9 Plotësimi i përhapjes gjeografike i mjediseve jetësore mesdhetare, malore dhe i mjediseve jetësore të brezit të ftohtë.		Situata e të nxënës: Organizimi i punës në grupe, ndarja e detyrave.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përforcon konceptet për mjediset jetësore mesdhetare, malore dhe të ftohta. - Përcakton në hartën skicë të botës shpërndarjen gjeografike të mjediseve jetësore mesdhetare, malore dhe të ftohta.		Koncepte kyçe: Mjedise jetësore mesdhetare, mjedise jetësore malore, mjedise jetësore të brezit të ftohtë.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Art pamor, Biologji.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit fq. 143, hartë fizike e botës, hartë skicë e botës, hartë e mjediseve jetësore të botës, atlas, glob, laps, lapsa me ngjyra, gomë, fletore etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Faza e parë: Diskutim

Njihen nxënësit me orën e mësimi dhe veprimtaritë që do të kryen. Në këtë fazë zhvillohet një diskutim i lirë mes nxënësve për të përforcuar njohuritë kryesore të temave:

- “Mjediset jetësore të brezit të ftohtë”.
- “Mjediset jetësore mesdhetare dhe mjediset jetësore në zonat malore”.

Faza e dytë: Punë në grupe

- Klasa ndahet në grupe me nga 4 anëtarë.
- Zgjidhet kryetari i grupit.
- Ndalen detyrat brenda grupit.

Nxënësit plotësojnë në hartën skicë të botës:

- Mjediset jetësore mesdhetare.
- Mjediset jetësore të brezit të ftohtë.
- ✓ Tundra
- ✓ Zonat polare
- Mjediset jetësore malore.

Faza e tretë: Diskutim

Në këtë fazë të mësimi diskutohet mbi punën e përfunduar, duke rregulluar gabimet e bëra.

- Krahasohen punët midis grupeve.
- Përcaktohet puna më e mirë midis grupeve.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të punës në grup, realizimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

MODELE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: <i>Projekt: Ndotja mjedisore dhe llojet e saj (ora e tretë).</i>		Situata e të nxënit: Prezantimi i produktit (projektit) nga secili grup.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Ndërton njohuri për ndotjet dhe pasojat e tyre në mjedisin lokal. - Komunikon (me shkrim, gojë, grafikisht dhe vizualisht) shpërndarjen hapësinore të ndotjeve në mjedisin lokal. - Propozon alternativa, strategji apo zgjidhje të mundshme për llojet e ndryshme të ndotjeve në mjedisin lokal.		Koncepte kyçe: Ndotja e mjedisit, ndotja e ajrit, ndotja e ujit, ndotja e tokës.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Matematikë, Fizikë, biologji, Kimi, TIK, Qytetari.		Burimet dhe mjetet mësimore: Interneti, videoprojektor,Power -Point, postera, broshura, fletë palosje, album me fotografi.	
METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE: FAZA E TRETË (ORA E TRETË) Në këtë fazë nxënësit prezantojnë projektet e tyre sipas grupeve përkatëse. Prezantimi bëhet me programin Power-Point, postera, broshura, fletëpalosje dhe album me foto. Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për: - Vlerësim pozitiv për të gjithë nxënësit që arrijnë të përfundojnë projektin. - Punën në grup dhe punën individuale. - Realizimit të projektit. - Prezantimin dhe paraqitjen e punës. Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.			

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Gjeografi	Shkalla: 3	Klasa: 7
Tema mësimore: PËRSËRITJE 6 Shoqëria dhe ndërveprimi me mjedisin.		Situata e të nxënësve: Organizimi i orës së mësimin. Veprimtaritë që do të zhvillohen.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Hulumton dhe vëzhgon nga burime të ndryshme mbi ndotjen e mjedisit në vendbanimin e tij. - Ndërton njohuri mbi mjedisin lokal mbi llojet e ndotjes së tij. - Grumbullon, sintetizon, analizon dhe vlerëson të dhënat dhe zhvillon një përfundim apo një gjetje kyç mbi ndotjen e mjedisit lokal.		Koncepte kyçe: Ndotja e tokës, ndotja e ujit, ndotja e ajrit, ndërtimet në bregdet, degradimi i tokës, smogu në zonat urbane, përmytjet, rrëshqitjet.	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Art pamor.		Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësve fq. 163, informacione nga interneti apo burime të tjera, karton, markera, etj.	

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARITË E NXËNËSVE:

Veprimi 1: Diskutim

Njohja e nxënësve me orën e mësimin dhe veprimtaritë që do të kryhen.

1. Nxënësve ndahen në grupe dhe secili grup përcakton dhe përzgjedh një temë rreth tematikës: “Shoqëria dhe ndërveprimi me mjedisin”.

2. Nxënësve propozojnë një vend për ekskursion sipas tematikës që kanë përzgjedhur për studim.

3. Mësuesi përzgjedh vendin e ekskursionit, duke vlerësuar propozimin më të mirë midis grupeve.

Veprimi 2: Punë në grupe

➤ Dita e ekskursion-konkursit do të ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë nxënësve do të bëjnë një studim të terrenit duke mbajtur shënime se çfarë zbuluan.

➤ Përfundimet do të paraqiten në një karton.

➤ Përfundimet do të raportohen gjatë pjesës së dytë të ditës, kur të fillojë konkursi.

Për studimin e terrenit mund të zgjidhen disa nga mundësitë e mëposhtme:

• Informacione mbi “zonën pyjore”, zona kullotë”.

• Informacione mbi “turizmin rural”

• Informacion për “monumentet e natyrës”.

• Informacion për “biodiversitetin detar”.

• Informacion për “prodhimin e plehut organik”.

• Informacion mbi, “pikat e nxehta” të ndotjes nga mbetjet urbane, dhe “pikat e nxehta” të ndotjeve industriale.

Secili grup pajiset me mjetet e nevojshme për realizimin e detyrës.

Veprimi 3: Konkurs

Pas përfundimit të punës grupet, zhvillohet një konkurs midis grupeve për paraqitjen dhe interpretimin e punës së tyre.

❖ Krahasohen punimet midis grupeve.

❖ Evidentohen punët më të mira.

❖ Shpallet grupi fitues.

Vlerësimi: Bëhet në bazë të pjesëmarrjes aktive në të gjitha etapat e mësimin, punës në grup, realizimit dhe prezantimit të detyrës.

Detyrat e shtëpisë: Përfundime dhe këshillime.

VLERËSIMI I NXËNËSIT

Vlerësimi i nxënësve është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencat. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënësve, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësve (njohuri, shkathtësi, qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve. Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilat përcaktohen si të domosdoshme për të gjykuar në lidhje me arritjet e nxënësve, në funksion të mbështetjes së të nxënësve dhe mësimdhënies.

- Paketa e dokumenteve për vlerësimin përfshin:
- Kornizën e vlerësimit të nxënësve për arsimin parauniversitar (MAS, Nr. 5563, dt, 23.07.2015)
- Udhëzimin e MAS-it, nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca në arsimin bazë”.
- Nivelet e arritjeve të nxënësve për vlerësimin e kompetencave, shkallët 3-4 (klasat 6-9).
- Formatet sugjeruese të evidencave për vlerësimin e vazhduar.

Vlerësimi për të nxënë i nxënësit kryhet nëpërmjet:

- vlerësimit të vazhduar;
- vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse;
- vlerësimit të portofolit lëndor të nxënësit.

Vlerësimi i vazhduar

Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët me shkrim, punët në grup, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës, përgjatë një periudhe.

Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse

- Në përfundim të periudhës kryhet vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse, e cila ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxënësve.
- Mësuesi përzgjedh të zhvillojë test ose detyrë përmbledhëse, në varësi të veçorive të lëndës.
- Testi përmbledhës është test që përmban vetëm rezultatet e të nxënësve (njohuritë dhe shkathtësitë) kryesore të periudhës përkatëse. Koha e realizimit të testit është 45 min si të gjitha testet e tjera.

Vlerësimi me portofol lëndor

- Portofoli është koleksionim sistematik i detyrave dhe punimeve krijuese dhe hulumtuese të kryera nga nxënësi përgjatë periudhës për të dëshmuar zhvillimin e kompetencave (njohuri, shkathtësi, qëndrime).
- Mësuesi udhëzon nxënësit për krijimin e portofolit dhe bashkëpunon me ta rreth përmbajtjes së tij. Në fillim të periudhës, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, përcaktojnë detyrat dhe punimet që do të përfshijnë në portofol përgjatë periudhës, në varësi të specifikave të lëndës.
- Këto detyra zhvillohen gjatë periudhës dhe nuk janë pjesë e vlerësimit të vazhduar (në evidencë), por vetëm pjesë e portofolit lëndor. Sugjerohet që përgjatë një periudhe, të përfshihen në portofol, të paktën 3 detyra të nxënësit, përfshirë projektin ose një nga fazat e tij.
- Pjesë e portofolit është edhe projekti kurrikular. Projekti kurrikular mund të jetë i shtrirë vetëm brenda një periudhe, por mund të jetë i shtrirë (nëse është një) edhe përgjatë gjithë vitit.
- Rubrikat e portofolit mund të grupohen në:
- punë dhe detyra të kryera në klasë dhe jashtë saj, si punë praktike, punë laborator, ese, detyrë me shkrim etj.;
- projekte individuale ose në grup;
- detyra dhe kontribute të pavarura të nxënësit, të cilat janë dëshmi e talentit, e hulumtimeve praktike, e punëve tematike (me shkrim, audio-vizuale etj.).

Vlerësimi periodik

Vlerësimi periodik bëhet në përfundim çdo periudhe dhe përmban tri nota:

GJEOGRAFI 7 - LIBRI I MËSUESIT

- *Nota e vlerësimit të vazhdueshëm (NVv)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Nota e vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse (NTp)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.
- *Nota e vlerësimit të portofolit lëndor (NVp)*, e cila vendoset në regjistër në kolonën përkatëse në faqet e vlerësimit.

Vlerësimi përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar shënohet në regjistër duke plotësuar kolonat “Vlerësimi vjetor” dhe në kolonën “Nota përfundimtare”. Vlerësimet vjetore përmbajnë:

- *Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar* që është rezultat i tri periudhave.
- *Notën vjetore të vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse* që është rezultat i tri periudhave.
- *Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit* që është rezultat i tri periudhave.

Nota përfundimtare llogaritet me përqindje për secilën nga rubrikat

Tabela: Pesha në përqindje e llojeve të vlerësimit

Lloji i vlerësimit	Pesha në përqindje
Vlerësimi i vazhdueshëm	40%
Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse	40%
Vlerësimi i portofolit të nxënësit	20%

$$(NV_v \times 0.4) + (NT_p \times 0.4) + (NV_p \times 0.2) = \text{Nota përfundimtare}$$

Nota përfundimtare 8

Shembull 1: Gjeografi, klasa VI

Tremujori I			Tremujori II			Tremujori III			Notat vjetore			Nota përfundimtare
NV V	NT _p	NVP	NV V	NT _p	NVP	NV V	NT _p	NVP	NV V	NT _p	NVP	
8	7	8	7	7	8	8	7	8	8	7	8	

$$(8 \times 0.4) + (7 \times 0.4) + (8 \times 0.2) = 7.6$$

REFERENCAT:

1. Kurrikula e bazuar në kompetenca.
Lënda Gjeografi Shkalla 3 (klasa 6-7). Tiranë 2016
2. Udhëzimi për zhvillimin e kurrikulës së re në AMU. (Janar 2017)
3. Portofoli i të nxënës. Tregues i arritjes së kompetencave. (Shtator 2016)
Udhëzimi nr. 34 *Vlerësimi i*

Ç'ËSHTË TESTIMI?

Testimi është një nga gjashtë teknikat e vlerësimit të njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave të nxënësve.

Teknikat e vlerësimit janë:

1. Vlerësimi me shkrim (testet)
2. Vlerësimi me gojë
3. Vlerësimi me anë të dëgjimit
4. Vlerësimi praktik
5. Vlerësimi me anën e pyetësorëve të nxënësve
6. Vlerësimi i projekteve, punëve kërkimore dhe i punëve në terren

Testimi si koncept shpreh zhvillimin e matjeve sipas një synimi ose objektivi të caktuar. Testimi shoqërohet me vlerësimin.

Pyetjet në hartimin e testeve duhet të respektojnë taksonominë e pyetjeve, i cili është një sistem për klasifikimin e pyetjeve sipas niveleve të vështirësisë. Nivelet e ndryshme të taksonomisë së pyetjeve janë:

1. Njohja: mbajtja mend e përkufizimeve, vlerave.
2. Kuptimi: ndryshimi i informacionit nga një formë në një tjetër.
3. Zbatimi: përdorimi i rregullave dhe i parimeve për të zgjidhur problemat.
4. Analiza: të shihen lidhjet shkak-pasojë.
5. Sinteza: përmbledhja e ideve duke ruajtur kuptimin bazë.
6. Vlerësimi : krijimi i kriterëve ku të vlerësohen situatat dhe të jepen gjykime.

TEST NR.1 (TREMUIJORI I PARË) GJEOGRAFI KLASA VII

EMËR MBIEMËR

PIKË

NOTA

1. **Përkufizoni fjalët:** 8 pikë

- a. Diell _____
- b. Gjithësi _____
- c. Rruga e qumështit _____
- d. Forcë e rëndesës _____
- e. Forcë magnetike _____
- f. Boshti i Tokës _____
- g. Kohë zonale _____
- h. Eklips _____

2. **Rendit planetët sipas largësisë nga Dielli:** 8 pikë

- 1 _____, 2 _____, 3 _____, 4 _____,
5 _____, 6 _____, 7 _____, 8 _____.

3. **Plotëso: Përcakto disa nga veçoritë e planetit tonë.** 4 pikë

- a. Toka është planet i për nga largësia prej Diellit.
- b. Hëna është sateliti natyror i
- c. Toka ka formën e një sfere me të rregullt, e shtypur në dhe më e gjerë në
- d. Diametri polar i Tokës ështëkm kurse ai ekuatorial ështëkm.

4. **Përcakto stinët në Hemisferën jugore :** 4 pikë

Hemisfera veriore

Hemisfera jugore

Verë

Pranverë

Dimër

Vjeshte

5. **Përcakto shtresat përbërëse të atmosferës.** 5 pikë

- a. _____
- a. _____
- a. _____
- a. _____
- a. _____

6. **Përcaktoni dhe shpjegoni faktorët që ndikojnë në formimin e brezave të ndriçimit:** 8 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

7. Lidh me shigjetë :

4 pikë

Temperatura	Barometër
Trysni atmosferike	Fluger
Era	Pluviometër
Reshjet	Termometër

8. Shpjego faktorët e formimit të klimës :

10 pikë

KLIMA				
Gjerësia gjeografike	Masat ajrore	Lartësia mbi nivelin e detit	Largësia nga detet e liqenet	Veprimtaria e njeriut

9. Përcakto fazat e qarkullimit të ujit në natyrë:

4 pikë

- 1
- 2
- 3
- 4

10. Përkthyeri veçoritë e ujit të deteve dhe oqeanëve.

6 pikë

11. Krahasoni:

6 pikë

Rryma oqeanike		
Të ngrohta	Tiparet e përbashkëta	Të ftohta
Tiparet e veçanta		Tiparet e veçanta

Tabela e pikëve:

Pikët	0-17	18-26	27-35	36-44	45-52	53-59	60-67
Notat	4	5	6	7	8	9	10

TEST NR.2 (TREMUIORI I PARË) GJEOGRAFI KLASA VII TEMATIKA: TOKA NË HAPËSIRË (I SUGJERUAR)

Emri Mbiemri i nxënësit: _____

Klasa _____

1. Përkufizoni fjalët: 12 pikë

- A) Diell _____
- B) Gjithësi _____
- C) Xhordano Bruno _____
- D) astronom _____
- E) teleskop _____
- F) Galaktika jonë _____
- G) Rruga e Qumshtit _____
- H) asteroid _____
- I) kometë _____
- J) "Apollo11" _____
- K) kohë lokale _____
- L) kohë zonale _____

2. Renditni planetët sipas largësisë nga Dielli. 9 pikë

- a) Mërkuri
- b) Toka
- c) Afërdita
- d) Jupiteri
- e) Marsi
- f) Saturni
- g) Urani
- h) Neptuni
- i) Plutoni

3. Përcaktoni nëse fjalitë e mëposhtme janë të vërteta (V) apo të gabuara (G) 8 pikë

a) Yjet janë trupa qiellorë të zjarrtë që lëvizin në hapësirë dhe që rrezatojnë dritë dhe nxehtësi përreth tyre. _____

b) Të gjitha galaktikat largohen gjithmonë e më shumë prej galaktikës sonë dhe prej njëra-tjetrës. _____

c) Gjithësia nuk ka një moshë të caktuar dhe një masë të caktuar.

d) Gjithësia, si një tërësi, nuk ka fillim të përcaktuar, as fund të përcaktuar, por ajo zgjerohet

vazhdimisht dhe në pafundësi. _____

e) Dielli është qendra e sistemit tonë diellor _____

e) Pozita e planetit Tokë, as shumë afër dhe as shumë larg Diellit, por edhe prania e atmosferës përreth saj, bëjnë të mundur që Toka të ketë temperaturë të përshtatshme për ekzistencën e jetës në të.

f) Nikolla Kopernik zbuloi pozicionin e saktë të Tokës, si e treta në raport me Diellin, dhe se Hëna rrotullohet rreth saj. _____

g) Këndi që formojnë rrezet e Diellit me sipërfaqen e Tokës, nuk është i ndryshëm në pjesë të ndryshme të saj.

4. Shpjegoni se cila është forma e Tokës duke argumentuar njohuritë tuaja. 5 pikë

5. Përse në planetin tonë ka jetë ? Argumentoni. 5 pikë

6. Paraqitni skemën e formimit të stinëve dhe shpjegoni pse formohen ato? 5 pikë

7. Përshkruani rrjedhojat gjeografike të rrotullimit ditor të Tokës. 5 pikë

8. Vlerësoni, pse është e rëndësishme ruajtja e planetit ku jetojmë? 5 pikë

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-17	18-23	24-29	30-35	36-41	42-47	48-54


TEST NR.3 (TREMUJORI I DYTË) GJEOGRAFI KLASA VII

EMËR MBIEMËR _____

PIKË _____

NOTA _____

1. **Përkufizoni fjalët:** 10 pikë
 - a. Lum _____
 - b. Pellg ujëmbledhës _____
 - c. Meandër _____
 - d. Liqen tektonik _____
 - e. Ujëra arteziane _____
 - f. Burim karstik _____
 - g. Cirqe akullnajore _____
 - h. Bërthama e Tokës _____
 - i. Lartësi absolute _____
 - j. Shkëmbinj magmatikë _____
2. **Plotëso tabelën:** 4 pikë



3. **Listo kontinentet e rruzullit tokësor sipas madhësisë së tyre.** 7 pikë
 - 1 2 3 4
 - 5 6 7
4. **Përkufizoni tre klasat e relievit:** 6 pikë
 - a. Klasa e parë _____
 - b. Klasa e dytë _____
 - c. Klasa e tretë _____
5. **Plotëso tabelën: Përkufizoni karakteristikat e lartësisë absolute dhe lartësisë relative.** 4 pikë

Lartësi absolute	Lartësi relative

6. **Klasifiko malet sipas vendndodhjes, lartësisë mbi nivelin e detit, moshës dhe origjinës së formimit të tyre:** 8 pikë

Vendndodhjes _____

Lartësisë mbi nivelin e detit _____

Moshës _____

Origjina e formimit _____

7. Plotëso tabelën: Përshkruaj mënyrën e formimit të fushave sipas origjinës.

6 pikë

Origjina e formimit të fushave		
Aktiviteti vullkanik	Veprimtaria gërryese e akujve dhe e ujit	Veprimtaria tektonike

8. Emërto liqenet sipas origjinës së formimit.

4 pikë

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____

9. Përcakto dhe shpjego faktorët që ndikojnë në formimin e dherave:

8 pikë

10. Çfarë janë tërmetet dhe si shkaktohen ato?

4 pikë

11. Cilët janë pjesët përbërëse të një vullkani?

4 pikë

- a. _____
- b. _____
- c. _____
- d. _____

Tabela e pikëve:

Pikët	0-17	18-26	27-35	36-44	43-52	53-59	60-66
Notat	4	5	6	7	8	9	10

TEST NR.4 (TREMUIJORI I DYTË) GJEOGRAFI KLASA VII

Emri Mbiemri i nxënësit: _____

Klasa _____

1. Përkufizoni fjalët:

8 pikë

- A) Atmosferë _____
- B) kufiri i ngopjes _____
- C) ciklon _____
- D) anticiklon _____
- E) trysni _____
- F) shiu acid _____
- G) smogu _____
- H) trysni _____

2. Renditni llojet e brezave të ndriçimit dhe pesë brezat e tyre.

2 pikë

3. Renditni zonat klimatike të Europës.

2 pikë

4. Përcaktoni nëse fjalitë e mëposhtme janë të vërteta (V) apo të gabuara (G)

9 pikë

a) Raporti midis peshës së ajrit dhe sipërfaqes mbi të cilën ai ndodhet quhet trysni. _____

b) Breshëri formohet kur masa ajrore lëviz menjëherë në lartësi, për rrjedhim ndryshojnë shumë shpejt kushtet e temperaturës së ajrit ku reja gjendet. _____

c) Aftësia e Atmosferës për të larguar ngrohtësinë në afërsi të Tokës, quhet "efekt serrë" _____

d) Musonet krijohen në brendësi të kontinenteve _____

e) Era është zhvendosje e ajrit me një forcë që mund të shkojë deri në disa dhjetëra metra në sekondë. _____

f) Izobari është një vijë që bashkon pikat me temperaturë të njëjtë atmosferike në një territor të caktuar. _____

g) Moti është gjendja njëvjeçare e klimës në një çast të caktuar dhe në një vend të caktuar, për sa u përket vlerave të temperaturës, trysnisë dhe lagështisë, si dhe për sa u përket dukurive meteorologjike si vranësira, reshjet, dhe erërat. _____

h) Energjia diellore mund të shndërrohet në energji elektrike ose në energji termike. _____

h) Energjia diellore mund të shndërrohet në energji elektrike ose në energji termike. _____


j) Shkenca e gjeografisë parashikon motin.

5. Kur flasim për lagështirën në ajër, ne përdorim disa tregues për ta matur. Të tilla janë: lagështira absolute, kufiri i ngopjes dhe lagështira relative. Shkruani nga një fjali për secilin tregues ku të tregoni se në ç'mënyrë e matim lagështirën në ajër. 5 pikë

6. Emërtoni situatën në foton e mëposhtme. 5 pikë



7. Vëzhgoni hartën e izobareve të Europës. Shkruani zonat që tregojnë trysni të lartë dhe ato me trysni të ulët. 5 pikë



Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-7	8-12	13-18	19-23	24-28	29-32	33-36

TEST NR.5 (TREMUIJORI I TRETË)


GJEOGRAFI KLASA VII

EMËR MBIEMËR

PIKË

NOTA

1. Plotëso skemën: Faktorët kryesorë që ndikojnë në përhapjen e bimëve dhe kafshëve në rruzullin tokësor: 5 pikë



2. Përcakto shtrirjen gjeografike të mjedisve jetësore të zonës së nxehte: 6 pikë

- Pyjet tropikale _____
- Savanet _____
- Shkretëtirat _____

3. Plotëso fjalitë:

4 pikë

- Mjediset jetësore të zonës së ftohtë gjenden përreth dhe
 • Ato janë përhapur në skajet veriore të kontinenteve të Europës, , dhe përreth Oqeanit të Ngrirë të Veriut dhe
 • Mjediset jetësore të zonës mesatare gjenden midis dhe
 • Ato janë të përhapura në kontinentet e Australisë, , , Afrikës , , Amerikës së Jugut.

4. Përcakto shtrirjen e mjedisit të veçantë mesdhetar:

3 pikë

-
-
-

5. Krahaso: Shkretëtirat e ngrohta me shkretëtirat e gjerësive mesatare.

6 pikë

Shkretëtira të ftohta Të veçantat	Të përbashkëta	Shkretëtira të ngrohta Të veçantat

6. Listoni katet e bimësisë:

4 pikë

- a. -----
- b. -----
- c. -----
- d. -----

7. Vlerësoni rëndësinë e bregdetit në jetën tonë:

6 pikë

Rëndësia e bregdetit		
Transporti	Banimi	Ushqimi

8. Cilat janë pasojat e ndotjes mjedisore?

4 pikë

9. Listoni dhe përshkruani kategoritë e substancave ndotëse të ajrit.

4 pikë

10. Plotësoni tabelën: Përshkruaj ndotjen në zonën urbane dhe në zonën rurale. 6 pikë

Ndotja në zonat urbane	Ndotja në zonat rurale

Tabela e pikëve:

Pikët	0-12	13-19	20-26	27-33	34-39	40-44	45-48
Notat	4	5	6	7	8	9	10

TEST NR.6 (TREMUJORI I TRETË)
GJEOGRAFI KLASA VII
TEMATIKA: HIDROSFERA (I SUGJERUAR)

Emri Mbiemri i nxënësit: _____

Klasa _____

1. Përkufizoni fjalët: 10 pikë

- A) Oqean _____
- B) Det _____
- C) Gji detar _____
- D) Baticë-zbaticë _____
- E) Rrymë oqeanike _____
- F) Kep _____
- G) Abrasion _____
- H) Erozion _____
- I) Ujëra nëntokësore _____
- J) Liqen _____

2. Lidhni me shigjetë detet me llojshmërinë e tyre: 4 pikë

- | | |
|-----------------------|---------------|
| b) dete të brendshme | Deti i Veriut |
| c) dete ndërishullore | Deti Kaspik |
| d) dete anësore | Deti Egje |
| e) dete të mbyllura | Deti Mesdhe |

3. Përcaktoni nëse fjalitë e mëposhtme janë të vërteta (V) apo të gabuara (G). 10 pikë

- 1. Litosfera, hidrosfera, atmosfera janë tri sferat që u përkasin sistemeve abiotike. _____
- 2. Hidrosfera ndërvepron me atmosferën, por nuk ndikon në formimin e klimës dhe të motit. _____
- 3. Uji kur është në gjendje të ngurtë, zhytet në ujë _____
- 4. Avullimi është procesi i shndërrimit të ujit nga gjendje e lëngët në gjendje të gaztë _____
- 5. Uji i detit është më pak i kripur në zonat e nxehta (ekuatoriale) sesa në zonat e ftohta (polare) _____
- 6. Pjesa më e cekët e detit, që është nën ndikimin e baticë-zbaticave, quhet fushë abisale _____
- 7. Cunamit njihen ndryshe si valë detare sizmike, pasi 80% e tyre ndodhin për shkak të tërmeteve nënujore. _____
- 8. Materialet e depozituara në plazhe, duke iu nënshtuar veprimtarisë së erës, krijojnë dunat bregdetare. _____
- 9. Shpejtësia e një rrjedhjeje ujore, nuk varet shumë nga pjerrësia e terrenit. _____
- 10. Liqene quajmë gropa të mëdha të mbushura me ujë, të cilat nuk komunikojnë drejtpërdrejt me detin _____

4. Shpjegoni: Përse gjatë stinës së dimrit, në temperaturat nën 0°C, mund të ndodh çarja e tubave të ujit? 5 pikë

5. Përse brigjet perëndimore të kontinenteve të Hemisferës Jugore janë më të ftohta? Nga cilat rryma oqeanike ndikohen ato? 5 pikë

6. Paraqitni skemën e qarkullimit të ujit në natyrë dhe shpjegoni sesi ndodh ai? 5 pikë

7. Skiconi skemën e një vale detare në lëvizje dhe paraqitni elementët e saj. 5 pikë

8. Vlerëso shkurtimisht: përse uji është një e mirë me vlerë e cila duhet ruajtur dhe mirëpërdorur? 5 pikë

Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-12	13-18	19-24	25-30	31-36	37-42	43-49

TEST NR.7 (TREMUIJORI I TRETË) GJEOGRAFI KLASA VII


1. Përkufizoni fjalët:

10 pikë

- a) Mantel _____
- b) Reliev _____
- c) Izohipsë _____
- d) Mal _____
- e) Fushë _____
- f) Shkëmbinjtë magmatikë _____
- g) Tërmet _____
- h) Epiqendër _____
- i) Krater _____
- j) Vullkan _____

2. Plotësoni strukturën e brendshme të Tokës në figurën e mëposhtme:

4 pikë



3. Përcaktoni nëse fjalitë e mëposhtme janë të vërteta (V) apo të gabuara (G)

8 pikë

- 1. Në vendin tonë, trashësia e kores kontinentale, arrin 34 km. _____
- 2. Manteli është shtresa më e brendshme e Tokës. _____
- 3. Të gjitha kontinentet e sotme, kanë qenë të bashkuar në kontinentin e madh, Pangea, i cili filloi të ndahej në kontinente rreth 200 milionë vite më parë. _____
- 4. Malet e vjetra janë më të larta se malet e reja dhe kanë maja të mprehta. _____
- 5. Alpet shqiptare janë alpet e reja. _____
- 6. Rrafshnalta më e madhe dhe më e lartë në botë është rrafshnalta e Dekanit. _____
- 7. Shkëmbinjtë janë bashkime në mënyrë natyrore i një ose më shumë mineraleve. _____
- 8. Mermerët _____ janë _____ shkëmbinj
meta morfik. _____

4. Cilat janë zonat e përhapjes gjeografike të tërmeteve?

6 pikë

- A) _____
- B) _____
- C) _____

5. Përcaktoni se në cilin brez të dherave (tokave) ndodhet vendlindja juaj, në varësi të lartësisë? Cili është përdorimi ekonomik i tyre?

5 pikë


6. Plotësoni mjediset jetësorë sipas brezave të nxehtësisë:

10 pikë

Brezat e nxehtësisë	Mjediset jetësore
Brezi i nxehtë	
Brezi mesatar	
Brezi i ftohtë	

7. Plotësoni skemën e një vullkani duke paraqitur pjesët përbërës të tij

5 pikë



8. Shihni foton ku paraqitet pamja nga fusha e Myzeqesë. Vlerësoni shkurtimisht rëndësinë e përdorimit ekonomik të fushave në ndërveprimin shoqëri-mjedis. Si mund t'i mbrojmë tokat nga ndotja?

5 pikë



Notat	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0-13	14-20	21-27	28-34	35-41	42-47	48-53

MODELI I NJË PROJEKTI MËSIMOR

Lënda: Gjeografia 7

Klasa: 7

Tema: Ndotja mjedisore dhe llojet e saj

SYNIMI I PROJEKTIT

- Aftësimi i nxënësve në punën kërkimore dhe studimore në hulumtimin e problemit.
- Analiza e problemeve dhe bashkërendimi i ideve në zgjidhjen e problemeve të shkaktuara nga ndotjet.
- Aftësimi i nxënësve në një punë kërkimore dhe studimore duke punuar në grup.
- Përcaktimi i llojeve kryesore të ndotjes, shkaktarëve që ndikojnë në formimin e ndotjes, pasojat e ndotjes së tokës, ujit, ajrit dhe marrja e masave konkrete për mbrojtjen e mjedisit.
- Krijimi i një produkti (poster, fletëpalosje, raportim etj)

Suksesi final i projektit është ndërthurja e njohurive me veprimtaritë praktike, të cilat zhvillojnë dhe aftësojnë nxënësit.

KOHEZGJATJA E PROJEKTIT: 3 orë mësimore

Teori	20%
Praktikë	70%
Vlerësimi	10%

PJESËMARRËSIT NË PROJEKT: Nxënësit e klasës 7

PARTËNERËT : Prindërit, mësuesit

PËRFITUESIT : Nxënësit e klasës 7

Aktivitetet që do të kryhen gjatë projektit:

- 1) Kërkime dhe mbledhje e informacionit nga burime të ndryshme mbi ndotjen në zonën tuaj.
- 2) Grumbullim, seleksionim dhe analiza e informacionit.
- 3) Prezantimi i projektit në klasë dhe në "POWER POINT" ose në forma të tjera raportuese si postera, broshura, përmbledhje, album fotosh në varësi të mundësive,

Burimet e informacionit

1) Internet, 2) Teksti shkollor, 3) Enciklopedi dhe literatura të shkruara mbi ndotjen në zonën tuaj (shkaktarët, gjendja, masat e marra)

Buxheti: nevojitet për përgatitjen e posterave, fletë palosjeve, printimeve, nevojave të tjera të vogla etj. Realizohet nga shkolla, vetë nxënësit, prindërit, donatorë etj.

Lista e njohurive lëndore që do të përftohen nga projekti

Përmes informacionit të grumbulluar, nxënësi do të mësojë se çfarë është ndotja e mjedisit, nga se shkaktohet ajo dhe cilat janë masat që mund të përdorim për të mbrojtur mjedisin nga ndotja.

Do të konkretizojë njohuri të përgjithshme të marra për:

- Ndikimin e shoqërisë njerëzore mbi mjedis
- Ndotja e tokës
- Ndotja e ajrit
- Ndotja e ujit

Duke i konkretizuar këto njohuri të marra në studimin e ndotjes dhe të mbrojtjes së mjedisit. Do të vlerësojë larminë e ndotësve në natyrë.

Do të evidentojë problematikat dhe do të ofrohen zgjidhje për to.

REZULTATET E PRITSHME TË PROJEKTIT

- Nxënësit të plotësojnë njohuritë e marra në tekst për ndotjen mjedisore.
- Të aftësohen në mbledhjen e informacionit dhe evidentimin e problemeve.
- Të kenë sukses në një punë të thjeshtë kërkimore.

VLERËSIMI I NXËNËSVE

Nxënësit do të vlerësohen individualisht me notë.

Nxënësi do të vlerësohet për:

- përmbushjen e objektivave të projektit;
- respektimin e afatit kohor;
- bashkëpunim të mirë në grup;
- aftësi në prezantim.

FAZAT E PROJEKTIT

FAZAT	Veprimtaritë	Afati	Përgjegjës
FAZA I	Prezantimi i temës; ndarja e grupeve; diskutimi i planit të punës dhe krijimi i strukturës	45'	Mësuesja/i dhe nxënësit
FAZA II	Diskutim i materialeve, përzgjedhje, seleksionimi i informacionit, formulimi i materialit përmbledhës	45'	Nxënësit dhe mësuesja/i
FAZA III	Prezantimi i punës dhe vlerësimi	45'	Nxënësit dhe mësuesja/i

FAZA I (ora 1)

Prezantohet tema e projektit

Ndarja e punës në grupe

Ndarja e detyrave specifike sipas niveleve dhe dëshirës për të bashkëpunuar

Orientimet për projektin që do të nisin

Hapat për organizimin e temës së caktuar

Marrja e mendimit (kutia e sugjerimeve, anketim, tryeza, diskutim)

Shpallja e vendimit dhe hartimi i planit të veprimtarive

Objektivat për mësuesin:

- të identifikojë temat që do të shtjellojnë projektin;
- të organizojë punën në grup dhe ndarja e detyrave.

LËNDA: Gjeografia 7

Temat që do të ndiqen në tekstin Gjeografia 7, kryesisht kapitulli 6 dhe tema apo nënçështje të veçanta nga kapitulli i Atmosferës për ndotjen e ajrit, kapitulli i Litosferës për ndotjen e tokës dhe Hidrosferës për ndotjen e ujit. Specifikohen temat mësimore.

Tematikat e grupeve sipas zgjedhjeve

- **Grupi 1:** Shkaktarët kryesorë të ndotjes së ajrit, dukuritë dhe efektet që lë ndotja e ajrit në botën e gjallë.
- **Grupi 2:** Format kryesore të ndotjes së tokës dhe pasojat e saj. Rreziku dhe mundësitë e zgjidhjes së problemeve.
- **Grupi 3:** Llojet e ndotjes së ujit dhe pasojat e ndotjes së tij.
- **Grupi 4:** Rrugët që mund të ndjekim për parandalimin dhe minimizimin e ndotjes mjedisore.

FAZA II (Ora 2 e projektit)

Grumbullimi i materialit

Ngritja e strukturës së punës me projekte

Lidhja në mënyrë koherente, logjike e materialeve me njëra-tjetrën

Formulimi i një materiali përmbledhës dhe diskutimi i materialeve dhe i punës së kryer deri në këtë fazë.

Përcaktimi i planit të mëtejshëm të veprimtarive

Çfarë do të bëhet më tej? (Veprimtaritë)

Kush? (udhëzohen konkretisht grupet, nxënësit duke respektuar afatet kohore)

Diskutimi i materialeve dhe i punës së kryer deri në atë fazë.

Udhëzime për formulimin e një materiali përmbledhës.

FAZA 3 (Ora 3)

Në këtë fazë nxënësit prezantojnë punimet e tyre të ndarë sipas grupeve.

Prezantimi do të bëhet në “Word” dhe “PowerPoint”. Ai mund të jetë një poster, i cili mund të reklamohet në ambientet e shkollës; një fletëpalosje, e cila mund të shpërndalet në klasat e tjera apo t’u përcillet edhe prindërve; një raport i cili mund të botohet në revistën e shkollës; një vlerësim i cili mund të jetë pjesë e një konkursi etj.

Në këtë orë mësimore nxënësit do të vlerësohen për punimet e tyre.

Vlerësimi do të jetë në këtë mënyrë:

-20% prezantim me gojë;

-80% materialet dhe bashkëpunimi në grup.

Reflektim

Materialet do të depozitohen në dosje të veçanta dhe do të ruhen nga nxënësit.

TEMATIKA DHE IDE TË TJERA PËR PROJEKTE MËSIMORE

1. Lumenjtë (Ujërat rrjedhëse sipërfaqësore)




Ide:

Grupi 1: Fakte mbi lumenjtë (koncepti lum, lumenjtë me të gjatë, lumenjtë më të mëdhenj,

Grupi 2: Përse përdoren lumenjtë? (foto ilustruese nga bota dhe individuale; si përdoren lumenjtë për kalimin e kohës së lirë? Rrjedhjet ujore, erozioni i tokave dhe mbulesa bimore, etj.

Grupi 3: Modelimi i një pellgu lumor duke evidentuar pjesët e një rrjedhje ujore sipërfaqësore nga burimi deri në grykëderdhje.



2. Bregdeti

Ide:

Grupi 1: Çfarë tiparesh evidentoni në një bregdet (evidentojini nëpërmjet fotove dhe ngjiteni ato në një letër përmasa dhe: gji detar, shpellë, kep, plazh, duna, lagunë, fjorde, shkëmbinj etj). Krijoni një album fotografish me tipare fizike të vijës bregdetare.

Grupi 2: Cilat procese modelojnë brigjet? (baticë-zbaticat, dallgët detare, rrymat oqeanike, ndryshimi i nivelit të detit). Modelimi i zhvillimit të një kepi nga veprimtaria gërryese e detit.

Grupi 3: Modelimi i një vije bregdetare, duke evidentuar format kryesore të krijuara përgjatë tij nga veprimtaria gërryese dhe depozituese e detit.



3. Vullkanet

Ide:

Grupi 1: Cilët janë vullkanet e fjetur? Po ata aktivë? (modeloni pjesët e një vullkani me mjete të ndryshme: plastelinë, letër me ngjyra etj).

Grupi 2: Cilët janë vullkanet më aktivë sot në botë? Sillni fakte dhe foto nga shpërthimet e tyre më të fundit.

Grupi 3: Paraqitja e përhapjes gjeografike e zonave vullkanike në një hartë të botës, të skicuar nga nxënësit, ku evidentohen oqeanet dhe kontinentet.

Të tria punimet e grupeve mund të bashkëngjiten në një të vetme dhe të ekspozohen në muret e klasës, duke i shoqëruar nxënësit gjatë gjithë vitit.

4. Moti




Ide:

Grupi 1: Matja e shpejtësisë dhe drejtimit të erës realizohet me anemometër. Gjeni foto të këtyre instrumenteve dhe i prezantoni ato në një aset fotografish. Ndërtoni një anemometër. Shihni figurën (pipëza, gota plastike, laps etj)

Grupi 2: Matja e temperaturës gjatë një periudhe kohore, të cilën e vendosni bashkërisht mësues-nxënës. Kujdes temperatura matet në hije dhe në një lartësi 1 m nga sipërfaqja e tokës. Ndërtoni një grafik dhe interpretoni të dhënat. Gjatë ditëve të projektit, merrni foto të motit, të cilat ju nevojiten në përgatitjen e prezantimit përfundimtar.

Grupi 3: realizoni një paraqitje të skemës së qarkullimit të ujit në natyrë duke evidentuar avullimin, kondensimin, reshjet, rrjedhjet ujore sipërfaqësore etj.



KRITERET BAZË PËR VLERËSIMIN E NJË MËSUESI

Këto janë kriteret me të cilat kompetencat tuaja mësimdhënëse do të vlerësohen.

A. PRAKTIKË MËSIMDHËNËSE

1. KOMPETENCA SHKENCORE

1. 1 Njohuri shkencore të thelluara.
1. 2 Gjuhë të saktë shkencore.
1. 3 Aftësi për të vlerësuar nxënësit nga njohuritë shkencore.

2. KOMPETENCA PEDAGOGJIKE

2.1 Planifikim

2.1. 1 Përshtatja e zbatueshmërisë së planit mësimor të hartuar në përputhje me programin e MAS-it dhe udhëzimeve të IZHA-s, për lëndët që jep mësim dhe me kushtet konkrete ku shkolla zhvillon veprimtarinë e saj.

2.1. 2 Hartimi i ditarit (përgatitja ditore) në bazë të planit mësimor, mjeteve, burimeve që ka në dispozicion për realizimin orës mësimore dhe edukative, si dhe në përshtatje me nivelin e nxënësve të klasës.

2.1. 3 Përcaktimi i saktë i qëllimeve dhe i objektivave të rezultateve të të mësuarit.

2.1. 4 Aftësi për të planifikuar në mënyrë koherente dhe progresive punën në klasë.

2. 2 Realizim

2. 2. 1 Informacion shkencor të përshtatshëm me temën.

2. 2. 2 Motivim.

2. 2. 3 Metodologji të përshtatshme me nxënësit e klasës, mjetet dhe burimet e zgjedhura.

2. 2. 4 Aftësi për të zgjedhur metodat dhe materialet në përshtatje me aftësitë e nxënësve; përdorimi i një shumëllojshmërie të stileve të mësimdhënies, teknikave, mjeteve; përdorimi i teknikave të të pyeturit në përshtatje me moshën dhe aftësitë e nxënësve; përdorimi i gjuhës së përshtatshme, aftësi komunikimi.

2. 2. 5 Aftësi për t'i demonstruar ato duke krijuar mundësi të barabarta për nxënësit.

2. 2. 6 Aftësi për të marrë parasysh nevojat specifike të nxënësve, duke përfshirë si ata që kanë aftësi të kufizuara, ashtu edhe ata që janë të talentuar.

2. 2. 7 Zhvillim i kapaciteteve të nxënësve.

2. 2. 8 Krijimi i situatave ku nxënësit të kenë mundësi të mësojnë e të arrijnë rezultate.

2. 2. 9 Aftësi për të ruajtur një mjedis të qetë të të mësuarit.

2. 2. 10 Aftësi për të krijuar kushtet për të mësuar; aftësi për të motivuar nxënësit në procesin e mësimdhënies e mësimnxënies dhe të ruajtjes së pages.

3. VLERËSIM

3. 1 Teste zhvilluese.
3. 2 Kriteria vlerësuese.
3. 3 Analiza të përshtatshme dhe përdorim i rezultateve.
3. 4 Aftësi për të monitoruar dhe vlerësuar progresin dhe arritjet e nxënësve.
3. 5 Aftësi për të regjistruar dhe raportuar arritjet.
3. 6 Aftësi për t'iu përgjigjur të dhënave vlerësuese, në planifikimin e mësimdhënies së ardhshme.
3. 7 Vetëvlerësim.

4. I HAPUR NDAJ TË REJAVE PEDAGOGJIKE

4. 1 Brenda në klasë.
4. 2 Jashtë klasës.

B – QËNDRIME

1. Përgjegjësi.
2. Kapacitet për analiza kritike dhe analiza vetëkritike.
3. Iniciator dhe krijues.
4. Fleksibël.
5. Lidhje njerëzore
5. 1 Me nxënësit.
5. 2 Me kolegët e departamentit ku bënë pjesë, mësuesit e drejtuesit e shkollës.
5. 3 Me prindërit e anëtarët e tjerë të komunitetit.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Gjeografia 7: Libri i mësuesit / Jostina Dhimitri,
Fatmiroshe Xhemalaj, Silvana Kasa, Orjeta Prifti. –
Ribot. - Tiranë : Filara, 2017

... f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-142-79-5

I.Dhimitri, Jostina etj.

1.Gjeografia 2.Tekste për mësuesit 3. Tekste për
shkollat 9-vjeçare

911.2 (072) (075.2)